



Funded by
the European Union

With funding from

 Austrian
Development
Cooperation

 Sida
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

“Pandemia nuk njih gjini”?

Analizë gjinore fiskale buxhetore:

Reagimi i Qeverisë së Kosovës ndaj Pandemisë
COVID-19 nga perspektiva gjinore



Gender Budget Watchdog Network

for a gender equal region



“Pandemia nuk njeh gjini”?

Analizë gjinore fiskale buxhetore: Reagimi i Qeverisë së Kosovës ndaj Pandemisë COVID-19 nga perspektiva gjinore

© Rrjeti i Grave të Kosovës, 2020

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Autore: Nicole Farnsworth, Nerina Guri, Naile Selimaj Krasniqi, Ernera Dushica, Aurora Maxharraj dhe Lauren Hanna.

Botuar online në Prishtinë, Kosovë.

Dizajnuar nga Jeta Dobranja.

Ky botim është përgatitur me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian, Agjencisë Austriake për Zhvillim, dhe Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autoreve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Agjencisë Austriake për Zhvillim, dhe Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar.

MIRËNJOHJE

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) falënderon të gjithë përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave që kanë kontribuar duke ndarë kohën e tyre të çmueshme në mbështetje të këtij hulumtimi, veçanërisht duke pasur parasysh sfidat e shumta me të cilat janë përballë dhe për punën shtesë që kanë pasur gjatë pandemisë COVID-19. Ekipi hulumtues i RrGK-së, i përbërë nga Naile Selimaj Krasniqi, Aurora Maxharraj, Nerina Guri dhe Ernera Dushica, punuan pa u lodhur për të realizuar këtë hulumtim brenda një afati shumë të shkurtër në kushte tepër sfiduese të punës. Nicole Farnsworth dhe Lauren Hanna bashkëpunuan në hartimin e raportit. Ekipi falënderon Drejtoreshën Ekzekutive të RrGK-së Igballe Rogova si dhe Koordinatorën e Projektit dhe Asistenten Juridike Valmira Rashiti për mbështetjen e tyre të vazhdueshme.

RrGK falënderon Rrjetin e Mbikëqyrësve të Buxhetimit Gjinnor, posaçërisht Qendrën për Hulumtime dhe Politikë-bërje në Maqedoninë e Veriut, të cilët kanë zhvilluar metodologjinë fillestare për këtë hulumtim. Autorët falënderojnë Dr. Elisabeth Klatzer dhe Dr. Elizabeth Villagomez për rishikimin e tyre shumë të vëmendshëm të draftit dhe për sugjerimet e dobishme. Recensentët e jashtëm, duke përfshirë Edi Gusia nga Agjencia për Barazi Gjinnore, Mentor Morina nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Aulona Selishte, Albana Rukolli, dhe Donjeta Morinën që kanë ofruar komente të dobishme për draftin e parë të raportit.

Ky hulumtim nuk do të ishte realizuar pa ndihmën financiare të Bashkimit Evropian, Agjencisë Austriake për Zhvillim, dhe Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar.

PËRMBAJTJA

Akronimet	1
Përmbledhje ekzekutive	3
HYRJE	5
Metodologjia	6
KOHA E DUHUR E FINANCIMIT PËR REAGIMIN NDAJ COVID-19	9
Fillimi dhe Përhapja e COVID-19 në Kosovë	10
Koha e duhur e reagimit të qeverisë ndaj COVID-19	10
Përfundimi	16
PËRGJEGJËSIA E QEVERISË NË RIALOKIMET E BUXHETIT PËR TË ADRESUAR COVID-19	17
Përdorimi i rezervës për rastet e paparashikuara	17
Miratimi dhe Arsytimi i Rialokimeve	20
Burimet e financimit për adresimin e Pandemisë COVID-19	22
Përfundimi	24
MENAXHIMI I FINANCAVE PUBLIKE NË REAGIMIN NDAJ COVID-19	25
Konsultimet publike, nga perspektiva gjinore	25
Transparenca dhe ndjeshmëria gjinore e prokurimit publik	28
Transparenca në raportet financiare	30
Përfundimi	31
QËLLIMET DHE KONTRIBUTET E MASAVE FISKALE DREJT BARAZISË GJINORE	32
Dokumentet buxhetore dhe amandamentet	33
Përmbledhje e masave fiskale, të buxhetuara dhe të shpenzuara, për të adresuar COVID-19	36
Masat sociale	42
Masat ekonomike dhe adresimi i tyre i pabarazive gjinore	44
Masat ekonomike	49
Masat arsimore	64
Masat shëndetësore	66
Një analizë e shpejtë gjinore e qasjes në kujdesin shëndetësor	67
Masat komunale	69
Përgjegjshmëria e Përgjithshme Gjinore e Masave	70
Përfundimi	72
PERSPEKTIVA EKONOMISTE FEMINISTE MBI MASAT PËR ADRESIMIN E COVID-19	75
Rishikim i teorisë ekonomike neoklasike dhe i alternativave të propozuara	75
Si do të mund të dukej reagimi i ekonomisë feministe ndaj COVID-19 në Kosovë?	78
Përfundimi	80
REKOMANDIMET	81
Për Qeverinë	81
Për Zyrën Kombëtare të Auditimit	84
Për Komunitat	85
Për Kuvendin e Kosovës	85
Për BE-në dhe financuesit e tjerë	86
Për Organizatat e Shoqërisë Civile	86
PUNIMET E CITUARA	87
SHTOJCAT	95
Shtojca 1. Treguesit dhe dimensionet e SHPPF MPGJFP	95
Shtojca 2. Model i manualit të intervistave	96
Shtojca 3. Lista e të intervistuarve	103
Shtojca 4. Anketa	105
Shtojca 5. OShC-të që i janë përgjigjur anketës	109
Shtojca 6. Buxhetet dhe Shpenzimet për COVID-19	110
Shtojca 7. Qëllimet e masave drejt arritjes së barazisë gjinore	111

Akronimet

AIMNK	Agjencia e Investimeve dhe Mbështetjes së Ndërmarrjeve në Kosovë
ASK	Agjencia e Statistikave e Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BP	Ballkani Perëndimor
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
D4D	Demokracia për Zhvillim
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LIVTh	Llogaria e Vetme e Thesarit
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MEA	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MPGjFP	Korniza plotësuese e SHPPF-së për vlerësimin e menaxhimit të përgjegjshëm gjinor të financave publike
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
OSHCG	Organizata të Shoqërisë Civile për të drejtat e Grave
PVGJ	Plani i Veprimit Gjinor i BE-së
PI	Treguesit e SHPPF
QHP	Qendra për Hulumtim dhe Politikëbërje
RrGK	Rrjeti i Grave të Kosovës
RrMBGJ	Rrjeti i Mbikëqyrësve të Buxhetimit Gjinor
SHPPF	Shpenzimet Publike dhe Përgjegjshmëria Financiare
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
ZBGj	Zyrtar për Barazi Gjinore

Përmbledhje ekzekutive

Rrjeti i Grave të Kosovës ka realizuar këtë hulumtim, si anëtare e Rrjetit të Mbikëqyrësve të Buxhetimit Gjinnor, për të analizuar nga perspektiva gjinore masat e politikave fiskale të ndërmarrë nga Qeveria e Kosovës me qëllim të adresimit të pandemisë COVID-19. Ky hulumtim mbulon periudhën nga shkurti deri në tetor 2020. Në gjetjet kryesore bëjnë pjesë:

Pandemia COVID-19 ka prekur si gratë ashtu edhe burrat. Rreziku i prekjes nga virusi duket të jetë më i lartë për gratë, duke marrë parasysh përfaqësimin e tyre më të lartë në shëndetësi dhe sektorë të tjerë esencialë. Megjithatë, sipas të dhënave zyrtare, nga sa duket, më shumë burra e kanë pasur dhe/ose kanë vdekur nga COVID-19.

Burrat dhe gratë janë përballur me vështirësi të mëdha ekonomike. Gjetjet nga zyra e punësimit dhe të dhënat cilësore sugjerojnë se shumë kanë humbur punën dhe / ose janë përballur me kushte më të vështira të punës. Sidoqoftë, të dhënat e sakta të punësimit për sektorët dhe njerëzit më të prekur nuk janë ende në dispozicion, gjë që e bën të vështirë analizimin e pabarazive gjinore.

Normat e mëparshme shoqërore dhe marrëdhëniet e pushtetit pa dyshim i kanë vendosur gratë në një pozitë të pasigurt ekonomike. Duke pasur parasysh rolet tradicionale gjinore, përgjegjësitë e kujdesit i kanë bërë gratë të rrezikohen nga humbja e punës, veçanërisht nënat vetë-ushqyese dhe gratë që kujdesen për persona me aftësi të ndryshme. Kjo është për shkak të mbylljes së shkollave dhe shërbimeve sociale për të rriturit në varësi. Pandemia theksoi kujdesin e papaguar dhe punën riprodhuese të heshtur më parë, që është thelbësore për funksionimin e ekonomisë.

Kufizimet në lëvizje gjithashtu ka të ngjarë të kenë kontribuar në qasjen më të dobët në kujdesin shëndetësor për gratë që kanë më pak qasje në transport dhe në shërbime shëndetësore.

Gratë dhe fëmijët kanë qenë më të rrezikuar nga dhuna në familje.

Në përgjithësi, Kosova nuk ishte e përgatitur si duhet për çfarëdo emergjence, duke pasur parasysh paqëndrueshmërinë e saj politike dhe limitimin e alokimeve buxhetore ekzistuese për këtë qëllim. Megjithëse reagimi fillestar qeveritar ndaj COVID-19 ishte mjaft në kohë, shpërndarja e fondeve u vonua për shkak të ndërrimit të qeverisë, krizës politike, vonesave shoqërore në rishikimin e buxhetit dhe dështimit të Kuvendit të Kosovës për të pasur kuorum ose për t'u pajtuar për propozimet e politikave.

Ministria e Financave kishte një rezervë për raste të paparashikuara, dhe organizatat buxhetore rialokuan shpenzimet për të përmbushur nevojat, pas proceseve zyrtare të miratimit të rialokimeve. Megjithatë, arsyetimet për këto nuk përmbanin perspektivë gjinore.

Prokurimi ndonjëherë u realizua sipas procedurave të përsheptuara që janë të lejueshme. Shumica e dokumenteve të tilla janë në dispozicion të publikut. Masat afirmative të lejueshme ligjrisht ndaj barazisë gjinore nuk u pasqyruan në prokurim, pasi që zyrtarët e financave në përgjithësi nuk kishin njohuri të nevojshme në lidhje me dispozitat përkatëse në ligjet për barazinë gjinore dhe prokurimin.

Raportimi i rregullt financiar vazhdoi, por jo të gjitha raportet janë në dispozicion të publikut. Këto raporte nuk përmbajnë ndonjë perspektivë gjinore. Shpenzimet në lidhje me pandeminë COVID-19 nuk do të auditohen deri në vitin 2021; historikisht, auditimet nuk kanë ekzaminuar ndikimin gjinor.

Shumica e masave të Qeverisë për të adresuar pandeminë e COVID-19 nuk i marrin në konsideratë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave. Zyrtarët në përgjithësi besonin se kriza i ka prekur të gjithë, dhe për këtë arsye nuk ishte e nevojshme perspektiva gjinore. Për shumë masa, mos konsiderimi i dallimeve gjinore mund të nënkuptojë që masat përforcojnë pabarazitë gjinore ekzistuese dhe madje mund të jenë edhe “negative nga aspekti gjinor”.

Po ashtu, as qasja e ndërthurjes nuk u mor parasysh në hartimin e masave; nevojat e veçanta të grave dhe burrave me moshë, etni, vendndodhje gjeografike dhe aftësi të ndryshme u morën në konsideratë fare pak ose aspak në këto masa.

Qeveria organizoi shumë pak konsultime publike për të mbledhur informata nga gratë dhe burrat në lidhje me masat; as nuk angazhuan shumë organizata të shoqërisë civile për të dhënë kontributin e tyre.

Në përgjithësi, planet e rimëkëmbjes shpërndajnë shumicën dërmuese të burimeve për bizneset, sesa për infrastrukturën sociale si shëndetësia, arsimi, sistemet e kujdesit dhe shërbimet sociale, ose mjedisi, duke mos njohur që forcimi i një infrastrukture të tillë sociale është themelor për një rimëkëmbje ekonomike afatgjatë dhe gjithëpërfshirëse.

Pavarësisht nga detyrimet në Ligjin për Barazinë Gjinore, qeveria nuk ka mirëmbajtur të dhëna të ndara sipas gjinisë për grupet e synuara ose përfituesit e masave qeveritare, e as nuk ka realizuar Vlerësime të Ndikimit Gjinor ex-ante. Është shumë herët të vlerësohet ndikimi që kanë pasur masat tek gratë dhe burrat, ose në barazinë gjinore.

Shqyrtimi i nevojave të grave dhe burrave, krahasuar me mbështetjen e dhënë përmes masave qeveritare, sugjeron që disa nevoja mbeten të pa adresuara.

Raporti përfundon me rekomandime specifike për Qeverinë, Zyrën Kombëtare të Auditimit, komunat, Kuvendin e Kosovës, financuesit dhe shoqërinë civile.

HYRJE

Pandemia COVID-19 ka ndikuar në çdo aspekt të jetës shoqërore dhe ekonomike. Ndërsa kriza ka prekur të gjithë, edhe pse nuk është prekur në mënyrë të barabartë: gratë dhe burrat i ka prekur në mënyra të ndryshme. Në gjithë botën, gratë preken në mënyrë disproporcionale dhe rrezikohen më shumë nga prekja e virusit pasi kanë qenë në vijat e para të pandemisë COVID-19, duke qenë në pjesën më të madhe të kujdesit shëndetësor dhe forcës së punës sociale si infermiere, punonjës të kujdesit për bujtina dhe punëtorë me pakicë. Në të vërtetë, kjo ka çuar që recesioni i ardhshëm i drejtuar nga pandemia të quhet si “recesioni i saj” [she-cession].¹ Si rezultat i mbylljes dhe masave të izolimit, gratë kanë mbajtur barrën e shtuar të punës së papaguar të kujdesit, siç janë kujdesi për fëmijët, për të moshuarit dhe për punë të tjera shtëpiake.² Përgjegjësitë e rritura kanë pasur ndikime negative në mirëqenien fizike dhe mendore të grave.³ Në Kosovë, hulumtimet sugjerojnë që puna e papaguar dhe barra e punëve në shtëpisë kontribuojnë në stresin fizik, psikologjik dhe emocional të gratë.⁴ Humbja e punës dhe papunësia që rezultojnë nga masat e izolimit mund të ndikojnë negativisht tek gratë dhe kthimi i tyre në tregun e punës.⁵ Gjatë bllokimit, dhuna në familje është rritur, dhe gratë kanë qenë të privuara për tu ndihmuar për shkak të izolimit në shtëpi me abuzuesit.⁶

Në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore, buxheti gjinor është i nevojshëm për të siguruar respektimin e parimit të barazisë gjinore në ndarjen e fondeve shtetërore.⁷ Sipas praktikave më të mira në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, vlerësimet *ex ante* paraprake të ndikimit gjinor duhet të informojnë buxhetimin bazuar në nevojat aktuale të grave dhe burrave të ndryshëm.⁸ Për më tepër, Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021 e Qeverisë së Kosovës, shprehimisht bën thirrje për Vlerësim të Ndikimit Gjinor, si pjesë e Vlerësimit të Ndikimit Rregullativ, për të siguruar informata për të gjitha politikat dhe programet qeveritare.⁹ Udhëzuesi dhe Doracaku për Hartimin e Koncept Dokumenteve përfshin kryerjen e Vlerësimeve të Ndikimit Gjinor¹⁰. Agjencia për Barazi Gjinore gjithashtu ka ofruar udhëzime për kryerjen e Vlerësimeve të Ndikimit Gjinor¹¹.

Përkundër hulumtimeve ekzistuese për COVID-19 dhe diskutimeve mbi ndikimin e ndryshëm që COVID-19 mund të ketë tek gratë dhe burrat, në Kosovë ekziston hulumtim minimal gjithëpërfshirës në lidhje me reagimin e shtetit ndaj pandemisë nga perspektiva gjinore, veçanërisht në alokimin e financimit shtetëror. Ndërsa literatura ekzistuese përmban informata të përgjithshme se si virusi ka ndikuar tek gratë, asnjë analizë nuk përmban të dhëna për implikimet ekonomike, shoqërore dhe shëndetësore të pandemisë, të ndara sipas gjinisë. Gjithashtu, nuk janë publikuar kënaqshëm të dhënat e ndara sipas gjinisë për përfituesit e masave shtetërore në adresimin e pandemisë. Të dhëna të tilla të ndara sipas gjinisë janë të rëndësishme për informimin e shpenzimeve të ardhshme të bazuara në nevojat dhe përdorimin paraprak, drejt përdorimit më efikas dhe efektiv të fondeve të kufizuara shtetërore.

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) e ka realizuar këtë hulumtim, si anëtare e Rrjetit të Mbikëqyrësve

¹ Fondacioni Atkinson, [Informimi i Vendimeve Publike Public Decisions](#) - Armine Yalnizyan, 2020.

² UNFPA dhe UN Women, [Shpërthimi i Pandemisë COVID-19: Ndikimi i situatës së COVID 19 tek gratë dhe vajzat si dhe rekomandimet për përgjigje të ndjeshme gjinore](#).

³ Qendra Ndërkombëtare për Rritje, “Covid-19 dhe impakti tek gratë [[COVID-19 and the impact on women](#)]”, 28 Prill 2020.

⁴ Demokracia për Zhvillim (D4D), “[Implikimet e mundshme gjinore të COVID-19 në Kosovë](#)”, 2020.

⁵ Po, aty.

⁶ Po, aty.

⁷ [Ligji nr. 05/L-20 për Barazi Gjinore](#), Neni 5, par. 1.5.

⁸ Për më shumë informacion në lidhje me metodologjinë për ndërmarrjen e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe një udhëzues të thjeshtë, ju lutem shikoni: Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), [Një Udhëzues Praktik i Përdoruesit: Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor në Nivelin Qendror](#), RrGK: Prishtinë, 2017; dhe një Udhëzues Praktik i Përdoruesit: Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor në Nivelin Lokal, RrGK: Prishtinë, 2017.

⁹ Qeveria e Kosovës, [Strategjia e Rregullimit më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021](#).

¹⁰ Zyra e Kryeministrit, Qeveria e Republikës së Kosovës, [Udhëzime dhe Manual për Zhvillimin e Koncept Dokumentit](#), Prishtinë, Mars 2018.

¹¹ Agjencia për Barazi Gjinore, [Vlerësimi i Ndikimit të Barazisë Gjinore](#).

të Buxhetimit Gjinor.¹² për të analizuar nga perspektiva gjinore masat e politikave fiskale të ndërmarra nga Qeveria me qëllim të adresimit të pandemisë COVID-19 në Kosovë. Ky raport së pari ofron një pasqyrë të pandemisë dhe efekteve të saj tek gratë dhe burrat në Kosovë, duke identifikuar nevojat e tyre të ndryshme. Raporti shqyrton afatet e reagimit të qeverisë ndaj COVID-19 dhe më pas vlerëson përgjegjshmërinë gjinore të programeve qeveritare dhe alokimeve buxhetore. Në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien, raporti pastaj diskuton shkallën deri në të cilën menaxhimi i financave publike të pandemisë ishte i ndjeshëm ndaj gjinisë, duke përfshirë konsultimet publike, angazhimin e shoqërisë civile, prokurimin publik dhe raportimin financiar. Në fund, raporti përpiqet të shqyrtojë ndikimin fillestar të masave nga perspektiva gjinore. Raporti përfshin analizën e masave sociale, ekonomike, arsimore, shëndetësore dhe komunale, si dhe një diskutim të përgjithshëm të marrë nga ekonomia feministe. Ndërsa kërkimi u përpoq të shqyrtonte ndikimin fillestar të secilës masë nga perspektiva gjinore, ishte mjaft herët për të vlerësuar ndikimin. Raporti përfundon me rekomandime, të cilat kërkojnë të mbështesin qeverinë në përmirësimin e reagimit të saj ndaj pandemisë.

Metodologjia

Pyetja e përgjithshme e hulumtimit ishte: deri në çfarë mase ka përfshirë reagimi i Qeverisë së Kosovës ndaj pandemisë COVID-19 perspektivën gjinore? Qendra për Hulumtim dhe Politikëbërje (QHP) hartoi metodologjinë dhe mjetet kërkimore të përdorura për këtë hulumtim. RrGK i përshtati ato për përdorim në Kosovë duke siguruar krahasueshmërinë rajonale. Metodologjia e hulumtimit u bazua në metodologjinë e Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjshmërisë Financiare (SHPPF) për vlerësimin e performancës së menaxhimit të financave publike dhe kapjen e ndryshimeve në performancën e menaxhimit të financave publike me kalimin e kohës. Komisioni Evropian, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore dhe qeveri të ndryshme inicuan për herë të parë metodologjinë SHPPF në vitin 2001. Ky hulumtim përdori këta tregues për të udhëhequr vlerësimin e reagimit të Qeverisë së Kosovës ndaj COVID-19. Hulumtimi shqyrtoi katër dimensionet e reagimit të qeverisë, të formuluar në përputhje me kornizën e SHPPF:¹³ (i) përgjegjshmërinë gjinore; (iii) menaxhimin e financave publike nga perspektiva gjinore, përfshirë transparencën dhe llogaridhënien; dhe (iv) ndikimin e shpenzimeve nga perspektiva gjinore. Performanca e qeverisë u vlerësua duke përdorur treguesit e mëposhtëm të zgjedhur SHPPF (PI): PI-18 “Shqyrtimi legjislativ i buxheteve”, PI-18.4, “Rregullat për përshtatjen e buxhetit nga ekzekutivi”, PI-21 “Parashikimi i alokimit të burimeve brenda vitit” dhe PI-21.4 “Rëndësia e përshtatjeve buxhetore brenda vitit”.

Po ashtu, në vitin 2020, SHPPF lansoi Kornizën plotësuese për vlerësimin e menaxhimit të përgjegjshëm gjinor të financave publike (MPGjFP). Korniza ka nëntë tregues të rëndësishëm për aspekte të ndryshme të ciklit buxhetor, përfshirë:

1. Analiza e ndikimit gjinor e propozimeve të politikave buxhetore;
2. Investime publike të menaxhimit të përgjegjshme gjinore;
3. Qarkore buxhetore të përgjegjshme gjinore;
4. Dokumentacioni i përgjegjshëm gjinor i propozimit të buxhetit;
5. Informacione të performancës të ndara sipas gjinisë për ofrimin e shërbimeve;

¹² Rrjeti i Mbikëqyrësve të Buxhetimit Gjinor (RrMBGJ) është një rrjet rajonal i Organizatave të Shoqërisë Civile nga vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia) dhe Republika e Moldavisë, i cili përdor mjete të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, monitoron buxhetet nga perspektiva gjinore dhe vlerëson nismat e buxhetit gjinor në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi.

¹³ Sekretariati SHPPF, Korniza për vlerësimin e menaxhimit publik financiar, Washington: 2019.

6. Përcjellja e shpenzimeve të buxhetit për barazinë gjinore;
7. Raportimi i përgjegjshëm gjinor;
8. Vlerësimi i ndikimeve gjinore të ofrimit të shërbimeve; dhe
9. Shqyrtimi legjislativ i ndikimeve gjinore të buxhetit.¹⁴

Ky hulumtim diskuton reagimin e Qeverisë së Kosovës ndaj pandemisë duke iu referuar këtyre indikatorëve. Hulumtimi gjithashtu përpiqet të merr në konsideratë ndërthurjet, më saktësisht mënyrat në të cilat ndërthurjet e moshës, aftësisë, orientimit seksual, vendndodhjes gjeografike dhe përkatësisë etnike me gjininë mund të ndikojnë në cënueshmëri në kohë krizash.

Hulumtimi filloi realizimin nga muaji korrik deri në tetor 2020. Metodologjia përfshinte metoda të përziera hulumtuese. Së pari, përmes shqyrtimit dokumentar u shqyrtuan të gjitha hulumtimet ekzistuese mbi pandeminë nga perspektiva gjinore, duke përfshirë vendimet e qeverisë në lidhje me krizën, dokumentet buxhetore, dokumentet mbështetëse, buxhetet e shtetit, raportet nga aktorët përkatës dhe të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Çdo politikë dhe masë qeveritare si reagim ndaj COVID-19 është analizuar bazuar në pyetjet hulumtuese, duke përdorur një shkallë të ndjeshmërisë gjinore të semaforit.¹⁵

Së dyti, ekipi zhvilloi intervista me drejtorët e Buxhetit dhe Financave në pesë ministritë kryesore që ofrojnë reagim ndaj COVID-19;¹⁶ 22 drejtorë komunalë të Buxhetit dhe Financave; tetë zyrtarë për barazi gjinore (ZBGJ) nga komunat dhe ministritë; Agjencinë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës; si dhe nëntë organizata të ndryshme të shoqërisë civile (OSHC). Ministritë përfshinin Ministrinë e Financave; Ministrinë e Shëndetësisë; Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT); Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA); dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS).¹⁷ Zyra Kombëtare e Auditimit ishte kontaktuar, por nuk u intervistua pasi që kurrfarë të dhënash përkatëse nuk do të jenë gati deri në vitin 2021. Të anketuarit u zgjodhën duke përdorur metodën e marrjes së mostrave të volitshme dhe mostrave të variacionit, bazuar në përgjegjësitë e tyre dhe punën që lidhet drejtpërdrejt me pandeminë COVID-19 Gjetjet në lidhje me departamentet e buxhetit në ministri dhe komuna shpesh i referohen këtyre organeve si “organizata buxhetore”, sipas terminologjisë së përdorur zakonisht në Kosovë.¹⁸

Së treti, në gusht dhe shtator, një anketë u administrua në mënyrë elektronike për të vlerësuar përfshirjen e shoqërisë civile në reagimin ndaj krizës, transparencën e politikave dhe proceseve buxhetore dhe këndvështrimin e OSHC-ve mbi ndikimin e masave qeveritare nga perspektiva gjinore.¹⁹ Anketa u administrua në internet dhe u reklamua duke përdorur listat e adresave të RrGK-së dhe të rrjetit të OSHC-ve CIVIKOS. Në total, 75 organizata u përgjigjën, që vlerësohen të jenë rreth 7.5% e të gjitha OSHC-ve aktive në Kosovë.²⁰ Përderisa, sondazhi ka përdorur marrjen e mostrave të përshtatshme, gjetjet janë ilustruese por jo statistikiisht përfaqësuese.

¹⁴ Sekretariati SHPPF, [Korniza për vlerësimin e menaxhimit të përgjegjshëm gjinor të financave publike](#), Washington: Janar, 2020. Shih Shtojcën 1.

¹⁵ Për informata të mëtejshme, shihni kapitullin Masat Fiskale.

¹⁶ Një shembull i udhëzuesit për intervistë gjendet në [Shtojcën 2](#) dhe një liste e të anketuarve në [Shtojcën 3](#).

¹⁷ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë gjithashtu ishte kontaktuar, por Zyrtari i Financave nuk ishte në dispozicion për një intervistë (korrespondenca, 17 gusht).

¹⁸ Ligji Nr. 03 / L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 1, përkrahur Organizatat Buxhetore si “çdo autoritet publik ose ndërmarrje publike që merr drejtpërdrejt sipas një Ligji të Ndarjeve një përvetësim që nuk është përbërës i një ndarjeje më të madhe totale të parashkuar një autoriteti tjetër publik ose ndërmarrje publike”.

¹⁹ Instrumenti i anketës është në dispozicion në [Shtojcën 4](#).

²⁰ Sipas Ministrisë së Pushtetit Lokal [10.214 OSHC ishin të regjistruara në Kosovë në vitin 2019](#). Sidoqoftë, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile ka vlerësuar se vetëm 1,000 OSHC janë aktive. Një listë e OSHC-ve kombëtare dhe ndërkombëtare në vitin 2020 është në dispozicion [në internet](#). Madhësia e mostrës prej 100 OSHC-ve ishte shënjestruar (10%), duke përdorur metodën e marrjes së mostrave të volitshme (p.sh., ato që iu përgjigjën anketës). Të anketuarit gjenden në [Shtojcën 5](#).

Të paktën dy hulumtuese i analizuan të gjitha gjetjet, krahas vlefshmërisë së avancuar. Në përgjithësi, triangulimi i metodave, burimeve të të dhënave dhe hulumtuesve kishte për synim të përmirësojë vlefshmërinë e gjetjeve.

Kufizimet përfshinin mos disponueshmërinë ose refuzimin e zyrtarëve për t'iu përgjigjur kërkesave për intervistë; përfaqësuesit e institucioneve që vetë vuajnë nga COVID-19; dhe institucionet që nuk mbanin të dhëna të ndara sipas gjinisë, shpesh duke ia atribuar këtë "situatës emergjente" dhe se nuk kishte "kohë për të menduar për gjininë". Ishte shumë herët për t'iu përgjigjur disa pyetjeve të hulumtimit. Për shembull, audimi për vitin 2020 nuk do të kryhet deri në vitin 2021. Ishte thjeshtë herët të shqyrtohej ndikimi i masave. Mos disponueshmëria e disa dokumenteve publike, apo vështirësitë për t'i gjetur ato në internet, gjithashtu paraqitën sfida. Ndërimi i qeverisë dhe riorganizimi i ministrive, i cili ndodhi gjatë fazës së hulumtimit, gjithashtu nënkuptonte që zyrtarët qeveritarë të ndryshonin pozitat; kjo mund të ketë nënkuptuar që disa të anketuar nuk kishin njohuri për atë që kishte ndodhur me qeverinë e mëparshme në planifikimin ose zbatimin fillestar të masave. Fakti që disa politika qeveritare gjithashtu ndryshuan drejt kah fundi i vitit 2020 gjithashtu nënkuptonte që hulumtimi u zgjerua shpejtë në mënyrë të konsiderueshme në fushën e veprimit pak para botimit. Afati kohor për rishikimin e masave të fundit dhe ndikimi i tyre i mundshëm te gratë dhe burrat ishte jashtëzakonisht i kufizuar, por mos përmendja e tyre fare do të përbënte lëshim të madh. Kështu që, ekipi pranon se mund të ketë pasur zhvillime të rëndësishme në muajt e fundit të vitit 2020 që ky raport nuk i mbulon, veçanërisht duke marrë parasysh që intervistat me institucionet janë kryer në gusht dhe shtator 2020.

Një kufizim tjetër i përgjithshëm është fakti që njerëzit në Kosovë ndonjëherë komunikojnë me gojë dhe jo gjithmonë i shkruajnë detajet e vendimeve të marra. Ky hulumtim kryesisht ka nxjerrë informata nga dokumentet e shkruara dhe informacioni i dhënë në intervista. Gjatë fazës përfundimtare të rishikimit të jashtëm, ekipi mësoi se zyrtarë të caktuar qeveritarë kishin ndërmarrë disa hapa për të adresuar nevojat e veçanta të grave dhe burrave, por që këto ishin diskutuar përbrenda dhe nuk ekzistojnë me shkrim. Prandaj, ekipi pranon faktin se mund të jenë ndërmarrë hapa shtesë drejt barazisë gjinore, por ekipi nuk kishte qasje në këtë informacion ose nuk iu ishte dhënë ky informacion gjatë intervistave me përfaqësues të institucioneve kyçe. Megjithatë, vendime të tilla të brendshme pa dyshim duhet të ishin artikulluar nga institucionet qeveritare në vendimet zyrtare dhe ti komunikoheshin qartë publikut. Ekziston gjithashtu mundësia që qeveria të ketë marrë masa që ata nuk e dinin se do të kontribuonin në mënyrë indirekte në barazinë gjinore, dhe prandaj ata mund të mos i kishin përmendur ato në dokumentet e politikave ose në intervistat.

KOHA E DUHUR E FINANCIMIT PËR REAGIMIN NDAJ COVID-19

Në këtë kapitull përshkruhet fillimi dhe përhapja e pandemisë në Kosovë, duke ofruar një pasqyrë hyrëse të përgjigjes së qeverisë. Kapitulli analizon afatet kohore dhe efikasitetin e financimit të qeverisë si përgjigje ndaj pandemisë. Ai është i rëndësishëm për vlerësimin e dimensionit 18.3 të SHPPF-s- koha e miratimit të buxhetit.

Fillimi dhe Përhapja e COVID-19 në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKShP) në Kosovë filloi testimin e qytetarëve para se të raportoheshin rastet e para të konfirmuara. Nga 8 shkurti 2020, IKShP e përdori faqen e tij në internet dhe faqen e Facebook-ut për të ofruar informacione mbi masat e nevojshme të mbrojtjes, si dhe përditësime të rregullta për rastet e reja, rastet e konfirmuara dhe rastet e vdekjeve.²¹ Sipas IKShP-së, 93 mostra janë testuar midis 8 shkurtit dhe 12 marsit të vitit 2020; të gjitha testet u kthyen me rezultat negativ. Ky informacion nuk ishte i ndarë sipas gjinisë, moshës ose komunës. Kur dy rastet e para pozitive u konfirmuan më 13 mars,²² IKShP ofroi të dhëna për gjininë, moshën dhe komunën e pacientëve. Sipas qeverisë, ata ishin një grua italiane 20 vjeçe dhe një kosovar 77 vjeç.¹⁵

Më 17 mars, një njoftim për shtyp theksoi se nga 13 deri më 17 mars, kishte 16 raste pozitive në Kosovë, tetë gra dhe tetë burra. Nga të dhënat e disponueshme për publikun, deri më 24 mars kishte 22 raste të konfirmuara, 11 burra dhe 11 gra. Praktika e publikimit të gjinisë, moshës dhe komunës së rasteve pozitive dhe vdekjeve përfundoi më 24 mars. Pas kësaj, IKShP lëshoi vetëm të dhëna për numrin e testeve të kryera në 24 orët e fundit, numrin e personave që rezultojnë pozitiv në testim dhe numrin e vdekjeve. Nga 25 marsi deri më 25 korrik, IKShP filloi përsëri ofrimin e këtij informacioni sipas komunave. Nga 26 korriku, IKShP publikoi një formë tabelore me këtë informacion, të ndarë gjithashtu sipas qytetit ose fshatit.²³ Të dhëna për gjininë dhe moshën ende nuk raportoheshin.

Më 10 gusht, Bordi për licencim të institucioneve private shëndetësore, nga më shumë se 100 aplikacione, licencoi 29 laboratorë për trajtimin e COVID-19.²⁴ Dy javë pas licencimit të laboratorëve privatë (24 gusht), IKShP filloi të përfshinte në postimet e tyre të përditshme në Facebook gjithashtu edhe informacionet mbi mostrat e testuara në laboratorët privat.²⁵

Në përgjithësi, nga 13 marsi deri më 31 tetor, Kosova kishte 20,179 raste të konfirmuara pozitive me COVID-19, përfshirë 9,420 gra (47%) dhe 10,749 burra (53%).²⁶ Siç e ilustron Grafiku 1, numri i rasteve arriti kulmin në korrik, megjithëse një valë e dytë e rasteve kishte filluar në muajin tetor. Nga rastet pozitive, 228 gra (33.5%) dhe 460 burra (67.5%) vdiqën nga virusi.²⁷ Kështu që, të dhënat sugjerojnë se në përgjithësi, burrat kanë më shumë të ngjarë sesa gratë të infektohen dhe të vdesin si

²¹ Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, [Faqja zyrtare në Facebook e IKShP](#).

²² Bota Sot, "Një muaj nga rasti i parë COVID-19 në Kosovë. Masat e marra dhe rritja ditore e numrit të personave të infektuar me virus", April 2020.

²³ Zyra e Kryeministrit të Kosovës, faqja zyrtare, [Konfirmohen dy rastet e para të Corona Virusit Covid-19 në Kosovë](#), 13 Mars 2020.

²⁴ IKShP, [Faqja zyrtare e Facebook e IKShP](#).


²⁵ KALLXO, "Lista e laboratorëve privatë të licencuar për testimin e COVID-19 testing". Nga këto, 27 ishin të licencuar për teste të përgjithshme serologjike dhe dy ishin të testuar për kryerjen e testeve më të ndjeshme dhe më specifike molekulare (RT-PCR).

²⁶ IKShP, postimi i datës 24 gusht 2020. Laboratorët privatë nuk e bënë të ditur këtë informacion, pasi iu dha automatikisht IKShP me regjistrimin e pacientëve.

²⁷ Komunikimi me email mes RrGK dhe IKShP.

rezultat i virusit.²⁸ Hulumtimi fillestar ia atribuoi këtë tendencës më të madhe të burrave që kanë pasur sëmundje para-ekzistuese që i vendos ata në rrezik, si dhe dallimeve imunologjike të bazuara në gjini, por gjithashtu edhe “sjelljes gjinore”, pra që burrat janë të prirë të kenë nivel më të lartë të pirjes së duhanit, përdorimit të alkoolit dhe “qëndrimeve të papërgjegjshme” ndaj masave parandaluese, duke i vendosur ata kësisoj në rrezik më të madh.²⁹ Ndërkohë, duke pasur parasysh tendencat më të gjera të qasjes në kujdesin shëndetësor në Kosovë,³⁰ ekziston mundësia që burrat të kenë pasur qasje më të mirë në kujdesin shëndetësor dhe kështu të raportojnë më shumë raste, ndërsa disa raste të prekura nga gratë mund të kenë mbetur të pa raportuara për shkak të mungesës së qasjes. Për shembull, duke marrë parasysh faktin që punonjësit publikë kanë pasur përparësi zyrtare për testim, dhe se ka më shumë burra që janë të punësuar në institucionet publike sesa gra,³¹ më shumë burra mund të kenë pasur qasje në teste sesa gra. Edhe kjo mund të kontribuojë në një pasqyrim më të lartë të rasteve në mesin e burrave, pasi që rastet e grave mund të jenë raportuara më pak.³²

Grafiku 1. Trendet e Covid-19 në Kosovë prej marsit deri në tetor



Koha e duhur e reagimit të qeverisë ndaj COVID-19

Kosova hyri në vitin 2020 pa qeveri dhe pa buxhet të aprovuar për vitin aktual. Pas zgjedhjeve të përgjithshme të mbajtura më 3 tetor 2019, u deshën tre muaj për dy partitë kryesore politike, Vetëvendosjen dhe Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), që të krijojnë qeverinë. Më 3 shkurt 2020, Kuvendi i Kosovës miratoi qeverinë e re, të udhëhequr nga Kryeministri Albin Kurti. Ai bëri një riorganizim thelbësor të qeverisë dhe administratës publike, të cilat janë përmendur, ku është relevante, më vonë në këtë raport. Në atë kohë, COVID-19 ishte një shqetësim global në rritje, megjithëse Kosova nuk kishte raste të konfirmuara.

Më 11 mars, qeveria vendosi të marrë masa parandaluese për të mbrojtur qytetarët nga

²⁸ Ky informacion nuk ishte i disponueshëm publikisht; RrGK i mori këto të dhëna pas një kërkesë zyrtare në tetor.

²⁹ Bwire, George M., “Coronavirus: Pse burrat janë më të ndjeshëm ndaj Covid-19 sesa gratë?”, Mjekësia Klinike Gjithpërfshirëse, qershor 2020: 1–3, tek: Mbledhja e Emergjencave të Shëndetit Publik Natyror [Nature Public Health Emergency Collection].

³⁰ RrGK, Qasja në Shëndetësi në Kosovë, 2016.

³¹ RrGK, Analizë Gjinore e Kosovës, Prishtinë: RrGK, 2018: “Gratë përbëjnë 40% të të gjithë punonjësve dhe 27% të vendimmarrësve në institucionet e nivelit qendror. [...] Që nga gushti i vitit 2017, gratë mbanin 33% të të gjitha pozicioneve të administratës publike komunale dhe vetëm 20% të të gjitha pozicioneve udhëheqëse” (f. 11).

³² Intervistat e RrGK me OShC, 2020.

COVID-19. Ditën e nesërme, qeveria miratoi një vendim për të themeluar një Komision të Posaçëm për Parandalim të Përhapjes së Coronavirusit (COVID-19) në Kosovë; Komisioni do të monitoronte zbatimin e akteve ligjore dhe jo-ligjore për të mbrojtur qytetarët. Komisioni përfshinte tre gra (14%) në mesin e 22 përfaqësuesve institucionalë (14%).³³ Vetë vendimi dhe mandati i Komisionit nuk përmbanin ndonjë perspektivë gjinore, siç janë përgjegjësitë për të vlerësuar ndikimin potencial të përhapjes së virusit ose masave të propozuara qeveritare për gratë dhe burrat.

Dy ditë pasi Kosova shënoi dy rastet e para me COVID-19, më 15 mars qeveria shpalli emergjencë të shëndetit publik,³⁴ duke marrë masa për parandalimin e përhapjes së COVID-19. Komunitat e prekura fillimisht, ajo e Klinës dhe Vitisë, i ndaluan hyrje-daljet në komunitat e tyre, pas vërtetimit të rasteve të para atje.³⁵ Kjo praktikë së shpejti u zbatua nëpër komunitat e tjera që konsideroheshin si “vatra të nxehta” të pandemisë që përhapej me shpejtësi. Në fund të muajit mars, qeveria kishte ndaluar lëvizjen e qytetarëve dhe automjeteve gjatë orëve të caktuara, përveç në rastet për nevoja esenciale.³⁶

Masat e para përfshinin mbylljen e shkollave, kopshteve, institucioneve të tjera arsimore, bizneseve, bareve dhe restoranteve, si dhe vetë-izolimimin dhe karantinimin.³⁷ Masat tjera përfshinin ndërprerjen e transportit ndër-urban dhe udhëtimeve ndërkombëtare, me mbyllje të aeroportit. Këto masa synonin të zvogëlonin përhapjen e COVID-19 në pjesë të tjera të vendit dhe rajonit, Ballkanit Perëndimor, përmes udhëtimeve ajrore dhe tokësore,³⁸ si dhe përpjekjen që pikat e nxehta të mbaheshin në karantinë për 14 ditë.³⁹ Konvikti i Studentëve në Prishtinë u shndërrua në një hapësirë karantinimi për persona që kishin kontakte të drejtpërdrejta me persona të infektuar ose të cilët dyshohej se kishin virusin.⁴⁰ Menjëherë pas këtyre mbylljeve, jo më shumë se pesë njerëz lejoheshin të grumbulloheshin në të njëjtin vend, përveç nëse ata jetonin së bashku. Institucionet dhe kompanitë zvogëluan numrin e punonjësve në zyra duke lënë vetëm personelin esencial në ambientet fizike, duke i inkurajuar punonjësit jo-esencial që të punojnë nga shtëpia. Ndërkohë, nga muaji mars, maskat e fytyrës, dezinfektimi dhe distancimi social u bënë masa parandaluese në dalje nga shtëpia. Nga 12 marsi, restorantet dhe kafenetë fillimisht u mbyllën, por më vonë u lejuan të ofrojnë shërbimin “merre me vete”.

Më 15 mars, Kuvendi e miratoi buxhetin për vitin 2020.⁴¹ Ligji për Buxhetin u publikua në gazetën zyrtare dhe u bë publik katër ditë më vonë.⁴² Vonesa në miratimin e buxhetit, e shoqëruar me faktin se asnjë linjë specifike e buxhetit nuk ishte caktuar për reagim të menjëhershëm emergjent ndaj pandemisë, ndikoi në kohën e duhur të reagimit të qeverisë, veçanërisht për komunitat e prekura për herë të parë nga infeksioni më 13 mars.

Më 21 mars, Kryeministri njoftoi se familjet që marrin ndihmë sociale do të marrin transferimet e ndihmës së tyre sociale më herët, 10 ditë para datës së zakonshme të pagesës dhe se kjo pagesë do të ishte e barabartë me pagesat e dy muajve, si një “dhuratë për përfituesit”.⁴³ Më 24 mars, qeveria i ekzekutoi pagesat e parakohshme, të dyfishta për përfituesit e ndihmës sociale⁴⁴, duke konsideruar se ata do të preken më shumë nga kriza.⁴⁵ Buxheti për zbatimin e këtyre pagesave të dyfishta ishte alokuar

³³ Vendimi Nr. 01/08, [Komisioni i Posaçëm për Parandalim të Përhapjes së Coronavirusit \(COVID-19\) në Kosovë](#).

³⁴ Qeveria e Kosovës, [Vendimi nr. 01/11](#), 15 mars 2020.

³⁵ Qeveria e Kosovës, [Vendimi nr. 01/09](#), 13 mars 2020.

³⁶ Qeveria e Kosovës, [Vendimi nr. 01/15](#), 23 mars 2020.

³⁷ [Zyra e Kryeministrit](#), 11 mars 2020.

³⁸ Qeveria e Kosovës, [Vendimi nr. 01/07](#), 11 mars 2020.

³⁹ Qeveria e Kosovës, [Vendimin nr. 01/13](#), 18 mars 2020.

⁴⁰ Po, aty.

⁴¹ [Koha](#), “[Miratohet Ligji për Buxhetin 2020](#)”, 15 mars 2020.

⁴² [Ligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020](#).

⁴³ [Video mesazhi](#) në Facebook i Ish Kryeministrit Kurti për “Shëndetin e Ekonomisë”, 21 mars 2020.

⁴⁴ Ministria e Financave dhe Transfereve, [Vendimi nr. 38/2020](#), 23 Prill 2020, nga MPMS për RrGK.

⁴⁵ [Kallxo](#), “[Rastet sociale përfituan nga dy pagesa por jo edhe pensionistët](#)”; [Ekonomiaonline](#), “[Vendimi i Qeverisë nuk pamundëson marrjen e mjeteve për rastet sociale](#)”.

nga alokimet ekzistuese të mëparshme nën linjën e MPMS të ndihmës sociale. Kjo masë më vonë u përfshi në Pakon Fiskale Emergjente.

Në mes të gjitha pasigurive lidhur me risitë negative të COVID-19, Kosova përjetoi një krizë tjetër më 25 mars, kur qeveria një muajshe mori një votë mosbesimi, pas një mocion të nisur nga partneri i tyre i koalicionit, LDK-ja.⁴⁶ Arsyet kryesore të LDK-së për mocionin e mosbesimit përfshinin mosmarrëveshjet ndërmjet dy palëve në çështjen e heqjes së taksës për produktet e Serbisë dhe shkarkimin e Ministrit të Punëve të Brendshme të LDK-së pa konsultimin paraprak me LDK-në.⁴⁷ Ministri ishte shkarkuar në 18 mars pas deklaratës së tij televizive në një intervistë në lidhje me pandeminë COVID-19, për të cilën Kryeministri Kurti pohoi se përhapte panik midis qytetarëve.⁴⁸ Kryeministri shpjegoi më tej se Ministri i Punëve të Brendshme u shkarkua sepse ai mori anën e Presidentit Hashim Thaqi, i cili kishte kërkuar që qeveria të shpallte gjendjen e jashtëzakonshme.⁴⁹ Kështu që, Qeveria e Kosovës ra, gjoja pjesërisht për shkak të mosmarrëveshjeve mbi reagimin e qeverisë ndaj COVID-19.

Qeveria në detyrë megjithatë miratoi një Pako Fiskale Emergjente më 30 Mars, për të shërbyer si një infuzion i përkohshëm për zbutjen e krizës nga COVID-19.⁵⁰ Kjo pako përfshinte 15 masa, të diskutuara më vonë, në vlerë prej 179,650,000 € që duhej të zbatohen sipas një Plani Operacional të miratuar nga qeveria më 3 prill⁵¹ Pakoja Fiskale Emergjente planifikoi të mbështesë bizneset dhe sektorët publik më të prekur nga kriza.

Ndërkohë që qeveria kishte filluar zbatimin e disa prej masave të Pakos Fiskale Emergjente, më 3 qershor Kuvendi zgjodhi qeverinë e re, të udhëhequr nga Kryeministri Avdullah Hoti.⁵² Qeveria e udhëhequr nga Hoti ndryshoi strukturën e ministrive dhe shërbimit civil, duke përfshirë kthimin e përgjegjësive të disa ministri që kishin ekzistuar para qeverisë së udhëhequr nga Kurti. Më 5 qershor, qeveria e re miratoi Programin e Qeverisë 2020-2023, i cili parashikon një program të rimëkëmbjes ekonomike⁵³

Një nga objektivat e para të qeverisë së re ishte ndryshimi i buxhetit⁵⁴. Mos-ndryshimi i buxhetit, sipas qeverisë, kishte mbajtur peng ekzekutimin e pagesave në lidhje me Pakon Fiskale Emergjente për punëtorët, përfshirë ndihmën për qiratë për bizneset dhe masat e tjera⁵⁵. Ndryshimet e propozuara në buxhet kishin kaluar leximin e parë më 13 korrik, dhe Kuvendi e miratoi këtë projektligj gjatë një seance të jashtëzakonshme më 31 korrik. Ligji i ri Nr. 07 / L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit me Nr. 07 / L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 hyri në fuqi më 7 Gusht⁵⁶ Sipas Ministrisë së Financave, buxheti i ri u zbatua menjëherë⁵⁷.

Në ndërkohë, duke filluar nga 6 korriku, restorantet, baret dhe shërbimet e tjera të gastronomisë duhej të mbylleshin nga ora 21:00 deri në 05:00 deri në një njoftim tjetër.⁵⁸ Një vendim i ri i qeverisë më 25 shtator i lejoi sektorit të gastronomisë punën gjatë ditës, duke respektuar masat parandaluese që përfshinte distancën dy metra në mes tavolinave. Restorantet ende nuk lejoheshin të punojnë nga ora

⁴⁶ Mediat: [Televizioni 21](#), [Deutsche Welle](#); [Gazeta Express](#); dhe [Insajderi](#), 25 mars, 2020.

⁴⁷ Mediat e Kosovës: [Radio Televizioni i Kosovës](#); [Kallxo](#); dhe [Klan Kosova](#), 19 mars 2020.

⁴⁸ [Telegrafi](#), "Deklarata për të cilën u shkarkuar Agim Veliu", 18 mars 2020. He said: "Situata në Kosovë është serioze, numri i të prekurve po rritet nga ora në orë dhe sigurisht institucionet e Kosovës duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet në mënyrë që të parandalojnë këtë pandemi. Unë besoj personalisht jam që të ndërmerren të gjitha masat qofshin ato ekstreme, që të mbrohemi nga ky rrezik"

⁴⁹ [Klan Kosova](#): "Kurti: Koalicioni me LDK-në u prish para shkarkimit".

⁵⁰ Zyra e kryeministrit të Kosovës, [Vendimi Nr. 01/19](#), mars 2020.

⁵¹ Ministria e Financave, [Plani Operacional për Pakon Fiskale Emergjente](#), prill 2020. Këto janë analizuar nga perspektiva gjinore në Kapitujt 3 dhe 4 të këtij raporti.

⁵² [Evropa e Lirë](#), "[Kuvendi voton Qeverinë e re](#)".

⁵³ Qeveria e Kosovës, [Programi Qeverisës 2020-2023](#), 2020.

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ [Epoka e Re](#), [Çfarë parashih rishikimi i Projektligjit të Buxhetit të Kosovës për vitin 2020](#), korrik 2020.

⁵⁶ [Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës](#).

⁵⁷ Intervista me Ministrinë e Financave, shtator 2020.

⁵⁸ Qeveria e Kosovës, [Vendimi nr. 01/10](#), 5 korrik 2020.

23:30 deri në 05:00.⁵⁹ Nga 13 korriku, të gjitha institucionet publike dhe private ishin të detyruara të sigurojnë pajisje mbrojtëse higjienike, të tilla si dezinfektues dhe maska për punonjësit.⁶⁰ Maskat e fytyrës dhe masat e distancimit social u bënë të detyrueshme për personat të cilëve u lejohet të largohen nga shtëpitë e tyre dhe për të gjitha institucionet publike, përfshirë policinë, ndërsa moszbatimi i këtyre masave rezultoi me ndëshkime.⁶¹

Më 22 korrik, qeveria e re e udhëhequr nga Hoti miratoi Projektligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike - COVID-19, duke e proceduar atë në Kuvend.⁶² Në gusht, Kryeministri Hoti njoftoi se nga shtatori, qeveria do të fillonte zbatimin e planit ekonomik afatgjatë, duke zhvilluar strategji pesë-vjeçare me vlerë deri në 6 miliardë € për të rimarrë dëmet ekonomike të shkaktuara nga COVID-19.⁶³ Menjëherë pas kësaj, më 13 gusht, qeveria e re miratoi Planin e saj për zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike, që parashihte 15 masa për të cilat do të diskutohet më vonë⁶⁴. Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike rridhte nga Programi i Qeverisë së Kosovës për vitet 2020-2023⁶⁵. Plani shumëvjeçar prej 365 milion eurosh (ekuivalent me 14% të buxhetit total të ndryshuar për vitin 2020) synonte të forconte sektorët ekonomikë dhe socialë gjatë rimëkëmbjes⁶⁶. Një ditë më vonë, Kuvendi diskutoi për herë të parë për Projektligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike⁶⁷ Ligji kërkonte të plotësohen dhe ndryshohen disa ligje, në drejtim të rimëkëmbjes ekonomike⁶⁸. Pasi dështoi gjashtë herë ta votojë atë në leximin e tij të parë, për shkak të mungesës së kuorumit, Kuvendi e kaloi këtë projektligj në leximin e parë në 12 tetor⁶⁹; Ligji u miratua në leximin e dytë më 4 dhjetor dhe hyri në fuqi më 7 dhjetor.⁷⁰

Një ligj tjetër i rëndësishëm për të adresuar COVID-19 gjithashtu kishte udhëtim të gjatë para se të miratohej. Më 15 prill, Kryetarja e Kuvendit propozoi atë që përfundimisht do të bëhej Ligji Nr. 09 / L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës, por Kuvendi nuk e miratoi atë deri më 14 gusht.⁷¹ Partitë politike nga dy partitë në pushtet ashtu edhe nga opozita vonuan miratimin e Ligjit sepse nuk ishin dakord me aspektet e tij.⁷² Ligji hyri në fuqi që nga 25 gushti. Ky Ligj ishte propozuar pasi që Zyra e Presidentit të Kosovës kërkoi më 24 mars që Gjykata Kushtetuese të rishikojë vendimin e qeverisë në detyrë që kufizonte lëvizjen, duke pretenduar se ato vendime shkelnin të drejtat kushtetuese. Vendimet e qeverisë në detyrë në lidhje me kufizimet e lëvizjeve që rrjedhin nga Ligji për Sëmundjet Ngjithëse dhe Ligji për Shëndetësinë.⁷³ Gjykata vendosi se ligjet e sipërpërmendura nuk autorizojnë qeverinë të kufizojë të drejtat dhe liritë kushtetuese (p.sh., kufizimin e lëvizjes).⁷⁴ Gjykata Kushtetuese sqaroi se qeveria nuk mund të kufizojë asnjë të drejtë themelore dhe liri përmes vendimeve përveç nëse një kufizim i së drejtës përkatëse bëhet nga Kuvendi përmes një ligji. Me 6 prill, Gjykata caktoi datën 13 prill për hyrjen në fuqi të këtij aktgjykimi, që shfuqizonte

⁵⁹ Qeveria e Kosovës, [Vendimi nr. 01/03, 25 shtator 2020](#).

⁶⁰ REL, ["Qeveria e Kosovës: Maskat janë obligative, teste negative për qytetarët e vendeve fqinje"](#), 13 korrik 2020.

⁶¹ Qeveria e Kosovës, [Vendimi Nr. 11/09, 1 korrik 2020](#).

⁶² Zyra e Kryeministrit të Kosovës, [Vendimi Nr. 01/15 Projektligji për Rimëkëmbjen Ekonomike - Covid-19](#), korrik 2020.

⁶³ *Ekonomia Online*, [Hoti: Në shtator fillon plani afatgjatë i rimëkëmbjes ekonomike](#), 20 August 2020.

⁶⁴ Zyra e Kryeministrit, [Plani për zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike; Qeveria e Kosovës, Njoftim për miratimin e Planit për zbatimin e rimëkëmbjes ekonomike](#), gusht 2020.

⁶⁵ Zyra e Kryeministrit, [Programi Qeverisë 2020-2023](#).

⁶⁶ *Koha Ditore*, [Miratohet plani për zbatim të rimëkëmbjes ekonomike, vlera 365 milion euro](#), gusht 2020.

⁶⁷ Kuvendi i Kosovës, [Transkripti i seancës së mbajtur më 14 gusht 2020](#)

⁶⁸ Kuvendi i Kosovës, [Projektligji për Rimëkëmbjen Ekonomike](#).

⁶⁹ *Kallxo*, [Pas gjashtë tentimeve, votohet në parim Projektligji për rimëkëmbjen ekonomike](#), 12 tetor 2020.

⁷⁰ *Gazeta Zyrtare*, [Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike-COVID-19](#). Ligji është i vlefshëm deri më 31 dhjetor 2021, megjithëse klauzolat mbi pensionet dhe Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, të diskutuara në një kapitull të mëvonshëm, do të qëndrojnë në fuqi deri më 31 Dhjetor 2028.

⁷¹ Kuvendi i Kosovës, [Kuvendi miratoi Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës](#), gusht 2020. Ligji nr. 09/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e COVID-19 në Republikën e Kosovës, neni 2, gusht 2020.

⁷² *Koha Ditore*, ["Edhe pse u miratua në lexim të parë ligji kundër pandemisë, pozita e opozita kanë vërejtje."](#)

⁷³ *Gazeta Zyrtare*, [Ligji Nr. 04/L-15 and Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësinë](#).

⁷⁴ Siç parashihet në nenet 35, 36 dhe 43 të Kushtetutës në nivelin e tërë Republikës së Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës pa përjashtim.

Rrjedha kohore e përhapjes së COVID-19 dhe reagimi i qeverisë

- 27 shkurt ● Ministria e Shëndetësisë themelon Komitetin për Koordinim dhe Vlerësim të Situatës Emergjente me COVID-19
- 12 mars ● Propozohet Projektligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës
- 12 mars ● Themelohet Komisioni i Posaçëm për Parandalimin e Përhapjes së Koronavirusit (COVID-19) në Kosovë. Merren masat e para për parandalimin e COVID-19: mbyllja e shkollave, restoranteve, transportit ndër-urban dhe fluturimeve ndërkombëtare
- 13 mars ● Paraqiten dy rastet e para me COVID-19 në Kosovë
- 14 mars ● Projektligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës miratohet në leximin e parë
- 15 mars ● Ligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës miratohet në leximin e dytë
Qeveria shpall gjendjen Emergjente të Shëndetit Publik
- 19 mars ● Miratohet Ligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës
- 24 mars ● Qeveria bën pagesat “e dyfishta” për përfituesit e ndihmës sociale
- 25 mars ● Kuvendi miraton mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë
- 30 mars ● Miratohet Pakoja Fiskale Emergjente
- 3 prill ● Miratohet Plani Operacional për Pakon Fiskale Emergjente
- 15 prill ● Propozohet Projektligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19
- 5 maj ● Miratohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023
- 3 qershor ● Zgjidhet qeveria e re nga ana e Kuvendit
- 22 korrik ● Projektligji për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID-19 miratohet nga qeveria
- 7 gusht ● Miratohet Ligji Nr. 07/L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit me Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020
- 13 gusht ● Miratohet plani për zbatimin e Programit për Rimëkëmbje Ekonomike (15 masa)
- 14 gusht ● Miratohet Ligji Nr. 09/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës
- 18 shtator ● Miratohet rishikimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2021-2023
- 5 tetor ● 10 milion euro shpërndahen në 38 komuna për rimëkëmbjen e tyre ekonomike
- 12 tetor ● Leximi i parë i Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike - COVID-19 pas gjashtë tentimeve të dështuara për shkak të mungesës së kuorumit
- 30 tetor ● Qeveria miraton Projektligjin mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2021
- 12 dhjetor ● Leximi i dytë i Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike - COVID-19 dështon të kalojë në parlament për shkak të mungesës së kuorumit
- 4 dhjetor ● Ligji nr. 07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike- COVID-19- miratohet

Vendimin e qeverisë.⁷⁵ Prandaj, nevojitet një ligj i ri për parandalimin dhe luftimin e pandemisë. Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 përcaktoi përgjegjësitë dhe rolet e institucioneve shtetërore, institucioneve shëndetësore publike, private dhe publiko-private në marrjen e masave për parandalimin, kontrollin, trajtimin, monitorimin, sigurimin e financimit dhe ndarjen e përgjegjësive gjatë pandemisë COVID-19. Ai gjithashtu përcakton masat dhe ndëshkimet për shkeljet e rregullave, vendimeve dhe udhëzimeve të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2021-2023 u nënshkrua më 20 prill 2020 dhe u rishikua më vonë për të pasqyruar ndryshimet makroekonomike të parapara që ndodhën si pasojë e pandemisë.⁷⁶ KASH ka për qëllim të ofrojë një analizë të ndryshimeve makroekonomike, si dhe krijimin e një baze për planifikimin e buxhetit për vitet e ardhshme. Vendimi për të rishikuar KASH është nënshkruar më 18 Shtator.⁷⁷ Ministria e Financave përdori KASH-in për të arsyetuar rishikimet e buxhetit.

Drejtorët e buxhetit dhe financave në ministri dhe komuna të ndryshme deklaruan se rishikimet dhe modifikimet e planifikuara të buxheteve u bënë në periudhën në mes të fundit të marsit dhe fillimit të qershorit.⁷⁸ Tre deklaruan se ata implementuan buxhete të modifikuara, duke filluar në prill, ndërsa tre filluan zbatimin e ndryshimeve në muajin gusht. Kështu, koha kur organet qeveritare filluan të zbatojnë ndryshimet në buxhetin e tyre për të adresuar COVID-19 duket se ka qenë e ndryshme, me ndryshimet më të hershme që ndodhën në muajin prill.

Përveç masave të marra nga qeveria, katër nga komunat e intervistuar miratuan pakot e stimulimit ekonomik emergjente deri në mes të muajit maj 2020 (Prishtina, Drenasi, Ferizaj dhe Hani i Elezit).⁷⁹ Dy komuna (Podujeva, Lipjani) miratuan masa të pjeshme ekonomike, siç janë përjashtimi i bizneseve nga taksat komunale.⁸⁰

Në përgjithësi, ekziston pak informacion në lidhje me atë se kur kanë arritur fondet në lidhje me masat e sipërpërmendura tek përfituesit, megjithëse të anketuarit raportuan për vonesa në marrjen e fondeve.⁸¹ Vonesat në rishikimet dhe miratimet e buxhetit, të shoqëruara me hutinë midis ministrive dhe komunave në lidhje me fondet rezervë që ato mund t'i aplikojnë, kontribuan edhe më tutje në vonesa.⁸²

Vonesat në pagesa kontribuan në hutinë midis përfituesve të mundshëm. Ndër arsytet e vonesave ishte se verifikimi gjithashtu mori kohë, duke pasur parasysh numrin e madh të aplikacioneve për asistencë. Institucioneve iu desh të harxhojnë kohë shtesë që të rishikojnë aplikacionet për të siguruar që përfituesit individualë të mos i keqpërdorin masat, në mënyrë që të mos aplikojnë dy herë për masa të ndryshme, edhe pse kjo nuk lejohet.⁸³ Në disa raste, përfituesit bënë gabime kur plotësuan aplikacionet, gjë që shkaktoi vonesa në qasjen e tyre në masat mbështetëse.⁸⁴

Ndërkohë, institucionet përkatëse si qendrat e mirëqenies sociale funksionojnë me kapacitete të kufizuara të personelit midis masave të izolimit; kjo kontribuoi në vonesa të mëtejshme për shkak të mungesës së burimeve njerëzore për të procesuar kërkesat.⁸⁵ Procedurat e zgjatura dhe vonesat në

⁷⁵ Gjykata Kushtetuese, [Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës](#), të 23 marsit 2020.

⁷⁶ Ministria e Financave, [KASH 2021-2023](#), shtator 2020.

⁷⁷ Zyra e Kryeministrit të Kosovës, [Vendimi Nr. 01/27](#), prill 2020.

⁷⁸ Intervistat e RrGK-së.

⁷⁹ Intervistat e RrGK-së. Komuna shtesë mund të kenë bërë ndryshime, por jo të gjitha komunat iu përgjigjën kërkesave për intervistë, përkundër disa përpjekjeve.

⁸⁰ Instituti GAP, ["Ndikimi i Pandemisë COVID-19 në Pushtetin Lokal"](#), maj 2020.

⁸¹ Intervistat e RrGK-së.

⁸² Këto diskutohen më vonë në raport.

⁸³ Intervistat e RrGK-së.

⁸⁴ Intervistat e RrGK-së.

⁸⁵ Intervistat e RrGK-së.

disbursimin e fondeve e bënë të vështirë për kompanitë e prekura nga COVID-19 që të përfitojnë nga masat e Pakos Fiskale Emergjente.⁸⁶ Institucionet përgjegjëse i atribuon vonesat te aplikantët që ngarkuan në sistem të dhëna në mënyrë të gabuar gjatë aplikimit.⁸⁷ Prandaj, vonesat ndodhën në procesin e ri-aplikimit dhe verifikimit të të dhënave.⁸⁸ Problemet e buxhetit gjithashtu kontribuan drejtpërdrejt në vonesa.⁸⁹ Ndryshimet dhe ndarjet buxhetore ishin të nevojshme për të mundësuar ekzekutimin ligjor të pagesave të mbetura për përfituesit e paraparë të Pakos Fiskale Emergjente. Kështu, deri në miratimin e ligjit të ndryshuar për buxhetin në muajin gusht,⁹⁰ ministrinë dhe komunat u përballën me sfida për të pasur financim të mjaftueshëm për të zbatuar masat e Pakos Fiskale Emergjente.

Kur u pyetën nëse ata kishin një buxhet të alokuar për adresimin e COVID-19, 21 zyrtarë të financave të intervistuar në komuna dhe ministri të ndryshme thanë se ata kanë alokuar fonde duke modifikuar buxhetet e tyre ekzistuese, përfshirë ri-programimin dhe alokimin e parave nga kategoritë ekzistuese të buxhetit, të diskutuara në kapitullin e rradhës.

Përfundimi

Në përgjithësi, Kosova nuk ishte e përgatitur sa duhej për çdo emergjencë, duke pasur parasysh paqëndrueshmërinë e saj më të gjerë politike dhe kufizimin e jashtëzakonshëm të para-alokimeve buxhetore ekzistuese për këtë qëllim. Reagimi fillestar i qeverisë ndaj COVID-19 ishte me kohë.⁹¹ Qeveria ndërmoi disa masa edhe para se të raportoheshin rastet e para, dhe Plani Operacional për Pakon Fiskale Emergjente u miratua disa javë pas rasteve të para. Sidoqoftë, implementimi i këtij Plani dhe shpërndarja e fondeve tek përfituesit u vonua. Rënia e qeverisë, kriza politike që pasoi, vonesat e ndërlikdhura në rishikimet dhe aprovimet e buxhetit dhe dështimi i Kuvendit të Kosovës për të vendosur kuorumin ose për t'u dakorduar për propozimet, të gjitha kontribuan në reagim të vonuar. Veprimi i kufizuar u ndërmor nga prilli deri në gusht kur më në fund u miratuan ndryshimet e buxhetit, duke mundësuar ndryshimet e buxhetit të nevojshme për zbatimin e masave të parashikuara. Përgjigja afatmesme për atë afatgjatë ndaj COVID-19 nuk u miratua deri në dhjetor.

⁸⁶ Bota Sot, "[Bizneset po rrezikohen nga vonesat në zbatimin e pakos Fiskale Emergjente](#)", qershor 2020.

⁸⁷ Intervistat e RrGK-së

⁸⁸ Epoka e Re, "[Bislimi sqaron vonesat e disa pagesave nga pakoja Fiskale Emergjente](#)", maj 2020

⁸⁹ Insajderi, "[Rishikimi i buxhetit – ja çfarë përfitojnë qytetarët](#)".

⁹⁰ Gazeta Ekonomia, "[Miratohet në lexim të parë rishikimi i buxhetit të Kosovës](#)".

⁹¹ Megjithëse mënyra se si kjo përgjigje synonte të ndikonte tek gratë dhe burrat, përfshirë ata brenda grupeve të marginalizuara, nuk u muar parasysh kur planifikohet dhe hartohet kjo përgjigje, siç diskutohet në një kapitull të mëvonshëm.

PËRGJEGJËSIA E QEVERISË NË RIALOKIMET E BUXHETIT PËR TË ADRESUAR COVID-19

Ky kapitull analizon aspektet e përgjegjësive së qeverisë kur bën rialokimet e buxhetit për të adresuar COVID-19, bazuar në dimensionin 2.3. Ky dimension gjithashtu lidhet me shpenzimet nga rezervat e paparashikuara në kohë krize.⁹² Pas shqyrtimit të përdorimit të rezervave të paparashikuara, kapitulli diskuton procesin e rialokimeve, miratimet e rialokimeve dhe arsyetimet e dhëna, përfshirë nga perspektiva gjinore, siç inkurajohet nga MPGjFP. Në fund, ai ofron një përmbledhje të burimeve të ndryshme të financimit të alokuara për adresimin e pandemisë COVID-19 në Kosovë.

Përdorimi i rezervës për rastet e paparashikuara

Rishikimi i përdorimit të rezervave për raste të paparashikuara dhe procesi përmes të cilit qeveritë sigurojnë miratimin për përdorimin e buxheteve për raste të paparashikuara, i diskutuar në këtë seksionin, është i rëndësishëm për SHPPF PI-18.4, “Rregullat për përshtatjen e buxhetit nga ana e ekzekutivit”. Gjithashtu, PI-18, “Kontrolli legjislativ i buxheteve”, në përgjithësi merr në konsideratë shkallën deri në të cilën legjislativi shqyrtton, debaton dhe miraton buxhetin vjetor, duke përfshirë shkallën deri në të cilën procedurat e legjislativit për shqyrtim janë vendosur dhe respektuar, siç diskutohet në nën-seksionin tjetër. MPGjFP – 9 për shqyrtimin legjislativ të ndikimeve gjinore të buxhetit përdoret për të vlerësuar shkallën në të cilën ligjvënësi shqyrtton me kujdes buxhetin vjetor nga perspektiva gjinore

Çdo vit, Kosova planifikon buxhete për menaxhimin e krizave në mbarë vendin. Ky fond menaxhohet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI). Në situata emergjente, aktivizohet nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në Ligjin fillestar të Ndarjeve Buxhetore për vitin 2020, ky fond arriti në 1.2 milion euro; më vonë, ajo u ndryshua në 4.2 milion euro.⁹³

Tutje, Qeveria e Kosovës planifikon një fond për raste të paparashikuara në Ministrinë e Financave çdo vit; qëllimi i tij është që të përmbushen shpenzimet urgjente apo shpenzimet e paparashikuara të qeverisë. Ky fond kishte vlerën 36.7 milion € në Ligjin fillestar të Ndarjeve Buxhetore për vitin 2020, i miratuar në mars. Në ligjin e miratuar në muajin gusht për ndryshimin dhe plotësimin e buxhetit, ky fond kishte shumë prej 53 milion eurove; ai është në linjën e buxhetit të Shpenzimeve Kapitale të Ministrisë së Financave.⁹⁴

Sidoqoftë, Ministria e Financave qartësoi në korrespondencë të shkruar më vonë se fondi i paparashikimit para ndryshimit të buxhetit arriti në 29.95 milion € në total, i përbërë nga:

- 177,945 € për MPMS, 6,230,000 € për Ministrinë e Shëndetësisë;
- 500,000 € për komunën e Preshevës, Bujanovc dhe Medvegje me Vendimin e Qeverisë Nr. 09/26;

⁹² SHPPF, [Korniza për vlerësimin e menaxhimit publik të financave](#), 2016.

⁹³ Ligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, mars 2020; dhe Ligji Nr. 07/L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. No. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, gusht 2020.

⁹⁴ [Ligji Nr. 07/L-014](#) Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020. Kjo linjë e buxhetit financohet përmes klauzolës së Investimeve dhe Kreditimit, e cila i mundëson Qeverisë që të financojë projekte kapitale me interes publik mbi 2% deficit të Bruto Produktit Vendor, nëse projektet e tilla financohen nga Institucionet Ndërkombëtare Financiare dhe Agjencitë e Zhvillimit. Ishte e paqartë në dokumentin e ndryshuar të buxhetit se për çfarë qëllimi janë planifikuar të shpenzohen këto fonde.

- 10,900,000,000 € për zbatimin e Pakos Emergjente Fiskale me Vendimin 01/19 Ndryshuar dhe Plotësuar me Vendimin Nr. 06/25 të datës 17 prill 2020;
- 151,299.95 € për Thesarin mbi detyrimet e Lotarisë së Kosovës me Vendimin e Qeverisë Nr. 04/37; dhe
- 12,000,000 për Ministrinë e Tregtisë për zbatimin e Pakos Emergjente Fiskale me Vendimin Nr. 04/39 Ndryshuar dhe Plotësuar me Vendimet Nr. 06 / 25 të datës 17 prill 2020⁹⁵.

Fondi i paparashikuar i MF-së, pas rishikimit të buxhetit, arriti në 13,000,000 € me Vendimin e Qeverisë Nr. / 10/34, të destinuar për rimëkëmbjen e ekonomisë.⁹⁶

Në përgjithësi, mes ngjarjeve të paparashikuara, zyrtarët e financave mund të aplikojnë në Ministrinë e Financave për lëshimin e buxhetit për raste të paparashikuara dhe Ministri autorizoi “shpenzimet nga përvetësimi i paparashikuar me miratimin paraprak me shkrim të Qeverisë”, sipas nenit 29 të Ligjit Nr. 03 / L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë.⁹⁷

Këtë vit, më 28 shkurt, qeveria mori një vendim për të alokuar një buxhet prej 400,000 eurove nga Ministria e Financave për Ministrinë e Shëndetësisë për parandalimin e pandemisë COVID-19, në linjën e saj të “Shpenzimeve të Paplanifikuara” në kategorinë e shpenzimeve të rezervës.⁹⁸ Përveç kësaj, gjatë intervistave, vetëm MASHT raportoi se aplikonte për këto fonde deri në fund të marsit, për mbështetjen e programeve të mësimin në internet.⁹⁹ Bazuar në informata prej intervistave të RrGK, në fillim komunat nuk duket se kanë aplikuar për fondet për raste të paparashikuara të Ministrisë së Financave.

Buxheti fillestar i Kosovës i vitit 2020 përmban fjalën “kontigjencë” (rezervë për raste të paparashikuara) 23 herë, në lidhje me rezervën qeveritare të menaxhuar nga Ministria e Financave, dhe po ashtu me shpenzime të paparashikueshme për “projekte të paspecifikuara 2017-2019,” për shkak të nënperformancës së ndërmarrjeve publike. Mbase duke pasur parasysh mungesën e përgjithshme të linjave buxhetore për “kontigjencë” për organizatat tjera buxhetore në buxhetin e Kosovës, intervistat me zyrtarët e financave duket se sugjerorin se disa nga ta nuk e kuptonin se çfarë ishte “kontigjencë”. Përkundrazi, ata kishin prirjen t’u referoheshin “rezervave” ose “suficitit” të tyre. Zyrtarët komunalë nuk aplikuan për lëshim e fondit rezervë të Ministrisë së Financave sepse ata zgjodhën që të përdorin fondet e mbetura nga linjat e tjera buxhetore; kjo mundësoi një reagim më të menjëhershëm që nuk kërkonte pritjen e miratimit nga ana e kabinetit qeveritar dhe Ministria e Financave për lëshimin e fondeve rezervë.

Në Ligjin fillestar të Buxhetit për vitin 2020, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS), Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme, kishin linja të përgjithshme të buxhetit për raste të paparashikuara apo emergjente. Gjashtë komuna (15%) kishin një linjë buxhetore për “Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore”;¹⁰⁰ dhe tri (8%) kishin një “fond emergjent”.¹⁰¹ Këto fonde zakonisht janë nën linjën buxhetore “Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencat”. Në përgjithësi, zyrtarët komunalë janë të prirë të thonë se ata nuk mund të përfshijnë linja të tilla të jashtëzakonshme ose të paparashikuara të buxhetit në buxhetet

⁹⁵ Korrespondencë me Ministrinë e Financave, 16 Dhjetor 2020.

⁹⁶ Po, aty.

⁹⁷ Po, aty; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, [Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë](#), neni 29 për Shpenzimet e paparashikuara, 2008. Neni 30 regullon se si mund të bëhën rialokimet.

⁹⁸ Qeveria e Kosovës, Vendimi Nr. 07/04, 28 shkurt 2020.

⁹⁹ Intervista e RrGK-së. RrGK kërkoi informacion nga Ministria e Financave nëse organizatat e tjera buxhetore kanë aplikuar, por ende nuk ka marrë përgjigje.

¹⁰⁰ Komunat: Shtime, Mitrovicë, Zveçan, Kamenicë, Vushtrri, dhe Kaçanik

¹⁰¹ Komunat: Hani i Elezit, Klina, dhe Suhareka.

e tyre për shkak të fondeve të kufizuara që ata marrin si komuna. Në mesin e komunave që kishin linja të tilla buxhetore, disa zyrtarë të financave thanë se ata përdorën disa nga këto fonde për të adresuar pandeminë;¹⁰² të tjerët jo. Si dhe nëse janë përdorur linja të tilla buxhetore varet nga nevojat e komunës së caktuar. Disa nga këto linja buxhetore në fakt u zvogëluan në buxhetin e ndryshuar për vitin 2020 (Shih Tabelën 1).

Tabela 1. Buxheti fillestar dhe i ndryshuar i “Emergjencës” në dispozicion për të adresuar COVID-19

Organizatrat buxhetore	Emri i Linjës Buxhetore	Buxheti original 2020	Buxheti i ndryshuar 2020
Ministria e Financave	Shpenzimet Kapitale (të paparashikuara)	36.7 milionë €	53 milionë €
Ministria e Punëve të Brendshme	Agjencia e Menaxhimit Emergjent	1.2 milionë €	€4.2 milionë
Komuna e Hanit të Elezit	Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencat (Fondi i Emergjencave)	10,000 €	10,000 €
Komuna e Suharekës	Fondi Emergjent	55,000 €	55,000 €
Komuna e Klinës	Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencat (Fondi i Emergjencave)	20,000 €	0 €
Komuna e Shtimes	Shërbimet Publike, Emergjencat e Mbrojtjes Civile (Menaxhimi i Fatkeqësive Natyrore)	21,674 €	21,674 €
Komuna e Mitrovicës	Shërbimet Publike, Emergjencat e Mbrojtjes Civile (Menaxhimi i Fatkeqësive Natyrore)	155,162 €	153,886 €
Komuna e Zveçanit	Shërbimet Publike, Emergjencat e Mbrojtjes Civile (Menaxhimi i Fatkeqësive Natyrore)	10,613 €	10,928 €
Komuna e Kamenicës	Shërbimet Publike, Emergjencat e Mbrojtjes Civile (Menaxhimi i Fatkeqësive Natyrore)	73,000 €	73,000 €
Komuna e Vushtrrisë	Shërbimet Publike, Emergjencat e Mbrojtjes Civile (Menaxhimi i Fatkeqësive Natyrore)	90,250 €	87,170 €
Komuna e Kaçanikut	Shërbimet Publike, Emergjencat e Mbrojtjes Civile (Menaxhimi i Fatkeqësive Natyrore)	10,000 €	0 €

Me qëllim të financimit të rritjes së buxhetit, disa zyrtarë të financave rialokuan sifcitet e buxhetit nga linjat e tjera të buxhetit për të adresuar pandeminë¹⁰³ siç lejohet nga ligji burimor si dhe ai i ndryshuar për buxhetin¹⁰⁴. Zyrtarët komunalë të financave përdorën fondet e mbetura, pasi transferimet e buxhetit duhet të aprovoheshin vetëm nga kuvendi i tyre komunal¹⁰⁵. Më 3 prill, Ministria e Financave caktoi kodin buxhetor 00099 për të ndjekur buxhetet dhe shpenzimet që lidhen me pandeminë COVID-19 brenda sistemit të Llogarisë së Vetme të Thesarit (LIVTh). Kjo u mundësoi komunave të raportojnë shpenzimet e rialokuara nga kategoria ekonomike të pagave dhe mëditjeve, ndër të tjera, pa kërkuar ndonjë miratim të mëtejshëm nga Ministria. Komunave megjithatë u duheshin miratimet nga kuvendet e tyre komunale.

¹⁰² Për shembull, sipas LIVTh-së, Komuna e Zveçanit përdori 315 € nga ky fond, dhe Ferizaji 44,626 nga “shërbimet publike emergjencat e mbrojtjes civile” për adresimin e COVID-19.

¹⁰³ Intervistat e RrGK-së.

¹⁰⁴ Ligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, mars 2020, neni 6; dhe Ligji Nr. 07/L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, gusht 2020, neni 5. Neni 5 parasheh: “Rezerva në buxhetet komunale, me vendim të Ministrit mund të bartet tek kategoria e pagave dhe shtesave, në varësi nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik. Në rast të situatës kur kjo nuk është e nevojshme, rezerva e tillë buxhetore me aprovim të Ministrit mund të bartet te të gjitha kategoritë e shpenzimeve me përjashtim të kategorisë së pagave dhe shtesave, sipas kërkesës dhe vendimit të Kuvendit të Komunës”.

¹⁰⁵ Po aty, fq. 6 dhe 2. Ligji për menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Neni 30. Ligji për Ndarjet buxhetore për vitin 2020, neni 15.

Fondet e rialokuara rrjedhën kryesisht nga suficitet buxhetore në kategorinë ekonomike të pagave dhe mëditjeve. Më herët, më 2019, ndryshimet e propozuara në Ligjin nr. 06/ L-111 për Pagat në Sektorin Publik kishin parashikuar një rritje në pagat për punonjësit e sektorit publik.¹⁰⁶ Kështu, buxheti fillestar i vitit 2020 kishte përfshirë fonde për të paguar për këtë rritje të pagave. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese vendosi që ky Ligj ishte jo-kushtetues pasi që shkelte pavarësinë e gjyqësorit,¹⁰⁷ sepse nuk lejonte kompetencën vetërregulluese në zbatimin e pavarësisë funksionale, organizative dhe buxhetore të gjyqësorit. Meqenëse ndryshimet e propozuara në Ligjin për Pagat nuk ishin miratuar, tashmë fondet e buxhetuara nuk mund të përdoren për një rritje në pagat e sektorit publik, kështu që disa komuna i përdorën këto fonde tashmë të buxhetuara për të adresuar pandeminë. Zyrtarët shprehën kënaqësinë që, për fat të mirë, që ata i kishin këto fonde të pashpenzuara.¹⁰⁸ Pa këto fonde, komunat thanë se nuk do të kishin pasur fonde për të adresuar pandeminë COVID-19.

Është interesante se buxheti i ndryshuar për vitin 2020 nuk përmban ndonjë linjë të veçantë buxhetore për adresimin e COVID-19, dhe kodi 00099 i LIVTh thjesht ndjek buxhetet dhe shpenzimet.¹⁰⁹ Duke përdorur këtë kod, shpenzimet në lidhje me adresimin e COVID-19 mund të monitorohen përmes sistemit të thesarit. Nga 30 shtatori, shpenzimet sipas këtij kodi buxhetor arritën në 143 milion euro, që arrin gjithsej 5.5% të buxhetit të përgjithshëm të ndryshuar për vitin 2020.¹¹⁰

Miratimi dhe Arsyetimi i Rialokimeve

Në përgjithësi, treguesi SHPPF PI-21, “Parashikueshmëria e alokimit të burimeve brenda vitit”, merr parasysh shkallën në të cilën ministria qendrore e financave e një vendi është në gjendje të parashihet zotimet dhe kërkesat e parave të gatshme dhe të sigurojë informacion të besueshëm mbi disponueshmërinë e fondeve për njësitë buxhetore për ofrimin e shërbimeve.¹¹¹ SHPPF PI-21.4, “Rëndësia e përshtatjeve buxhetore brenda vitit”, i referohet masës në të cilën buxheti mund të modifikohet pasi të jetë miratuar. Kufizimet ligjore në rregullimet e buxhetit pas miratimit nga parlamenti ose kuvendi komunal, përkatësisht, sigurojnë kontrollin dhe ekuilibrin mbi ekzekutivin duke siguruar që përdorimi i buxhetit të shtetit nga ekzekutivi të mbetet besnik për shpenzimet e miratuara nga parlamenti apo kuvendi.

Në Kosovë, organizatat buxhetore mund të rialokojnë deri në 5% të buxhetit të tyre pa miratim paraprak nga Ministria e Financave, “me kusht që të mos bëhet asnjë transfer i tillë në ndarjet e pagave dhe mëditjeve pa miratimin e Ministrit dhe, nëse është e zbatueshme, nga Qeveria apo Kuvendi”.¹¹² Për shumën që tejkalojnë 5%, nevojitet miratimi nga Ministria e Financave. Për shumën që tejkalojnë 15%, Ministri i Financave do të duhet të kërkojë miratimin me shkrim nga qeveria, ndërsa për shumën që tejkalojnë 25%, miratimi duhet të kërkojë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.¹¹³ Vetëm Ministria e

¹⁰⁶ Ligji Nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik. Veçanërisht, sipas ligjit, kjo duhet të bazohet në mundësi të barabarta, merita, integritet dhe mos-diskriminim në baza gjinore dhe të përkatësisë etnike.

¹⁰⁷ Shefkriu, A., *Pezullohet Ligji i Pagave, nuk ka paga me rritje për tre muaj*, KALLXO, 2019.

¹⁰⁸ Intervistat e RrGK-së.

¹⁰⁹ Për një krahasim të buxhetit origjinal dhe të ndryshuar për vitin 2020, shih [Shtojcën 6](#).

¹¹⁰ Llogaria e Vetme e Thesarit, Raporti nëntë-mujor, 2020.

¹¹¹ SHPPF, Korniza për vlerësimin e menaxhimit publik të financave.

¹¹² Ligji No. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 30, fq. 22.

¹¹³ Po aty, neni 30, par. 1: “ Një organizatë buxhetore mundet, pa marrjen e miratimit paraprak nga Ministri, të transferojë deri në pesë për qind (5%) të një ndarje buxhetore në një ndarje tjetër të asaj organizate buxhetore gjatë vitit fiskal; Nëse udhëheqësi i organizatës buxhetore, kërkon nga Ministri që të autorizojë transferimin e një shume që është më e madhe se pesëmbëdhjetë për qind 15 %, por më e vogël se njëzet e pesë për qind 25 % e ndarjes së ndikuar negativisht, atëherë Ministri mund të autorizojë një transfer të këtillë vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga Qeveria. Ky ligj zbatohet edhe për komunat edhe për ministrinë.

Shëndetësisë, e cila ka rialokuar 12%,¹¹⁴ duket se kishte nevojë për miratim nga Ministria e Financave. Në mënyrë që të adresojnë pandeminë, zyrtarët e financave modifikuan buxhetet komunale për më pak se 5%¹¹⁵. Zyrtarët komunalë të financave të intervistuar thanë se ata iu dërguan modifikimet e propozuara të buxhetit asambleve të tyre komunale. Ata nuk kishin nevojë të dërgonin rishikimet e propozuara në Ministrinë e Financave ose Kuvendin e Kosovës, pasi që rialokimet e propozuara përbënin më pak se 5% të buxheteve të tyre.¹¹⁶ Prandaj, indikator 9 i MPGjFP për shqyrtimin legjislativ të ndikimeve gjinore të buxhetit nuk u zbatua pasi legjislatura nuk i shqyrtoi këto rialokime të veçanta. Edhe pse me rëndësi, ekzaminimi se deri në çfarë mase kuvendet komunale i rishikuan ndryshimet nga një perspektivë gjinore ishte përtej këtij hulumtimi.

Analiza e ndikimit gjinor dhe dokumentacioni i përgjegjshëm gjinor i arsytiveve për rialokimet

Sipas MPGjFP I, analiza e ndikimit gjinor duhet të informojë propozimet e politikave buxhetore, përfshirë arsyetimet e vendosura për rialokimet e propozuara të buxhetit. Përveç kësaj, sipas MPGjFP 4, dokumentacioni i propozimeve të buxhetit, duke përfshirë arsyetimet për propozimet e rishikuara të buxhetit, duhet të jetë i përgjegjshëm gjinor.¹¹⁷ Siç u përmend, në përputhje me Ligjin e Kosovës për Barazinë Gjinore,¹¹⁸ praktikat më të mira në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe kërkesat e qeverisë për Vlerësimet e Ndikimit Rregullator përfshirë Vlerësimet e Ndikimit Gjinor¹¹⁹, të gjitha politikat, programet dhe buxhetet duhet të informohen *ex ante* nga analiza gjinore paraprake. Rrjedhimisht, kjo do të përfshinte arsytive për rialokimet e buxhetit në lidhje me COVID-19.

Për shkak të urgjencës së situatës, zyrtarët e financave të intervistuar thanë se ata nuk kishin kryer vlerësime të hollësishme të ndikimit rregullator ose vlerësime të ndikimit gjinor. Për më tepër, përgjigjet e intervistave sugjeruan që zyrtarët e financave duket se nuk e kuptuan se çfarë është Vlerësimi i Ndikimit Rregullator, e lëre më nevojën për të kryer vlerësime *ex ante* të Ndikimit Gjinor.¹²⁰ Kështu që, ndoshta jo çuditërisht, përzgjedhja e arsytiveve për rialokimet e buxhetit dhe rishikimet e rishikuara nga RrGK nuk përmbajnë analiza të ndikimit gjinor, vëmendje ndaj pabarazive gjinore që fondet e rialokuara u përpoqen të adresojnë, ose ndonjë ndarje të dukshme të të dhënave sipas gjinisë në lidhje me sigurimin e shumë informacioneve mbi përfituesit e parashikuar të këtyre fondeve.

Për më tepër, përfaqësuesit e organizatave buxhetore thanë se ato nuk përfshinin një perspektivë gjinore në arsyetimet e tyre. Përgjigje e përsëritur gjatë intervistave ishte se “situata ishte e njëjtë për të dy gjinitë”, dhe kështu nuk duhej perspektivë gjinore brenda arsytiveve.¹²¹ Siç është përmendur në metodologji, fakti që çështjet mund të diskutohen gojarisht por nuk artikulohen me shkrim mund të nënkuptojë që disa zyrtarë që nuk intervistohen nga RrGK mund të kenë konsideruar perspektivën gjinore kur bëjnë rialokime, por nuk i kanë përfshirë ato në dokumentet e shkruara.

¹¹⁴ Intervista e RrGK-së me Ministrinë e Shëndetësisë.

¹¹⁵ Intervistat e RrGK-së me Zyrtarët e Financave.

¹¹⁶ Po, aty.

¹¹⁷ Vlerësimi i Ndikimit Gjinor është pjesë e Kuadrit Plotësues të SHPPF-s për Vlerësimin e Menaxhimit të Përgjegjshëm të Financave Publike Gjinore.


¹¹⁸ Ligji Nr. 05 / L-20 për Barazinë Gjinore, neni 5, par. 1.5.

¹¹⁹ Qeveria e Kosovës, Strategjia e Rregullimit më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021.

¹²⁰ Intervistat e RrGK-së.

¹²¹ Intervistat e RrGK-së.

Grafiku 2. Burimi i Donacioneve në llogarinë e Kosovës të dedikuar për COVID-19 sipas vendeve.



Burimet e financimit për adresimin e Pandemisë COVID-19

Burimet e financimit, ose të ardhurat, për të mbështetur adresimin e pandemisë COVID-19 kanë të bëjnë me dimensionin SHPPF MPGJFP 1.2: analiza e ndikimit gjinor e propozimeve të politikës së të ardhurave. Ishte përtej fushës së kërkimit të këtij hulumtimi për të shqyrtuar plotësisht se si të gjitha të ardhurat e shtetit të Kosovës mund të ndikojnë ndryshe tek gratë dhe burrat, megjithëse kjo kërkon hulumtime të mëtejshme. Përkundrazi, kjo pjesë ofron thjesht një përmbledhje të shkurtër të burimeve të financimit dhe çfarë mund të konsiderohet në të ardhmen nga perspektiva gjinore.

Financimi për adresimin e pandemisë COVID-19 ka ardhur nga buxheti i Kosovës, financues të huaj dhe donatorë vendas, përfshirë këtu edhe në formë të granteve dhe kredive. Thesari i Kosovës krijoi një nën-llogari zyrtare bankare të dedikuar për marrjen e granteve dhe donacioneve të destinuar për adresimin e COVID-19, e cila mbahet në Bankën Qendrore të Kosovës si pjesë e sistemit të LIVTh. Deri në shtator 2020, donacionet për këtë llogari arritën shumën 716,774 euro (shih Grafikon 2). Shumica vinin nga jashtë Kosovës (93%), por disa ishin krijuar edhe brenda vendit (7%).

Kur u pyetën për burimet e tyre të financimit për adresimin e COVID-19, shumica e zyrtarëve të financave të intervistuar thanë se financimi erdhi kryesisht nga buxheti i tyre i rregullt, sa i përketit

buxhetit të Kosovës të miratur në gusht 2020. Pesë të anketuar nga intervistat raportuan se kishin marrë ndihmë nga të huajt dhe 15 kishin marrë ndihma nga donatorë privatë vendor. Në nivelin komunal, ndihma e brendshme shpesh ishte në formën e kontributeve bamirëse, të tilla si produkte sanitare si dezinfektues, doreza dhe maska. Rrallëherë komunat raportuan se kishin marrë ndihmë monetare nga donatorë të huaj ose vendor.

Më 30 mars 2020, Bashkimi Evropian (BE) njoftoi në lidhje me një pako financimi mbështetëse për Kosovën, dhe Ballkanin Perëndimor (BP), për të adresuar nevojat e ngutshme për pajisje mjekësore dhe mbrojtjes në lidhje me pandeminë COVID-19 dhe për të mbështetur shoqërinë dhe rimëkëmbjen ekonomike të BP-së, përfshirë mbështetjen për sektorin privat, rritjen e mbrojtjes sociale, me vëmendje të posaçme ndaj grupeve të cenueshme dhe forcimin e qëndrueshmërisë së sektorit të shëndetit publik. Disa nga këto fonde janë planifikuar të rrjedhin nga Instrumenti i Para-Anëtarësimit III. Asnjë referencë specifike nuk është bërë për gjininë në njoftimin e BE-së.

Më 9 prill, Koalicioni Rajonal për Integrimin e Perspektivës Gjimore në Procesin e Anëtarësimit në BE i dërgoi një letër zyrtare BE-së, ku kërkonte nevojën për analiza gjimore për të informuar në lidhje me planifikimin dhe zbatimin e mbështetjes së BE-së në reagim ndaj pandemisë. Letra kërkonte nga BE-ja që të inkurajojë qeveritë përkatëse të BP-së të sigurojnë që programet e rimëkëmbjes ekonomike të përfshijnë perspektivën gjimore, veçanërisht në lidhje me adresimin e ekonomisë joformale, ngarkesën e pabarabartë të grave për punën e papaguar dhe qasjen në burimet për rimëkëmbje dhe zhvillim të bizneseve. Në përgjigjen e BE-së më 5 qershor, Komisionerët e BE-së përsëritën se promovimi i barazisë gjimore është një vlerë thelbësore e BE-së dhe se Komisioni do të vazhdojë të promovojë barazinë gjimore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave gjatë pandemisë.

Plani II i BE-së për Veprim Gjitor (PVGj) kërkon që BE-ja të kryejë analiza gjimore dhe të konsultohet me mekanizmat kombëtar për barazinë gjimore, shoqërinë civile dhe posaçërisht organizatat e shoqërisë civile për të drejtat e grave (OSHCG-të) për të informuar modelin e të gjithë programimit të BE. Kjo vlen për programet e financuara nga BE për të mbështetur përpjekjet që adresojnë COVID-19. Ndërkohë RrGK ishte e angazhuar nga BE-ja në Kosovë në diskutimet fillestare në lidhje me financimin e saj të planifikuar për të adresuar COVID-19. Zyra e BE-së në Kosovë ka synuar të sigurojë që të gjitha veprimet e financuara nga BE-ja në lidhje me adresimin e COVID-19 kanë pasur të paktën një objektiv drejt barazisë gjimore dhe / ose fuqizimit të grave. Për më tepër, dy veprime morën pjesë posaçërisht për avancimin e barazisë gjimore me një fokus të fortë në nevojat e grave dhe vajzave.

Gjithashtu, në prill, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) miratoi një hua prej 56.5 milion dollarë amerikanë (51.6 milion €) në mbështetje emergjente për të adresuar pandeminë COVID-19, nën Instrumentin e Shpejtë Financiar.

Sipas Ligjit Nr. 07 / L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 07 / L-001 për ndarjet buxhetore të ndryshuar për Buxhetin e Republikës së Kosovës, Kosova pritet të marrë 50 milion € nga Banka Botërore dhe 100 milion euro nga BE-ja në formën e huave për të adresuar krizën dhe efektet e saj. Në të vërtetë, më 29 qershor, Ministria e Financave nënshkroi një Marrëveshje huaje me Bankën Botërore në vlerë prej 46 milion euro. Fondet do të përdoren për “Projektin Emergjent COVID-19 për Kosovën” për të parandaluar, zbuluar dhe përgjigjur kërcënimet që paraqet COVID-19. Më konkretisht, ajo do të mbështesë blerjen e pajisjeve mjekësore, forcimin e sistemit të shëndetit publik duke rritur kapacitetet e testimit dhe duke zgjeruar kapacitetin e Klinikës së Sëmundjeve Infektive. Brenda kësaj huaje, skemat e ndihmës sociale dhe familjet do të mbështeten sipas Pakos së mëparshme dhe Programit për Rimëkëmbje Ekonomike. Një muaj më vonë, më 30 korrik, një marrëveshje tjetër kredie u nënshkrua nga Ministria e Financave

dhe BE-ja në vlerë prej 100 milion eurove për Planin e Rimëkëmbjes Ekonomike dhe zbatimin e masave emergjente.

Kosova nënshkroi dy marrëveshje të kredisë me Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës (CEB). E para u nënshkrua në 14 gusht në vlerë prej 35 milion euro dhe do të përdoret për të siguruar mbështetjen e nevojshme për të përmirësuar ndjeshëm trajtimin dhe kapacitetin e sistemit shëndetësor për të forcuar qëndrueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore. Në veçanti, kjo marrëveshje do të financojë pajisjet mjekësore në përputhje me nevojat e MSH dhe SHSKUK (Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës), si dhe do të financojë në mënyrë retroaktive linjat buxhetore për masat 6 dhe 7 të pakos emergjente në aspektin e mbështetje për sektorin e shëndetësisë. Kredia e dytë me CEB u nënshkrua në 17 gusht, në shumën prej 30 milion euro për të ndihmuar Ndërmarrjet Publike të kalojnë periudhën e pandemisë sa më lehtë që të jetë e mundur duke pasur parasysh që shumica e tyre kanë përjetuar ulje të të ardhurave deri në 50% si rezultat i pandemisë. Sipas Ministrisë së Financave, “kësti i parë deri në 14 milion euro do t’i sigurohet qeverisë në kredi për siguruesit e infrastrukturës vitale për mbështetje të menjëhershme emergjente. Ndërkohë, kësti i dytë deri në 16 milion eurove do të përdoret për financime të mëtejshme dhe mbështetje për të përmirësuar mbledhjen e ofruesve të shërbimeve jetike të infrastrukturës.” Në total, kjo arrin shumën e 262.2 milion eurove në kredi.

Nuk ka kurrfarë informacione në dispozicion lidhur me atë nëse janë kryer analiza gjinore për të informuar në lidhje me këto hua ose për të vlerësuar ndikimin afatgjatë të pagesës së kredive që mund të prekë gratë dhe burrat në Kosovë. Në përgjithësi, Kosova ka mungesë të hulumtimit mbi implikimet e mundshme gjinore të përdorimit të formave të ndryshme të të ardhurave, përfshirë ato që lidhen me pandeminë.

Përfundimi

Ministria e Financave kishte një rezervë për raste të paparashikuara, e cila fillimisht i mundësoi Kosovës adresimin e COVID-19. Ligji i ndryshuar për buxhetin parashikon një rezervë për raste të paparashikueshme që tejkalon atë fillestare. Rialokimet e parashikuara në linjat buxhetore gjithashtu ishin të nevojshme. Në përgjithësi, proceset zyrtare të miratimit, përfshirë arsyetimet e nevojshme, duket se janë respektuar. Sidoqoftë, arsyetimet me shkrim nuk përmbanin perspektivën gjinore. Kosova ka marrë burime shtesë, të jashtme të financimit për të adresuar pandeminë, duke përfshirë grante dhe hua nga BE, CEB, BERZH, FMN, dhe Banka Botërore. Kosovës i mungojnë analizat e ndikimit gjinor të politikave të të ardhurave, përfshirë ato që lidhen me adresimin e COVID-19.

MENAXHIMI I FINANCAVE PUBLIKE NË REAGIMIN NDAJ COVID-19

Ky kapitull analizon shkallën në të cilën reagimi i qeverisë ndaj COVID-19 ishte transparent, i përgjegjshëm dhe i harmonizuar me praktikën më të mirë në menaxhimin e financave publike. Secila pjesë përfshin diskutimin e shkallës në të cilën këto procese përfshinin perspektivën gjinore. Treguesit e MPGJFP përdoren për të vlerësuar këtë, duke përfshirë 6 për gjurmimin/përcjelljen e shpenzimeve të buxhetit për barazinë gjinore dhe 7 për raportimin e përgjegjshëm gjinor. Ky hulumtim shqyrtoi përdorimin e konsultimeve publike të qeverisë për të informuar reagimin e qeverisë ndaj COVID-19 dhe angazhimin e OSHC-ve në këto konsultime. Për më tepër, në frymën e transparencës dhe llogaridhënies, ky kapitull analizon nëse proceset e prokurimit ishin transparente dhe nëse qeveria publikoi buxhetet dhe raportet financiare.

Konsultimet publike, nga perspektiva gjinore

Në përputhje me ligjin e Kosovës, qeveria duhet të mbajë konsultime publike. Rregullorja Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik thotë se konsultimet publike duhet të mbahen në mënyrë transparente “duke siguruar mundësi të barabarta për pjesëmarrje jo-diskriminuese të palëve të interesuara dhe publikut në procesin e konsultimeve publike”. Më konkretisht, në lidhje me buxhetin, sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, “pas pranimit të buxhetit të propozuar, Asambleja Komunale do të mbajë dëgjime publike në përputhje me aktet normative komunale në fuqi”. Pastaj, komuna duhet të rishikojë dhe ndryshojë si “e konsideron të nevojshme ose të këshillueshme” buxhetin e propozuar komunal para se ta paraqesë atë në Ministrinë e Financave. Qarkoret buxhetore gjithashtu udhëzojnë organizimin e dëgjimeve buxhetore midis Ministrisë së Financave dhe organizatave buxhetore. Udhëzimi Administrativ për Transparencën Komunale gjithashtu detyron organizimin e takimeve publike të paktën dy herë në vit, si dhe organizimin e takimeve të buxhetit.


Sipas praktikave më të mira me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, është e rëndësishme të sigurohet që si gratë ashtu edhe burrat të marrin pjesë në konsultimet publike për ligjet dhe politikat e buxhetit, për të adresuar interesat dhe prioritetet potencialisht të ndryshme të grave dhe të burrave. Pjesëmarrja e grave në konsultat publike mund të rritet duke inkurajuar komunitetin për të organizuar konsultime publike në vende, në data, dhe në kohë kur gratë mund të marrin pjesë, si dhe duke koordinuar me OSHCG lokale për të siguruar që gratë të informohen për konsultime të tilla. Organizimi i tyre në lokacionet e ndryshme, brenda dhe jashtë qytetit dhe sigurimi ose lehtësimi i transportit mund të sigurojnë pjesëmarrjen e grave dhe burrave të ndryshëm. Qeveria gjithashtu duhet të konsultohet me OSHC-të përkatëse, përfshirë OSHCG, kur harton programe qeveritare, siç është përgjigja ndaj COVID-19. Pastaj, qeveria duhet të përdorë informacionin e marrë nga konsultimet me gratë dhe burrat për të ndryshuar ndërhyrjet e planifikuara.

Kur u pyetën nëse ishin organizuar debate publike për të informuar hartimin e masave për adresimin e alokimeve të pandemisë dhe buxhetit, zyrtarët qeveritarë në nivelet lokale dhe qendrore deklaruan se nuk kanë organizuar debate publike. Zyrtarët e buxhetit nga vetëm tri komuna raportuan konsultimet me përfaqësuesit e fshatrave. Sidoqoftë, shkalla në të cilën morën pjesë gra dhe burra të ndryshëm, ose sa u diskutuan çështjet e barazisë gjinore, ishte e paqartë. Zyrtarët thanë që ata i morën


në konsideratë informatat e pranuar gjatë ekzekutimit të masave dhe shpërndarjes së pakovetëndihmës. Përveç këtyre rasteve të jashtëzakonshme, në përgjithësi zyrtarët komunalë të intervistuar nuk i konsideronin debatet publike të rëndësishme në kohë krize. Disa zyrtarë deklaruan se diskutimet e kuvendit komunal rreth masave kishin të njëjtin efekt si debatet publike dhe kështu që ishin të mjaftueshme. Deklarata të tilla ilustronë shpërfillje të qartë për përgjegjësitë e tyre të lartpërmendura për të organizuar diskutime publike.

Disa zyrtarë vunë re se diskutimet publike nuk mund të organizoheshin duke pasur parasysh politikën sociale të distancimit. Organizimi i debateve publike në internet nuk u mor parasysh. Mungesa e përgjithshme e diskutimeve publike në lidhje me masat do të thoshte se përfshirja e një perspektive gjinore në masa, bazuar në këto diskutime, ishte e pamundur.

Nga shtatori, kur u pyetën në përgjithësi nëse alokimet e buxhetit për reagimin e qeverisë ndaj COVID-19 u debatuan publikisht, 28% e 75 të anketuarve të OSHC-ve thanë se ishin debatuar pak, 9% thanë se ishin debatuar mesatarisht, dhe 27% thanë se alokimet e buxhetit nuk u diskutuan fare (Grafiku 3). Për më tepër, kategoria “Nuk e di” gjithashtu do të sugjeronte që debatet publike nuk ishin të kualitetit më të mirë ose të reklamuar mirë; përndryshe të anketuarit do të kishin ditur për to.



Grafiku 4. Konsultimet publike me gratë potencialisht të prekura nga masat



Kur u pyetën për rezultatet e atyre konsultimeve, 58% thanë se asgjë nuk ndryshoi si rezultat i konsultave


Nga mesi i OSHC-ve të anketuara, 44% thanë se gratë që mund të preken nga masat nuk u këshilluan fare (Grafiku 4). Nga 26% që thanë se ishin zhvilluar konsulta me gra, 37% thanë që konsultimet kishin ndodhur para se të miratoheshin masat dhe 63% thanë që konsultimet ndodhën më pas. Kur

u pyetën për rezultatet e atyre konsultimeve, 11 (58%) thanë se asgjë nuk ndryshoi si rezultat i konsultave, dhe shtatë (37%) thanë se masat ishin përshtatur për të adresuar sugjerimet e bëra. Vetëm një (5%) tha që një masë e planifikuar ishte anuluar pas konsultimeve.


Kur u pyetën për përfshirjen e tyre në sigurimin e informacionit për të informuar reagimin e qeverisë ndaj COVID-19, 83% e të anketuarve të OSHC-ve thanë se nuk u ishte dhënë asnjë mundësi për t'u përfshirë, 9% thanë se u ishte dhënë mundësia për përfshirje të vogël, 7% thanë që ata ishin të përfshirë mesatarisht, dhe vetëm një organizatë deklaroi që ishin të përfshirë në mënyrë thelbësore (Grafiku 5).

Përgjigjet e të anketuarve nga OSHC-të ishin të ngjashme kur u pyetën për përfshirjen e OSHC-ve të tjera në planifikimin dhe hartimin e reagimit të qeverisë. Sidoqoftë, më shumë OSHC tentuan të besojnë se

Grafiku 5. Përfshirja e OSHC-ve në Informimin e Përgjigjes COVID-19



Grafiku 6. A ishin OSHC-të e tjera të përfshira në përgjigjen e COVID-19?



organizatat e tjera kishin pak më shumë mundësi për të dhënë kontribut sesa ata vetë.

Ndërkohë, disa OSHC morën iniciativën për t'i dërguar rekomandime qeverisë. Më 22 mars, përpara se qeveria të vendoste për Pakon Fiskale Emergjente, 12 OSHC i paraqitën qeverisë rekomandimet e tyre për masat për të luftuar pasojat ekonomike të pandemisë. OSHC-të i kërkuan qeverisë që të hartojë dhe zbatojë me urgjencë një plan emergjence ekonomike, duke përdorur burimet shtetërore dhe duke mobilizuar burime të tjera. Ata i kërkuan qeverisë të minimizojë pasojat për punonjësit e sektorit privat dhe rastet sociale. OSHC-të rekomanduan ofrimin e mundësive për qasje në kredi dhe rishikimin e buxheteve dhe programeve për lirim të fondeve për masat e mbështetjes ekonomike, duke i dhënë përparësi sektorit privat. Ato sugjeruan krijimin e një Fondi

Edhe pse nuk u këshilluam, nuk pritëm. Ne bëmë punën tonë dhe dërguam rekomandimet tona.

— Përfaqësuesi i OSHC-së, Prishtinë

të Solidaritetit, të menaxhuar dhe administruar nga Qeveria e Kosovës, ku palët e interesuara brenda dhe jashtë Kosovës mund të sigurojnë ndihmë financiare në mirëbesim; fondi mund t'i japë prioritet adresimit të nevojave emergjente të rasteve më të prekshme. OSHC-të gjithashtu i kujtuan qeverisë kërkesat e tyre për të hyrë në një dialog urgjent me sektorin bankar në Kosovë për të pezulluar pagesat e huas për të gjithë huamarrësit për të paktën tre muaj, pa aplikuar interes për këtë periudhë. OSHC-të ofruan mbështetjen e tyre në hartimin dhe zbatimin e çdo mase të marrë nga qeveria. Letra nuk përmbante asnjë perspektivë gjinore, mbase pjesërisht për shkak të faktit se asnjë nga organizatat nënshkruese nuk ishte OSHCG.

Menjëherë pasi u miratua Pakoja Fiskale Emergjente, RrGK kërkoj nga qeveria të konsiderojë më mirë një perspektivë gjinore në reagimin e saj ndaj COVID-19. Në veçanti, RrGK i kërkoj qeverisë që urgjentisht të kryejë analizën gjithëpërfshirëse gjinore për të informuar dhe drejtuar masat e mëtejshme qeveritare, duke përfshirë një vlerësim *ex ante* të ndikimit gjinor, në përputhje me Ligjin për Baraziminë Gjinore. RrGK gjithashtu kërkoj që qeveria të përfshijë më shumë gra në hartimin e programeve dhe politikave në lidhje me COVID-19 dhe në propozimin e masave afatshkurtra dhe afatgjata, veçanërisht në lidhje me çështjet sociale, ekonomike dhe shëndetësore, duke përfshirë mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore. Ministrisë së Financave, RrGK i rekomandoi që të rishikojë buxhetin afatmesëm duke përdorur parimet më të mira të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, dhe duke u bazuar në gjetjet e vlerësimeve të ndikimit gjinor për të marrë parasysh nevojat e ndryshme të grave dhe burrave të ndryshëm.

Në përgjithësi, deri nga shtatori, përfaqësuesit e OSHC-ve thanë se qeveria nuk i mori parasysh rekomandimet e shoqërisë civile gjatë hartimit të masave. Disa shprehën pakënaqësi se si qeveria dështoi të angazhohej, me OSHC-të. Ndërsa disa nga masat e sipërpërmendura të qeverisë adresuan shqetësimet e ngritura në letrën e përbashkët të OSHC-ve, është e paqartë nëse ato rrjedhin nga rekomandimet e OSHC-ve. Shqetësimet e RrGK-së nuk janë adresuar ende.

Transparenca dhe ndjeshmëria gjinore e prokurimit publik

Treguesi i prokurimit SHPPF (P-24) nuk përfshin ekzistencën e procedurave emergjente për prokurim. Sidoqoftë, dimensionin 24.1 "Monitorimi i prokurimit" vlerëson ekzistencën e një sistemi monitorimi dhe raportimi. Një sistem i fortë mund të jetë në gjendje të mbështesë monitorimin dhe raportimin e operacioneve të prokurimit emergjent. Dimensionin SHPPF 24.2 mbi "Metodat e prokurimit" përfshin identifikimin e pragut nën të cilin nuk ka nevojë të përdoret një metodë konkurruese e prokurimit. Në fund, dimensionin 24.3 i SHPPF-s mbi "Qasjen publike në informacionin e prokurimit" rishikon shkallën në të cilën ekziston qasja e publikut në informacionin e plotë dhe të besueshëm të prokurimit, të rëndësishëm për transparencën në mesin e procedurave emergjente. Treguesit e MPGJFP 6 për gjurmimin e shpenzimeve buxhetore dhe 7 për barazimin gjinore dhe raportimin e përgjegjshëm gjinor, përdoret për të vlerësuar shkallën në të cilën një vend ka sistem monitorimi dhe raportimi për barazimin gjinore.

Në përgjithësi, qeveria e Kosovës në mënyrë transparente publikoi masat dhe buxhetin e saj në lidhje me COVID-19. Në rrethana normale, Ligji për Prokurim në Kosovë përcakton rregullat e përgjithshme për secilën organizatë buxhetore për të zbatuar aktivitetet e prokurimit përmes procedurave të hapura. Sipas legjislacionit të prokurimit, "procedurat e negociuara pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës mund të përdoren për arsye të emergjencave ekstreme, të shkaktuara nga ngjarje të verifikueshme objektivist, të cilat nuk mund të ishin parashikuar në mënyrë të arsyeshme nga autoriteti

përkatës kontraktues”. Gjithashtu, Ligji lejon afate më të shkurtra për procedurat e kuotimit të çmimeve dhe aktivitetet e prokurimit, si dhe rregulla të veçanta për afate më të shkurtra “nëse ka rrethana që kërkojnë zbatimin e një aktiviteti të prokurimit në rast emergjence”.


Duke pasur parasysh që pandemia COVID-19 kërkon-te masa emergjente, disa zyrtarë deklaruan se ata përdorën procedurat e sipërpërmendura të shpejtuara për të adresuar krizën, përfshirë procedurat e përshpejtuara të prokurimit për artikujt e prokuruar fillimisht. Procesi i prokurimit të përshpejtuar përfshinte afate më të shkurtra kohore (p.sh., deri në shtatë ditë ose më pak), ndër procedurat e tjera të përshpejtuar.

Zyrtarët e intervistuar tentuan të deklarojnë se ata ndoqën procedurat zyrtare të prokurimit në prokurimin e

mallrave dhe shërbimeve për të adresuar pandeminë COVID-19. Kjo përfshinte publikimin e dokumenteve dhe informacioneve të rëndësishme për procesin e prokurimit në faqet e tyre të internetit dhe në linkun e-Prokurimi. Kjo, thanë ata, përfshinte informacion në lidhje me atë që ishte blerë, si dhe për sa kishte kushtuar. Qytetarët e interesuar mund të kenë qasje në dokumentet përkatëse në faqet e internetit të institucioneve nën linkun e-Prokurimi. Baza e të dhënave përmban autoritetin kontraktues, kodin ose numrin e referencës, dokumentin dhe llojin e kontratës, emrin dhe materialin e prokuruar. “Fjalori i Klasifikimit të Prokurimit” përmban llojin e procedurës së prokurimit dhe vlerën e vlerësuar të kontratës. Ndër informacionet e tjera, këto dokumente përmbajnë afatin kohor për pranimin e tenderëve/aplikacioneve, datën e njoftimit, datën e dërgimit, aktin dhe dorëzimin elektronik të tenderit/kontratës.

Është interesante se, megjithëse shumica e proceseve të prokurimit të rishikuara nga RrGK dukeshin transparente. 36% e OSHC-ve të anketuara thanë se proceset e prokurimit nuk kishin transparencë, ndërsa 31% thanë se prokurimi ndonjëherë ishte transparent (Grafiku 7). Vetëm dy të anketuar (3%) thanë se procesi i prokurimit ishte shumë transparent. Ndërkohë, 31% nuk e dinin nëse prokurimi ishte transparent apo jo. Përkundër skepticizmit të shprehur nga OSHC-të, shumica e kontratave duket se janë publike nën linkun e-Prokurimi.

Sidoqoftë, informacioni i lidhur me prokurimin në dispozicion publik, i rishikuar nga RrGK nuk përmbante ndonjë perspektivë gjinore. Organizatat buxhetore kanë tendencë që të mos kenë përfshirë ndonjë masë afirmative drejt barazisë gjinore në prokurim, siç parashihet si një masë e përkohshme e mundshme drejt barazisë gjinore në Ligjin për Barazi Gjinore. Një përgjigje e përsëritur midis zyrtarëve të financave ishte se masat afirmative nuk mund të zbatohen në prokurim, pasi Ligji për Prokurim nuk parashikon masa afirmative bazuar në gjini. Kjo sugjeron një mungesë të përgjithshme të njohurive në



mesin e zyrtarëve të financave në lidhje me dispozitat e Ligjit për Barazi Gjinore dhe Ligjit për Prokurim. Legjislacioni i prokurimit” autoritetet kontraktuese mund të vendosin, ndër të tjera, kushtet specifike të kontratës të cilat lejojnë që të merren parasysh objektivat sociale”. Midis këtyre është “Detyrimi për të zbatuar, gjatë ekzekutimit të kontratës, masat që janë krijuar për të promovuar barazinë gjinore ose diversitetin për arsye të tjera”. Prandaj, sipas këtij ligji, për shembull, ministritë dhe komnatat, si autoritete kontraktuese, mund të përdorin veprime afirmative për të inkurajuar bizneset në pronësi të grave dhe/ose ndërmarrjet me më shumë gra të punësuara për të aplikuar. Organizatat buxhetore mund të sigurojnë që si gratë ashtu edhe burrat të përfitojnë nga vendet e punës të krijuara nga projektet e financuara nga qeveria.

Transparenca në raportet financiare

Buxheti për COVID-19 u ekzekutua përmes llogarisë së vetme të thesarit (LIVTh). LIVTh është një sistem që përbëhet nga të gjitha (nën) llogaritë e Thesarit në Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës dhe/ose bankat tregtare. Shpenzimet në lidhje me adresimin e COVID-19 u vendosën nën kodin e lartpërmendur 00099. Duhet theksuar se LIVTh nuk ka ndonjë kod buxhetor që i përket posaçërisht barazisë gjinore, kështu që fondet për veprimet e lidhura me barazinë gjinore nuk mund të gjurmohen, nëse ato ekzistojnë.

Transparenca e ekzekutimit të buxhetit për COVID-19 në lidhje me barazinë gjinore mund të vlerësohet duke përdorur treguesin MPGJFP 7 mbi raportimin e përgjegjshëm gjinor. Publikimi i raporteve financiare është i rëndësishëm për transparencën dhe për të mundësuar qytetarët të rishikojnë përdorimin e financave publike. Kur u pyeten për raportet financiare, përfaqësuesit e organizatave buxhetore thanë se ata përgatitën raporte të rregullta financiare, përfshirë raportet mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore, si dhe raporte të tjera nëse ishte e nevojshme. Të anketuarit thanë se nuk kishte vonesa në shkrimin e këtyre raporteve, dhe pandemia nuk ndikoi në punën e tyre të rregullt. Në përgjithësi, shumica e këtyre raporteve janë në dispozicion në faqen e internetit të secilit institucion. Nëse nuk është tashmë i disponueshëm publikisht, zyrtarët thanë se raportet mund të ndahen. Sidoqoftë dhe për dallim, pavarësisht nga detyrimet ligjore për t'i bërë publike raportet e financave, disa të anketuar duket se e konsiderojnë këtë linjë të pyetjeve të papërshtatshme, duke sugjeruar që raportet financiare janë vetëm për përdorimin e tyre të brendshëm dhe nuk duhet të ndahen. Disa të anketuar ranë dakord të dërgojnë raporte financiare jo të disponueshme në internet, por këto nuk i janë ofruar RrGK-së. Përndryshe, shumica e institucioneve publikuan raportet e tyre financiare në internet, megjithëse jo gjithmonë në kohë. Raportet financiare janë mjaft të hollësishme, sigurojnë të dhëna mbi të hyrat, shpenzimet krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, pagesa, subvencione dhe grante. Raportet detajojnë sektorët në të cilët janë ndërmarrë veprime, por nuk përfshihet asnjë perspektivë gjinore.

Në përgjithësi, auditimet e financave të shtetit kryhen çdo vit, vitin pasardhës. Prandaj, ishte shumë herët për të rishikuar raportet e auditimit që kishin të bënin me përgjigjen ndaj COVID-19 dhe shkallën në të cilën këto përmbajnë një perspektivë gjinore. Auditimet ende nuk ishin kryer, të brendshme apo të jashtme. As zyrtarët e auditimit nuk kishin filluar planifikimin e përmbajtjes së auditimeve, kështu që përfshirja e treguesve gjinorë në lidhje me vlerësimin e performancës nuk mund të vlerësohej ende. Kur u pyetën në lidhje me perspektivën gjinore të pasqyruar në auditimet e mëparshme, zyrtarët e financave vunë re se disa gra audituese kanë ekzaminuar financat e tyre; disa sugjeruan që prania e

grave në procesin e auditimit ishte një shenjë e barazisë gjinore në auditim. Kjo sinjalizon kuptim të pamjaftueshëm midis zyrtarëve të financave në lidhje me mënyrat në të cilat një perspektivë gjinore mund të reflektohet në procesin e auditimit më gjerësisht. Ndërsa treguesi 9.2 i MPGJFP i referohet shqyrtimit legjislativ të përgjegjshëm gjinor të raporteve të auditimit, ishte herët për të vlerësuar rishikimin legjislativ të auditimit të financimit të lidhur me COVID-19.

Përfundimi

Gjetjet e hulumtimit sugjerojnë se një numër i vogël i qytetarëve ose OSHC morën pjesë në konsultime për të informuar masat për adresimin ndaj COVID-19. Prandaj, pikëpamjet e grave dhe burrave të ndryshëm dhe perspektiva gjinore nuk mund të pasqyrohen në masa, bazuar në konsultime të tilla. Ndërsa proceset e prokurimit në përgjithësi duket se kanë qenë transparente dhe të arritshme nga publiku, disa OSHC menduan se nuk ishin transparente. Ndonjëherë proceset e prokurimit përshpejtohen, megjithëse kjo mund të lejohet në situata emergjente, bazuar në ligjin e prokurimit të Kosovës. Sidoqoftë, masat afirmative të lejueshme ligjërish ndaj barazisë gjinore duket se nuk janë reflektuar në procedurat e prokurimit, duke pasur parasysh mungesën e përgjithshme të njohurive të zyrtarëve të financave në lidhje me dispozitat përkatëse të Ligjit për Barazi Gjinore dhe Ligjit për Prokurim. Ndërsa raportet financiare në përgjithësi duhet të jenë të disponueshme në internet, jo të gjitha organizatat buxhetore i publikojnë ato ose i bëjnë ato të disponueshme sipas kërkesës. Raportet e auditimit në lidhje me COVID-19 nuk ishin ende në dispozicion, megjithëse rishikimi i raporteve të tilla të mëparshme sugjeron pak vëmendje ndaj barazisë gjinore brenda raporteve të auditimit.

QËLLIMET DHE KONTRIBUTET E MASAVE FISKALE DREJT BARAZISË GJINORE

Ky kapitull analizon shkallën në të cilën masat dhe buxheti i qeverisë i miratuar në përgjigje të COVID-19 kanë kërkuar që të avancojnë barazinë gjinore. Është vlerësuar progresi në treguesit e mëposhtëm MPGJFP: 1) analiza e ndikimit gjinor e propozimeve të politikave buxhetore; 2) investime publike të përgjegjshme gjinore; 4) dokumentacioni i propozuar i buxhetit të përgjegjshëm gjinor; 5) informacione të performancës të ndara sipas gjinisë për ofrimin e shërbimeve; dhe, 8. vlerësimin e ndikimeve gjinore të ofrimit të shërbimeve.

Së pari, në këtë kapitull diskutohet shkalla në të cilën dokumentet e buxhetit konsideruan perspektivën gjinore dhe shqyrton buxhetin e përgjithshëm dhe shpenzimet në lidhje me adresimin e COVID-19. Së dyti, ofron një përmbledhje të masave fiskale të qeverisë. Së treti, seksionet që vijojnë diskutojnë masat sociale, ekonomike, arsimore, shëndetësore dhe komunale për të adresuar COVID-19, përkatësisht, nga perspektiva gjinore. Secili prej këtyre seksioneve përmban analiza gjinore, duke ekzaminuar sesi masat e qeverisë për pandemi dhe ato të ndërlidhura kanë ndikuar ndryshe tek gratë dhe burrat. Pastaj, secili seksion diskuton shkallën në të cilën perspektiva gjinore është përfshirë në formulimin e masave qeveritare. Në fund, secili seksion diskuton përfituesit e masave, nga perspektiva gjinore. Në seksionin e fundit të këtij kapitulli, autorët marrin në konsideratë reagimin e përgjithshëm të qeverisë ndaj COVID-19, duke nxjerrë nga ekonomia feministe dhe heterodokse.

Në lidhje me kornizën ligjore relevante, siç u përmend, në përputhje me Ligjin e Kosovës për Barazinë Gjinore, praktikat më të mira në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe thirrjen e qeverisë për Vlerësime të Ndikimit Rregullator që përfshijnë Vlerësimet e Ndikimit Gjinor, të gjitha politikat, programet dhe buxhetet duhet të informohen nga analiza gjinore paraprake. Nga kjo rrjedh se masat për të adresuar COVID-19 duhet t'i përmbahen këtyre kërkesave. Analiza gjinore është e rëndësishme për informimin e politikave dhe programeve të tjera shoqërore, arsimore, shëndetësore, ekonomike dhe qeveritare për të siguruar adresimin e nevojave dhe interesave potencialisht të ndryshme të grave dhe të burrave. Meqenëse kjo pandemi nuk ndodhi në vakum, analiza gjinore konsideron situatat

paraprake, mundësitë, qasjen në burime dhe pabarazitë midis grave dhe burrave për të kuptuar më mirë ndikimet potencialisht të ndryshme të pandemisë te gratë dhe burrat. Identifikimi i çështjeve kryesore me të cilat përballen gratë dhe burrat në lidhje me pandeminë mund të ndihmojë në informimin e përgjigjes më të përshtatshme, më efektive dhe efikase të qeverisë. Analiza gjinore *ex-ante* gjithashtu mund të mbështesë identifikimin e rezultateve (përfshirë ato drejt përfshirjes dhe barazisë gjinore), vijat bazë, synimet dhe përfituesit e shpenzimeve shtetërore.

Pas një analize të shpejtë gjinore të kryer në lidhje me secilën masë për të përcaktuar nevojat potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave, autorët vlerësojnë shkallën në të cilën masat e miratuara në përgjigje ndaj COVID-19 synonin avancimin e barazisë gjinore. Autorët analizuan dhe vlerësuan secilën masë në lidhje me potencialin e saj për të kontribuar në barazinë gjinore, duke përdorur shkallën pesë pikëshe. Masat e vlerësuara si “negative gjinore”



Nuk e di pse insistoni që mund të ketë pabarazi. Nuk ka pabarazi. Gjithçka ishte e njëjtë për të gjithë; këtu nuk ka ‘gjini’.

— Zyrтари

nxisin pabarazitë gjinore duke forcuar normat, rolet dhe marrëdhëniet ekzistuese të pabalancuara midis grave dhe burrave; ato shpesh privilegjojnë burrat mbi gratë. Ndërhyrjet e emërtuara si “aspekti gjinor nuk është marrë në konsideratë” injorojnë normat, rolet dhe marrëdhëniet ekzistuese gjinore, duke mos marrë parasysh nevojat dhe interesat e ndryshme të grave dhe burrave. Nisma të tilla gjinore shpesh ndërtohen bazuar në parimin e të qenit “i drejtë” duke i trajtuar të gjithë “njësoj”. Kjo mund të kontribuojë në riprodhimin ose forcimin e pabarazive ekzistuese gjinore dhe diskriminimin strukturor të bazuar në gjini. Masat “e ndjeshme gjinore” marrin në konsideratë normat, rolet dhe marrëdhëniet gjinore në një sektor të caktuar, megjithëse ato nuk adresojnë pabarazitë. Ndërhyrjet “pozitive gjinore” marrin në konsideratë normat, rolet dhe marrëdhëniet gjinore dhe se si këto ndikojnë te gratë dhe burrat në qasjen dhe kontrollin e burimeve. Veprime të tilla marrin në konsideratë nevojat specifike të grave dhe burrave dhe synojnë qëllimisht gratë ose burrat për të arritur qëllimet ose për të përmbytur këto nevoja. Ndërhyrjet ideale “transformuese gjinore”, synojnë të transformojnë normat, rolet dhe marrëdhëniet gjinore të dëmshme, dhe se si këto ndikojnë te gratë dhe burrat në qasjen dhe kontrollin e burimeve të tyre, drejt avancimit të barazisë gjinore. Veprime të tilla përfshijnë strategji që nxisin ndryshime progresive në marrëdhëniet e pushtetit midis grave dhe burrave, drejt barazisë. Ky kapitull analizon secilën politikë, program dhe masë të miratuar ose rishikuar për të adresuar COVID-19, duke vlerësuar përgjegjshmërinë gjinore të tyre sipas këtyre kategorive.¹²²

Hulumtimi është përqendruar kryesisht në dokumentet e buxhetit, Masat Fiskale Emergjente dhe masa të tjera ekzistuese që nga gushti sepse të anketuarit e qeverisë ishin marrë vetëm me këto masa në kohën e këtij hulumtimi. Pakoja e dytë e masave, Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike, nuk u diskutua gjatë intervistave, pasi u miratua në mes të gushtit. Prandaj, gjetjet mund të jenë të kufizuara në lidhje me masat e mëvonshme, pasi ato nuk u diskutuan me institucionet. Veçanërisht, secila pjesë diskuton përmbajtjen e masave qeveritare, si janë formuluar ato me shkrim dhe shkallën në të cilën është përfshirë perspektiva gjinore në formulimin e shkruar të masave të arritshme për publikun. Ai nuk shqyrton qëllimin e mundshëm të vendimmarrësve, ku nuk shprehet me shkrim dhe nuk bëhet i disponueshëm për publikun.

Lidhur me përfituesit e masave, Ligji për Barazinë Gjinore kërkon që të gjitha organet qeveritare të mbledhin, regjistrojnë, përpunojnë dhe dorëzojnë të dhëna statistikore të ndara sipas gjinisë në ASK.¹²³ Sidoqoftë, pak organe qeveritare kishin të dhëna të ndara sipas gjinisë në lidhje me përfituesit e masave në dispozicion në kohën e këtij studimi. Kësisoj, ishte e vështirë të përcaktohej se sa gra dhe burra përfituan nga shpenzimet për këto masa. Disa organe qeveritare kishin përfitues me emër, por deklaruan se këto të dhëna ishin konfidenciale dhe nuk mund të ndaheshin për përdorim të jashtëm. Me disa masa që sapo filluan zbatimin në kohën e hulumtimit, ishte me të vërtetë shumë herët për të vlerësuar ndikimin.

Dokumentet buxhetore dhe amandamentet

Duke pasur parasysh treguesit e lartpërmendur të SHPPF MPGJFP, kjo pjesë shqyrton shkallën në të cilën dokumentet buxhetore dhe ndryshimet në këto dokumente morën pjesë në barazinë gjinore. KASH 2021-2023 e ndryshuar, e cila vendosi bazën për buxhetin e Kosovës, kishte këto objektiva në Programin e Qeverisë për 2020-2023: 1) mposhtjen e pandemisë; dhe 2) rimëkëmbjen ekonomike

¹²² Për përmbledhjen e të gjithave, ju lutem shikoni [Aneksin 4](#).

¹²³ Ligji për Barazinë Gjinore, neni 5, paragrafi 1.1.8.

pas-pandemike. Prioritetet e rishikuara të KASH përfshijnë “të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe komunitetet.”¹²⁴ KASH deklaroi se prioritet i qeverisë është “krijimi i mundësive të barabarta dhe jo-diskriminuese, respektimi i të drejtave të njeriut, forcimi i mekanizmave për Barazi Gjinore, mbrojtja nga dhuna në familje, ndihma juridike falas dhe kompensimi i viktimave të krimeve të luftës, integrimi i grupeve të marginalizuara dhe liria e shprehjes.”¹²⁵ Dokumenti nuk shpjegon se si ministritë do të bashkëpunojnë për ta arritur këtë. Në kapitullin “mbrojtja sociale”, KASH përmend që objektivi kryesor mbetet “rritja e mirëqenies sociale përmes zgjerimit dhe ngritjes së cilësisë, ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, me fokus specifik në grupet në nevojë dhe barazinë gjinore.”¹²⁶ KASH përmend termin “gjini” vetëm katër herë. Sidoqoftë, nuk ekziston asnjë shpjegim se si do të arrihet kjo.

Një grant i kujdesit shëndetësor parësor (2021-2023) në vlerë prej 62.6 milion euro për vitin 2021 është aprovuar ku përfshihen në mesin e përfituesve të dhënat e ndara sipas gjinisë, si dhe kategori të tjera të tilla si mosha dhe aftësia. Në mesin e tyre 50.4% janë burra dhe 49.6% janë gra.¹²⁷

Në përgjithësi, KASH-i mund të vlerësohet si dokument ku aspekti gjinor nuk është marrë në konsideratë, sepse përveç këtyre referencave të shkurtra, nuk merr parasysh ose nuk përcakton qartë hapat për të adresuar nevojat specifike të grave dhe burrave. As nuk siguron të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe perspektivës gjinore në punësim, shkallën e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, huat, depozitat, shpenzimet e institucioneve qendrore dhe lokale dhe në personel, shëndetësi, arsim, mjedis, sundim të ligjit dhe siguri publike, mbrojtje, strehim dhe çështje komuniteti, çështje të ekonomisë, rekreacion, kulturë dhe fe, dhe shifra të mbrojtjes sociale. Kështu, KASH nuk adreson sa duhet dimensionet e MPGJFP I.I. mbi analizën e ndikimit gjinor për të informuar propozimet e politikave buxhetore; 4.1 Dokumentacioni i propozuar i buxhetit të përgjegjshëm gjinor; ose 5.1. planet e performancës të ndara nga seksi për ofrimin e shërbimeve.

Ligji origjinal i Buxhetit për vitin 2020 përmend “çështjet gjinore” në 17 linja buxhetore, përfshirë Agjencinë për Barazi Gjinore dhe 16 linja buxhetore për shpenzimet e zyrtarëve për barazi gjinore. I 28 Ky dokument gjithashtu përfshin treguesit e tregut të punës sipas gjinisë. Objektivi i mbrojtjes sociale të KASH mbi “rritjen e mirëqenies sociale duke përmirësuar dhe rritur cilësinë, duke siguruar shërbime sociale dhe familjare, me fokus të veçantë në grupet e cenueshme dhe barazinë gjinore” është përmendur gjithashtu në këtë Ligj të Buxhetit. Ligji i ndryshuar i Buxhetit përmend “çështjet gjinore” në të njëjtat 17 linja buxhetore. I 29

Duke pasur parasysh që Kosova përdor kode buxhetore me pesë kategori të përcaktuara të shpenzimeve (të quajtura “kategori ekonomike”), në vend të buxhetimit të programeve, vetë Ligji i Buxhetit, i marrë vetëm, nuk përmbush asnjërin nga treguesit e lartpërmendur të MPGJFP. Në dokumentin e buxhetit ekziston informacion i pamjaftueshëm për të vlerësuar lehtësisht shkallën në të cilën shpenzimet e planifikuara mund të kontribuojnë në barazinë gjinore. Kështu, Ministria e Financave ka bërë disa përpjekje për ta adresuar këtë përmes qarkoreve buxhetore, të cilat inkurajojnë organizatat buxhetore të paraqesin një aneks në buxhetet e tyre, duke përfshirë të dhënat në lidhje me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, në drejtim të përmbushjes së detyrimeve të tyre të përcaktuara në Ligjin për Barazinë Gjinore.¹³⁰ Qarkoret e buxhetit për ciklin e planifikimit të buxhetit 2019, 2020 dhe 2021 përcaktojnë se:

¹²⁴ Ministria e Financave, [Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023](#), f. 13.

¹²⁵ Po aty.

¹²⁶ Po aty, f. 65.

¹²⁷ Po aty, f. 74.

¹²⁸ Ligji Nr. 07/L-001 për Ndarjet Buxhetore të Republikës së Kosovës për Vitin 2020, mars 2020

¹²⁹ Ligji Nr. 07/L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 për Ndarjet Buxhetore të Republikës së Kosovës për Vitin 2020, gusht 2020.

¹³⁰ Ministria e Financave, Qarkorja e Buxhetit 2020/01, 2019; Qarkorja e Buxhetit 2020/02 për Komunitat, 2019; Qarkorja e Buxhetit 2021/01, 2020; Qarkorja e Buxhetit 2021/02, 10 Gusht 2020; Qarkorja e Buxhetit 2021/02, për organizatat qendrore të buxhetit, 16 shtator 2020; dhe Qarkorja e Buxhetit 2021/03, 14 shtator 2020. Vetëm Qarkorja e Buxhetit 2020/02 për nivelin qendror nuk përfshinte një kërkesë për organizatat buxhetore për të paraqitur një aneks të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (Qarkorja e Buxhetit 2020/02 për nivelin qendror, 2019).

Institucionet e Kosovës janë përgjegjëse për “përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si mjet i domosdoshëm për të siguruar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe alokimin e burimeve” (neni 5.1.5). Prandaj, organizatat buxhetore duhet të bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë gjinore në buxhetin vjetor [2020; 2021]. Kjo gjithashtu do të kontribuojë në rritjen e efektivitetit dhe transparencës së menaxhimit të financave publike. Komunitat duhet t’i marrin parasysh këto udhëzime në nxjerrjen e qarkores së brendshme komunale si dokument bazë për planifikimin e buxhetit komunal [për periudhën 2020-2022; 2021-2023]. Nëse ka paqartësi në këtë drejtim, organizatat buxhetore mund të konsultohen me analistë përkatës brenda Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave.¹³¹

Qarkoret buxhetore përfshijnë një aneks me një formular për sigurimin e këtij informacioni. Për më tepër, Qarkorja e Buxhetit 2021/01, e miratuar nga qeveria e mëparshme, gjithashtu inkurajon angazhimin e ZBGj-ve në procesin e buxhetit: “kur buxheti do të propozohet, organizata buxhetore duhet të adresojë në mënyrë korrekte vërejtjet dhe propozimet e zyrtarit përgjegjës për Barazi Gjinore të organizatës buxhetore.”¹³² Udhëzimet e tij brenda qarkoreve buxhetore janë në përputhje me treguesin MPGJFP 3 për qarkoren e buxhetimit të përgjeshëm gjinor.

Në korrik 2020, 34 nga 38 (89%) e komunave kanë përfshirë buxhetimin e përgjeshëm gjinor në KASH (3) ose draft buxhetin e tyre (31). Pasi që këto ndryshonin, analiza të mëtejshme kërkoheshin për të vlerësuar shkallën në të cilën secila ishte e përgjeshme në bazë gjinore. Analiza e mëtejshme gjithashtu mund të vlerësonte shkallën në të cilën Korniza Buxhetore Afatmesme e secilës komunë për vitet 2020-2022 dhe 2021-2023 përfshinte objektivat dhe treguesit drejt barazisë gjinore, dhe nëse buxhetet e tyre vjetore përfshinin aneksin e kërkuar të buxhetimit të përgjeshëm gjinor.

Mes rishikimeve të buxhetit për të adresuar COVID-19, dy qarkore buxhetore synojnë të mbështesin organizatat buxhetore në përgatitjen e KASH-it të rishikuar, përfshirë informimin e buxheteve të tyre të rishikuara për vitin 2020 bazuar në KASH-in e ri.¹³³ Të dyja këto kërkuan anekse të buxhetimit të përgjeshëm gjinor. Prandaj, këto anekse duhej të përmbanin analiza gjinore për të informuar ndryshimet në buxhetet e tyre për të adresuar pandeminë COVID-19, si dhe për të identifikuar grupet e parashikuara të grave dhe burrave. Deri nga nëntori, RrGK nuk kishte marrë ende informacione nëse organizatat buxhetore dorëzuan anekset e tyre të rishikuara të buxhetimit të përgjeshëm gjinor së bashku me rishikimet e propozuara të buxhetit.

Për ciklin e planifikimit të buxhetit 2021, nga 51 organizatat buxhetore në nivelin qendror, 14% paraqitën anekset e tyre buxhetore të përgjeshme gjinore me KASH-in e tyre dhe 73% me projekt-buxhetin e tyre; në nivelin komunal, 37% e 38 organizatave buxhetore dorëzuan anekset e tyre me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH-in) dhe 74% me projekt-buxhetet e tyre. Kështu, edhe pse qarkoret buxhetore kanë qenë të përgjeshëm gjinor sipas indikatorit MPGJFP 3, jo të gjitha organizatat buxhetore paraqesin vazhdimisht informacionin e kërkuar.

¹³¹ Po, aty.

¹³² Qarkorja e Buxhetit 2021/01, 2020, f.6.

¹³³ Ministria e Financave, Qarkorja e Buxhetit 2021/02, 16 Shtator 2020; dhe Qarkorja e Buxhetit 2021/03 për komunat, 14 shtator 2020.

Përmbledhje e masave fiskale, të buxhetuara dhe të shpenzuara, për të adresuar COVID-19

Ky seksion përmbledh buxhetin e planifikuar të qeverisë dhe shpenzimet në lidhje me adresimin e COVID-19. Kjo ka të bëjë me dimensionin MPGJFP 1.1. në analizën e ndikimit gjinor të propozimeve të politikës së shpenzimeve, duke shqyrtuar nga një makro-perspektivë se si shpenzimet e planifikuara kanë potencialin për të ndikuar ndryshe tek gratë dhe burrat. Tabela 2 ilustron masat dhe shumën e buxhetuar për masa.

Tabela 2


Masa	Buxheti
Pakoja Emergjente Fiskale (Totali)	179,650,000 €
I - Pagesa e dyfishtë e vlerës së skemës sociale për të gjithë përfutuesit të skemave sociale për muajin Prill dhe Maj	7,650,000 €
Masa 2- Pagesa shtesë në vlerë prej 30 € në muaj për të gjithë përfutuesit e skemave sociale dhe pensionale që marrin pagesë mujore në vlerë më të ultë se 100 € për muajin Prill, Maj	13,000,000 €
Masa 3 – Mbulimi i shpenzimeve të pagave mujore të punonjësve në vlerë prej 170€, për muajin Prill dhe Maj.	41,000,000 €
Subvencioni i qirasë deri në 50% të vlerës së qirasë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, për muajin Prill dhe Maj.	12,000,000 €
Mbulimi i vlerës së kontributeve pensionale për pagat lidhur me masat e parapara me këtë vendim për muajin Prill dhe Maj.	8,000,000 €
Masa 4 – Sigurimi i huadhënies pa interes për ndërmarrjet publike që kanë vështirësi financiare për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik, me qëllim të sigurimit të likuiditetit të përkohshëm të tyre, me kthim deri më 31.12.2020.	20,000,000 €
Masa 5 – Sigurimi mbështetjes shtesë financiare për Komunitetet e Republikës së Kosovës që janë ndikuar në përballje me pandeminë, në rast nevojë për shkak të zgjatjes eventuale të situatës së emergjencës së shëndetit publik.	10,000,000 €
Masa 6 – Sigurimi i shtesës mbi pagë në vlerë prej 300 € për punëtorët në terren dhe që janë të ekspozuar drejtpërdrejt rrezikut të infektimit në punën e tyre.	15,000,000 €
Masa 7 – Pagesë shtesë në vlerë prej 100€ për punëtorët e dyqaneve ushqimore, furrave dhe farmacive për muajin Prill dhe Maj.	3,000,000 €
Masa 8 – PAGESA E ASISTENCËS MUJORE NË VLERË PREJ 130€) euro për qytetarët që humbin vendin e tyre të punës për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik, për muajin Prill, Maj dhe Qershor.	4,000,000 €
Masa 9 – Mbështetja e iniciativave dhe projekteve që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës, që janë goditur më rëndë nga situata e emergjencës së shëndetit publik.	2,000,000 €
Masa 10 – Mikro-ndërmarrjet dhe të vetë-punësuarit nëpërmjet programeve të caktuara të Fondit për Garantimin e Kreditorit të Kosovës, në shumën 10,000€ për periudhën 24 muajsh.	15,000,000 €
Masa 11 – Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për rritje të prodhimit bujqësor.	5,000,000 €
Masa 12 – Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për evitimin e situatës së krijuar nga situata e emergjencës së shëndetit publik në aktivitetet sportive dhe kulturore.	5,000,000 €
Masa 13 – Mbështetje për eksportuesit në Republikën e Kosovës pas përfundimit të situatës së emergjencës së shëndetit publik.	10,000,000 €
Masa 14 – Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që regjistrojnë punëtorët me kontratë pune së paku 1 vjeçare gjatë periudhës së situatës së emergjencës së shëndetit publik, nga 130€ për dy muajt pasues pas regjistrimit.	6,000,000 €
Masa 15 – PAGESA E ASISTENCËS MUJORE NË VLERË PREJ 130€ për qytetarët me kushte të rënda sociale, të lajmëruar si të papunë në institucionin kompetent, që nuk janë përfutues të asnjë të hyre mujore nga buxheti i Kosovës, për muajin Prill, Maj dhe Qershor.	3,000,000 €

Plani për zbatimin e rimëkëmbjes ekonomike	365,000,000 €
MASA 1 – Lehtësimi i qasjes në kredi për ndërmarrjet private, për të financuar projekte investive dhe vazhdimin e operimit.	100,000,000 €
MASA 1A – Rritja e mbulueshmërisë së kredive të reja përmes Fondit Kosovar për Garanci të Kredive.	60,000,000 €
MASA 1B – Mbulimi i kostos së tarifës së Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë.	5,000,000 €
MASA 1C – Ri-programimi i kredive bankare ekzistuese, ku koston e ri-programimit e merr Qeveria.	30,000,000 €
MASA 1D – Subvencionimi i normave të interesit për sektorë të caktuar bazuar në një plan strategjik të përgatitur nga akterët relevant.	5,000,000 €
MASA 2 – Lehtësimi i barrës tatimore të bizneseve, për të përmirësuar likuiditetin e tyre afatshkurtër.	15,000,000 €
MASA 2A – Shtyrje e pagesës së tatimeve bazuar në nevojat e bizneseve.	
MASA 2B – Mbulimi i 5% të kontributit pensional që biznesi paguan për punëtorë.	5,000,000 €
MASA 2C – Pushimet tatimore për firmat për sektorë të caktuar bazuar në një plan strategjik të përgatitur nga akterët relevant.	
MASA 2D – Lirimet për parapagimet e obligimeve tatimore nga ana e bizneseve.	
MASA 2E – Lirimi i bizneseve nga ndëshkimet tatimore për vonesa në pagesën e tatimeve për shkak të pandemisë bazuar në kritere të qarta dhe transparente.	
MASA 2F – Ofrimi i mundësisë për ri-programim të borxheve tatimore të mëparshme, duke përfshirë edhe zbritjet për pagesën e menjëhershme të borxhi.	
MASA 2G – Subvencionimi i 50% të shpenzimeve të qirasë për biznese.	10,000,000 €
MASA 3 – Rritja e punësimit, në veçanti e grupeve specifike të punëtorëve me gjasa më të ulëta për punësim.	67,300,000 €
MASA 3A – Subvencionim i pagës për punëtorët në biznese të prekura nga pandemia për muajin Mars dhe Prill 170 euro.	47,300,000 €
MASA 3B – Subvencionim i pagës për punëtorët e rinj që marrin bizneset në punë bazuar në një plan që identifikon sektorët dhe kategorinë e punëtorëve më në nevojë.	5,000,000 €
MASA 3C – Përkrahja profesionale për biznese për funksionim në kushte pandemie, siç është puna nga shtëpia, puna online, transformimi digjital etj.	3,000,000 €
MASA 3D – Përkrahja e bizneseve prodhuese dhe shërbyese me pajisje dhe makineri për automatizim të proceseve.	10,000,000 €
MASA 3E – Përkrahja e bizneseve me qëllim rritjen e produktivitetit të tyre.	2,000,000 €
MASA 4 – Rritja e prodhimit bujqësor vendor, për të rritur punësimin në zonat rurale, për të zvogëluar importin e produkteve bujqësore, për të tejkaluar sfidat nga mungesa e shitjeve shkaktuar nga COVID-19 dhe për të rritur sigurinë e ushqimit.	26,000,000 €
MASA 4A – Dyfishimi i buxhetit për Programin për Pagesat Direkte vetëm për vitin 2020.	24,000,000 €
MASA 4B – Subvencionimi i normave të interesit të kredive në bujqësi.	2,000,000 €
MASA 5 – Stimulimi i kërkesës agregate, e cila nxit prodhimin dhe punësimin me efekte multiplikuese në ekonomi.	15,000,000 €
MASA 5A - Lejimi i tërheqjes së shumës prej 10% të mjeteve të kursyera në Trustin Pensional për kontribut-paguesit, bazuar në nevojat e tyre, e cila mundësi mund të shfrytëzohet për një periudhë 4-mujore.	
MASA 5B – Mbështetje për zgjatjen e greis periudhës për blerje të banesave dhe shtëpive bazuar në kritere të të ardhurave.	15,000,000 €
MASA 6 – Mbështetje e operimit dhe investimeve kapitale të ndërmarrjeve publike, në veçanti ato investime që janë të natyrës strategjike, që të përballojnë uljen e të hyrave nga inkasimi dhe investimet e nevojshme kapitale që duhet të ndërmarrin.	17,000,000 €
MASA 6A – Mbulimi i kostove minimale operative të ndërmarrjeve publike.	14,000,000 €
MASA 6B – Rishikimi i planit dinamik të investimeve kapitale të ndërmarrjeve publike dhe vlerësimi i investimeve të nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve publike.	
MASA 6C – Mbështetje e investimeve të ndërmarrjeve publike përmes subvencionimit nga buxheti, huadhënies nga buxheti dhe lëshimit të garancioneve sovraane për kreditë që ndërmarrjet publike marrin në institucionet financiare.	3,000,000 €
MASA 7 – Mbështetje financiare për punësimin e të rinjve, përkrahjen e organizatave të shoqërisë civile, grupeve tjera jo formale, stimulimit të aktiviteteve kulturore, artistike, sportive dhe ri-vitalizimit të tyre.	5,000,000 €

MASA 8 – Mbështetje për programe ekzistuese dhe të reja që lidhen me zhvillimin rajonal përmes Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, që ndikojnë në zhvillimin e balancuar rajonal.	2,000,000 €
MASA 9 – Mbështetje komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës, për projektet dhe iniciativat që synojnë përmirësimin e jetës dhe rigjallërimin ekonomik të tyre.	2,000,000 €
MASA 10 – Mbështetje financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë përmirësimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe ekonomi.	2,000,000 €
MASA 11 – Mbështetje e sektorit të arsimit për të mundësuar fillimin dhe mbarëvajtjen me sukses të mësimin gjatë vitit shkollor 2020/2021.	10,000,000 €
MASA 12 – Mbështetje për komunat e Kosovës për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.	10,000,000 €
MASA 13 – Mbështetje financiare për bashkatdhetarët duke mbuluar koston e primit të policës së sigurimit.	3,000,000 €
MASA 14 - Financimi (rimbursimi i linjave buxhetore) për zbatimin e masave të vendimit Nr. 01/19 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.	71,700,000 €
MASA 15 – Kontigjencë për emergjenca – Kontigjenca mbahet për raste emergjente për përbalim më të mirë të pandemisë COVID-19.	19,000,000 €

Një pamje holistike e shpenzimeve totale shtetërore të planifikuara në lidhje me COVID-19 ilustron një fokus të fortë qeveritar në ekonomi. Pakoja Fiskale Emergjente parashikoi të paktën 84 milion €, 49% të të gjithë financimit të shtetit, për bizneset (Grafiku 8). Duhet të theksohet se disa prej tyre u përqëndruan në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), të cilat potencialisht mund të mbështesin ekonominë lokale, siç diskutohet më vonë. Do të jetë e rëndësishme të monitorohet përdorimi i këtyre fondeve për të identifikuar se cilat biznese përfitojnë dhe si kjo kontribuon në mirëqenien afatgjatë midis grave dhe burrave në komunitetet e prekura. Një shtesë prej 20 milion € u ndanë për të mbështetur ndërmarrjet publike (12%) dhe 5 milion € për sektorin e bujqësisë (3%). Fonde u caktuan gjithashtu për komunitetet pakicë dhe komunat, të cilat gjithashtu mund të kenë mbështetur bizneset lokale. Do të kërkohet një monitorim shtesë për të ditur se si janë përdorur shpenzimet e tilla. Njerëzit përfitonin drejtpërdrejt nga përfitimet e ndihmës sociale (14%) dhe përfitimet e papunësisë (2%). Veçanërisht, kjo pako nuk përfshinte ndonjë financim për sektorin e shëndetësisë ose sektorin e arsimit.


Grafiku 8. Masat fillestare të pakos emergjente fiskale sipas llojit të përfituesit



Pakoja Fiskale Emergjente parashikoi të paktën 84 milion €, 49% të të gjithë financimit të shtetit, për bizneset

Grup i dytë i masave të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike parashikon në mënyrë të ngjashme që shumica dërmuese e fondeve të shtetit do të shkojnë për bizneset 182.3 milion euro (50%), përfshirë huatë, do të ulin kontributet tatimore dhe ofrojnë subvencione për kompanitë që krijojnë vende pune (Grafiku 9) Një shtesë prej 17 milion euro (5%) është propozuar për ndërmarrjet publike

Grafiku 9. Masat e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike



Krahasimisht është planifikuar më pak për arsimin (10 milion €, 3%).Fonde të tjera janë planifikuar për rimbursimin e shpenzimeve para-ekzistuese (20%), komunat (3%), komunitetet pakicë (<1%) dhe zhvillimin rajonal (<1%), të gjitha këto do të kërkonin monitorim për të kuptuar më mirë se çfarë dhe kë mbështesin konkretisht. Krahasimisht, më pak është planifikuar për arsimin (10 milion €, 3%). Ndërsa fondet janë caktuar për të inkurajuar kërkesën e konsumatorit (duke zgjatur greis periudhën për blerjen e shtëpive), komunitetet e pakicave, gratë, artet dhe shoqërinë civile, ato janë dukshëm më pak në krahasim. Duket se nuk janë alokuar fonde për forcimin e sektorit shëndetësor.

Ekzaminimi i fondeve nga organizata buxhetore tregon se shumica e fondeve të buxhetuara për (dhe të shpenzuara në mënyrë të ngjashme) në lidhje me COVID-19 kaluan përmes MEA (51%), duke arritur në më shumë se 76 milion € në shtator 2020, sipas raportit nëntë mujor i LIVTh; këto fonde kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik dhe subvencionet për bizneset, siç detajohen më vonë në këtë kapitull. Siç ilustron Grafiku 13, përqindja tjetër më e madhe e fondeve që lidhen me COVID-19 ishin buxhetuar për MPMS (23%), në shumën prej 34.5 milion € për shpërndarjen e ndihmës sociale dhe skemat e pensioneve. Më pak shuma të buxhetuara mbështetën komunat (8%), 11,8 milion €, gjithashtu përgjegjëse për disa shërbime, pas decentralizimit. Ministria e Shëndetësisë (7%, 10 milion €) dhe Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (5%, 7,5 milion €) morën relativisht më pak fonde shtetërore, pasuar nga Ministria e Punëve të Brendshme (5%, 6,6 milion).

Grafiku 10. Buxheti për COVID-19 sipas Organizatave Buxhetore nga janari në shtator

Organizatave Buxhetore	Buxheti	Shpenzimet	% e Buxhetit Total
Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit	76,497,014 €	75,127,322 €	51%
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	34,522,156 €	34,450,626 €	23%
Ministria e Shëndetësisë	10,048,383 €	7,904,814 €	7%
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	7,497,541 €	7,498,801 €	5%
Ministria e Punëve të Brendshme	6,647,170 €	6,553,762 €	4%
Komunat	11,819,843 €	9,713,949 €	8%
Tjetër	1,744,799 €	1,455,575 €	1%

Sipas raportit nëntëmujor të LIVTh për janar deri në shtator 2020, shpenzimet arritën në 143,363,771 euro për pagesa dhe transaksione në lidhje me kodin buxhetor 00099 për adresimin e COVID-19. Shpenzime të tjera mund të kenë ndodhur, por këto nuk mund të gjurmohen lehtë. Një përmbledhje e raportit të LIVTh ilustron se shumica e fondeve të shpenzuara gjatë kësaj periudhe shkuan drejt ekonomisë dhe zhvillimit të biznesit (52%), pasuar nga ndihma sociale dhe pensionet (24%) (Grafiku 11). Sektori i shëndetësisë mori 15% të fondeve dhe administrata e përgjithshme dhe qeverisja 6%. Të gjitha shpenzimet e tjera sipas sektorëve arritën në më pak se 1% të fondeve.

Grafiku 11. Fondet e buxhetuara dhe të shpenzuara sipas sektorëve (në mijëra) nga janari deri në shtator 2020


Lloji i shpenzimeve	Të buxhetuara	Të harxhuara
Administrim i përgjithshëm	€ 10,238,048	€ 8,856,982
Bujqësi	€ 50,525	€ 27,860
Inspektimet / Monitorimi	€ 172,920	€ 172,620
Shëndetësi	€ 24,003,712	€ 21,626,249
Edukim	€ 148,861	€ 112,225
Karantina / Shërbime rezidenciale	€ 674,119	€ 597,962
Puna / Punësimi	€ 22,050	€ 22,050
Ekonomia / Zhvillimi i Biznesit	€ 76,807,260	€ 75,128,582
E paqartë	€ 112,770	€ 112,770
Ndihma Sociale, Pensionet	€ 34,134,196	€ 34,062,666
Siguria, Policimi, Korrigjimet	€ 1,248,055	€ 1,098,708
Ndihma juridike	€ 9,900	€ 3,326
Transport	€ 376,971	€ 264,370
Mjedisi dhe Planifikimi Hapësinor	€ 317,784	€ 169,753
Media	€ 4,000	€ 1,777
Art, Kulturë, dhe Sport	€ 59,015	€ 31,003
Zjarrëfikësit	€ 361,305	€ 361,305
Shërbime Sociale	€ 255,640	€ 253,140
Buxheti i Përgjithshëm	€ 425,300	€ 335,833
Menaxhimi i ndërtesave qeveritare	€ 64,965	€ 59,652

Kjo ndarje e përgjithshme e buxhetit dhe shpenzimeve përkatëse për COVID-19 ilustron theksin e fortë të qeverisë në ekonomi dhe zhvillimin e biznesit.


Transaksionet në lidhje me COVID-19 ndodhën në të gjitha kategoritë ekonomike të buxhetit (Grafiku 12). Deri më tani, shumica e transaksioneve kanë ndodhur në kategorinë “Subvencione dhe Transfere”. Kjo nuk është për t’u habitur duke pasur parasysh sasinë e konsiderueshme të fondeve të planifikuara për ndihmën sociale dhe ndihmës bizneseve.

Grafiku 12. Fondet për të adresuar COVID-19 sipas kategorisë ekonomike (në miliona)

■ Të buxhetuara ■ Të harxhuara



Grafiku 13. Zbatimi i masave që nga 17 korriku



Megjithëse raporti i LIVTh është mjaft i detajuar dhe pasqyron të gjitha shpenzimet, ai nuk përmban informacion mbi përfituesit. As nuk reflekton në masën në të cilën këto shpenzime iu përgjigjën nevojave të ndryshme të grave dhe burrave, ose nëse ato avancuan barazinë gjinore. Këto çështje diskutohen në seksionet që vijojnë, në lidhje me masat individuale, aty ku janë në dispozicion.

Saipërketzbatimit, sipas Institutit Demokratik të Kosovës, nga 17 korriku, vetëm masat e Pakos Fiskale Emergjente 1, 2, 6 dhe 15 u zbatuan pothuajse tërësisht; masat 5, 9, 10, 11, 12 dhe 13 nuk janë zbatuar fare; masa 3 u zbatua për 42%, masa 4 për 50%, masa 7 për 42%, masa 8 për 3% dhe masa 14 për 31% (shih Grafikun 13).

Përveç informacionit të limituar që prezantohet në kapitujt e ardhshëm, asnjë informacion tjetër i përditësuar nuk ishte i qasshëm në lidhje me zbatimin e Pakos Fiskale Emergjente gjatë kohës së këtij hulumtimi.

Ndërsa seksionet që vijojnë në këtë kapitull përqendrohen në masat individuale, ekzistuese, duhet të vërehet se alokimi i fondeve nëpër masa të ndryshme mund të ketë ndikime në barazinë gjinore. Për shembull, fakti që më shumë fonde u shpenzuan për bizneset sesa për arsim mund të ketë implikime për gratë, të cilat janë të nënpërfaqësuar në mesin e pronarëve të bizneseve dhe të përfaqësuar tepër nga kujdestaret që ndihmojnë fëmijët me arsim gjatë shkollimit në shtëpi. Siç detajohet më vonë në këtë raport, masat e izolimit pandemik dhe shoqërues kanë zhvendosur përgjegjësitë nga sektori publik në familjen private dhe kanë rritur sasinë e kohës së shpenzuar për punë të kujdesit të papaguar dhe arsimim brenda familjeve, të gjitha duke kontribuar në humbje të vendeve të punës dhe të ardhurave. Në shumë mënyra, barra e trajtimit të krizës është zhvendosur nga shteti në familje, ku në veçanti gratë mbajnë barrën më të madhe shtesë të punës së papaguar, duke pasur parasysh normat tradicionale gjinore. Prandaj, edhe një herë gratë përballen me një “rrezik të trefishtë” si përdoruesit kryesorë dhe ofruesit e shërbimeve publike dhe më shumë të ngjarë të rrisin punën e papaguar për të zëvendësuar shërbimet e humbura. Duke i dhënë përparësi fondeve për bizneset sesa investimeve në infrastrukturën sociale, veçanërisht shërbimeve të kujdesit, qeveria me shumë gjasë do të përforcojë pabarazitë para-ekzistuese, siç diskutohet në seksionet që vijojnë.

Masat sociale

Kjo pjesë shqyrton shkallën në të cilën masat sociale të marra nga qeveria konsideruan ndikimet e mundshme mbi gratë dhe burrat, si dhe mënyrën se si ato ndikuan te gratë dhe burrat. Një tabelë e detajuar është e dhënë në Shtojcën 7.

Masat parandaluese sociale të qeverisë për izolim, të cilat filluan më 11 mars, megjithëse ishin të nevojshme për të parandaluar përhapjen e virusit, patën ndikim negativ te prindërit, veçanërisht te gratë e punësuar. Duke pasur parasysh normat tradicionale gjinore të socializuara, gratë në mënyrë disproporcionale kishin përgjegjësinë sociale të qëndronin në shtëpi për t'u kujdesur për fëmijët e tyre kur u mbyllën institucionet arsimore dhe të kujdesit për fëmijët. Qeveria nuk mori në konsideratë ndikimin disproporcional që kjo do të kishte mbi gratë, përfshirë rrezikun në rritje të humbjes së punës me të cilin përballëshin për shkak të përgjegjësisë të kujdesit për fëmijët. Prandaj, masat sociale që përfshinin mbylljen e institucioneve arsimore, pa mundësi alternative për kujdesin ndaj fëmijëve, konsiderohen negative në bazë gjinore; ato përforcuan dhe madje përkeqësuan pabarazitë gjinore.

Një masë tjetër parandaluese, siç u përmend, hyri në fuqi më 24 mars kur qeveria kufizoi lëvizjen, duke pezulluar transportin publik ndër-urban. Vetëm rreth 10% e veturave në Kosovë janë në pronësi të grave, dhe 30% e shoferëve janë gra. Meqenëse gratë kanë më pak të ngjarë të posedojnë ose të

kenë qasje në automjete private për transport, kjo masë ka të ngjarë të ketë pasur ndikim negativ më të madh te gratë sesa te burrat. Gratë që jetojnë larg vendit të tyre të punës, veçanërisht që udhëtojnë nga zonat rurale në ato urbane, patën vështirësi për të shkuar në punë. Ndërprerja e transportit publik mund të vlerësohet si ndërhyrje negative në bazë gjinore, pasi ka gjasa që ka rritur pabarazitë gjinore në qasjen në punë dhe kujdesin shëndetësor.

Masat përfshinin gjithashtu kufizime të lëvizjes nga ora 10:00 deri në 16:00 dhe 20:00 deri në 06:00. Në prill, masat ndryshuan dhe i lejuan secilit qytetar vetëm 90 minuta dalje jashtë gjatë ditës. Individëve iu caktua koha bazuar në numrat e tyre individual të identifikimit. Gratë priren të jenë më të rrezikuara nga dhuna gjatë natës sesa burrat, që do të thotë që gratë të caktuara në mënyrë të rastësishme në oraret e mbrëmjes mund të përballëshin me rreziqe më të mëdha sesa burrat kur dilnin për tu furnizuar. Për më tepër, nënat vetushqyese, gratë kryefamiljare ose gratë përgjegjëse për fëmijët me aftësi të ndryshme ose personat e moshuar kishin vështirësi të linin shtëpitë e tyre në mbrëmje ose pa personat nga të cilët varen. Kjo mund të parandalonte gratë veçanërisht në sigurimin e ushqimit, barnave dhe produkteve të tjera esenciale. Prandaj, caktimi i kohërave pa marrë parasysh gjininë mund të konsiderohet masë negative në bazë gjinore.

Në maj, masat u liruan dhe njerëzit mund të dilnin dy herë në ditë për 90 minuta, me gjithsej tri orë në ditë. Gradualisht, kufizimet në lëvizje u hoqën dhe u zbatuan oraret e ndalimit. Kjo ndodhi me ndërprerje rast pas rasti kur numri i rasteve të reja u rrit në rajone ose qytete të ndryshme. Para 18 majit, dhe periodikisht pas, shumë institucione publike dhe private kanë punuar me staf të kufizuar, ndërsa të tjerët kanë punuar nga shtëpia. Në këto masa, aspekti gjinor nuk është konsideruar. Në të vërtetë, duke pasur parasysh përgjegjësitë e kujdesit, gratë u përballen me sfida të shtuara në koordinimin e punës së tyre në shtëpi, në zyrë dhe punën e kujdesit.

Masat e izolimit gjithashtu kanë kontribuar në depresion dhe stres tek burrat, të cilët nuk janë mësuar të qëndrojnë në shtëpi. Problemet financiare, rreziku nga varfëria dhe përgjegjësitë në rritje të kujdesit ndaj fëmijëve që kërcënuan identitetin mashkullor dhe pozicionin tradicional të pushtetit të burrave, kontribuan në frustrimin tek disa burra dhe rritjen e gjasave të shfaqjes së dhunës në familje. Humbja e punës për shkak të pandemisë, kërcënimet në identitetin mashkullor, izolimi i zgjatur dhe aftësia e kufizuar e grave për t'i shpëtuar marrëdhënieve abuzive ka kontribuar në rritje të rasteve të dhunës në familje në gjithë botën. Ndërkohë, marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit midis grave dhe burrave, që rezultojnë nga normat dhe marrëdhëniet patriarkale gjinore, janë faktorët kryesorë që kontribuojnë në dhunën ndaj grave. Personat që përballen me dhunën në familje, kryesisht gratë dhe fëmijët, ishin bllokuar në shtëpi me abuzuesit e tyre. Në prill të vitit 2020, kishte një rritje prej 21% të rasteve të raportuara në Policinë e Kosovës, krahasuar me marsin e vitit 2019 (shih Grafikun 14).

Mes masave të izolimit, gratë që përjetonin dhunë në familje u lejuan të linin shtëpitë e tyre në çdo moment, që ti shpëtonin situatës së dhunshme. Për më tepër, Agjencia për Barazi Gjinore hapi strehimore emergjente më 29 prill për gratë që prisnin rezultatet e testit ose të cilat kishin rezultuar pozitive për COVID-19 për të pasur një vend për të qëndruar derisa të shkonin në strehimore të rregullt, në mënyrë që të mos vinin në rrezik stafin e strehimores ose personat e tjerë. Kjo strehimore e përkohshme u themeluar me mbështetjen e UN Women dhe UNFPA, e cila siguroi pako esenciale higjienike, rroba, pajisje mbrojtëse personale dhe sende të tjera të nevojshme për të strehuarit. Strehimorja mbështeti 40 persona, duke u ofruar atyre siguri, ushqim, mjete sanitare dhe ndihmë tjetër. Agjencia për Barazi Gjinore bashkëpunoi ngushtë me ministritë e Shëndetësisë, Drejtësisë, Punëve të Brendshme dhe Punës dhe Mirëqenies Sociale. Punonjësit socialë kishin qasje në strehimore, pasi duhej të ishin aty në çdo kohë nëse dikush transferohej nga një vend tjetër jashtë Prishtinës.

Hapja e kësaj strehimore së përkohshme nga qeveria mund të vlerësohet si ndërhyrje pozitive gjinore, pasi parandaloi dhunën e mëtejshme, si dhe uli rrezikun e grave që punojnë në strehimore dhe të mbijetuarve të dhunës të kontraktuara të virusin COVID-19.

Grafiku 14. Rastet e raportuara të dhunës në familje nga janari në nëntor në 2019 dhe 2020



Masat ekonomike dhe adresimi i tyre i pabarazive gjinore


Ky seksion vlerëson se deri në çfarë mase masat ekonomike për adresimin e pasojave që lindën me pandeminë COVID-19 konsideruan ndryshimet dhe pabarazitë ekzistuese gjinore, si dhe çdo ndikim fillestar që këto masa mund të kenë pasur te gratë dhe te burrat. Ky fillon me analizë të shkurtër gjinore për të vendosur kontekstin duke identifikuar pozitat e ndryshme të grave dhe burrave në ekonomi para dhe gjatë pandemisë. Kjo analizë gjinore vendos bazën për një diskutim të masave ekonomike të qeverisë, i cili vijon.

Analizë e shpejtë gjinore e pabarazive gjinore në ekonomi, para dhe gjatë pandemisë

Para krizës, shkalla e papunësisë në vitin 2019 ishte 25.7%, sipas KAS. Papunësia ishte më e lartë tek gratë (34.4%), sesa tek burrat (22.6%). Në tremujorin e parë të vitit 2020, niveli i papunësisë ishte 25% (30.6% tek gratë dhe 23% tek burrat) (shih Grafikonin 14). Shkalla më e lartë e papunësisë është tek

gratë e reja 15 deri në 24 vjeç (60.3%). ASK nuk ofron të dhëna të disponueshme për publikun lidhur me punësimin dhe shkallën e papunësisë sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike, aftësisë ose vendndodhjes gjeografike. Gratë gjithashtu janë të mbipërfaqësuar në mesin e të papunëve afatgjatë, domethënë personave të papunë për më shumë se një vit (65.4% e burra dhe 74.4% e grave në 2019; 67.7% e burrave dhe 65.8% e grave në). Grafiku 15 sugjeron që papunësia në të vërtetë u zvogëluar në mesin e grave në fillim të vitit 2020, ndërsa u rrit lehtë te burrat. Sidoqoftë, që nga fillimi i dhjetorit 2020, ASK nuk kishte ende të dhëna të disponueshme për tremujorin e dytë të vitit 2020, domethënë kur ndikimi fillestar i COVID-19 në nivelet e papunësisë do të bëhej i dukshëm. As nuk kishte të dhëna mbi atë se cilët sektorë janë prekur më shumë, cilët mund të kenë implikime gjinore, që japin stereotipet profesionale dhe mbipërfaqësimin e grave dhe burrave në sektorë të veçantë.

Grafiku 15. Papunësia mes burrave dhe grave në 2019 dhe TM1 2020




Gratë priren të punësohen në arsim, tregti dhe kujdes shëndetësor (53.0%), ndërsa burrat janë punësuar kryesisht në tregti, ndërtim dhe prodhim (46.3%). Të gjithë këta sektorë ka të ngjarë të preken nga COVID-19, pasi shkollat, vendet e ndërtimit, dyqanet me pakicë dhe impiantet e prodhimit ishin ose të mbyllura ose përballëshin me protokolle intensive të distancimit social. Ashtu si kudo në botë, gratë në Kosovë janë të mbipërfaqësuar në profesione me një rrezik veçanërisht të lartë të infektimit me COVID-19, duke punuar në qendra shëndetësore, institucione arsimore, barnatori dhe supermarkete. Sistemi i shëndetit publik të Kosovës karakterizohet gjithashtu nga përfaqësim i madh i grave. Në vitin 2019, nga 13,518 të punësuar në institucionet shëndetësore publike, 8,245 janë gra (61%) dhe 5,270 janë burra (39%). Kjo sugjeron që gratë ishin më të ekspozuara ndaj rrezikut të infeksionit si pikat e para të kontaktit me personat e infektuar që kërkojnë kujdes. Me rritjen e rasteve, punonjësit e kujdesit shëndetësor gjithashtu kishin ndërrime të pandërprera. Gratë që punojnë në sektorë thelbësorë, veçanërisht ato me rreziqe më të larta të infektimit, shprehën shqetësimin për familjet e tyre që të jenë të sigurta, veçanërisht nëse do të duhej të linin fëmijët e tyre vetëm në shtëpi për shkak të mbylljes së shkollave.

Provat cilësore nga intervistat sugjerojnë që masat kufizuese të qeverisë, duke filluar nga marsi, rezultuan në humbjen e vendeve të punës. Disa punëdhënës raportuan se përdorën pandeminë si arsye për të ndërprerë kontratat e punës të disa grave., Për shembull, edhe pse e drejta e grave për pushim të lehonisë të paguar nga punëdhënësi mbrohet me ligj, të paktën një rast i njohur ekzistonte kur punëdhënësi i ndërpreu kontratën një gruaje kur ajo shkoi në pushim të lehonisë, duke ia atribuar atë pushimeve nga puna që kishin të bënin me COVID-19. Disa biznese në pronësi të grave si sallone

bukurie dhe rrobaqepës raportohet se u mbyllën gjatë karantinës.

Sipas Agjencisë së Punësimit të Kosovës (APK), numri i punëkërkuesve u rrit ndjeshëm që nga marsi, me rreth 37,000 persona të regjistruar si të papunë në katër muajt e parë të vitit 2020; kjo ishte pesë herë më shumë njerëz sesa në dhjetor 2019. Kjo është një rritje e madhe kur krahasohet me katër muajt e fundit të vitit 2019, kur numri i punëkërkuesve arriti në 6,882. Sipas APK, Kosova rezultoi me 73,407 më shumë punëkërkues nga janari deri në qershor 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë në 2019 (Grafiku 16). Një rritje e jashtëzakonshme mund të vërehet në prill dhe maj 2020, veçanërisht duke e krahasuar me vitin 2019. Kjo rritje e konsiderueshme mund t'i atribuohet pjesërisht masës qeveritare të miratuar në 30 mars, e cila përcaktonte që qytetari duhet të regjistrohet si i papunë në mënyrë që të kërkojë përfitime. Në të vërtetë, edhe pse ishte vazhdimisht më i lartë se në 2019, numri i punëkërkuesve u rrit qartë në prill 2020 pasi u miratua masa e re. Ndërkohë, pasi mbylljet e lidhura me karantinën gjithashtu filluan në mars, ishte e vështirë të përcaktohet se sa kërkues të rinj të punës u regjistruan sepse kishin humbur vendet e punës gjatë pandemisë dhe sa kishin qenë të papunë më parë, por vendosën të regjistroheshin për t'u kualifikuar për benefitin e ri të shtetit. Në përgjithësi, gjatë periudhës janar-tetor 2020, 200,577 punëkërkues të regjistruar në Agjencinë e Punësimit të Kosovës (45% gra dhe 54% burra). Kështu, që nga tetori i vitit 2020, Kosova kishte 129,787 më shumë punëkërkues sesa 70,790 punëkërkues të regjistruar deri në fund të vitit 2019 (pra, 46% gra dhe 54% burra). Nga punëkërkuesit, që nga tetori i vitit 2020, pas Masave Aktive të Tregut të Punës, ishin të punësuar 5,430 (52% gra dhe 48% burra). Në krahasim, në vitin 2019, nga 4,611 persona që u punësuan, kishte 2,198 (ose 47,7%) gra dhe 2,413 (ose 52,3%) burra që përfituan nga masat aktive të tregut të punës.

Grafiku 16. Numri i punëkërkuesve, janar - qershor 2019 dhe 2020




APK mban të dhëna për punëkërkuesit sipas moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, nivelit të arsimit dhe komunës/rajonit. Të dhënat në dispozicion për punëkërkuesit nga ASK i referohen vetëm gjinisë, nivelit të arsimit dhe komunës. Sipas APK, vazhdimisht më shumë burra regjistrohen si punëkërkues sesa gra (Grafiku 17). Krahasimi i punëkërkuesve me persona të papunë ilustron se edhe pse një përqindje më e lartë e grave sesa burrat janë të papunë, më shumë burra sesa gra kërkojnë punë. Në Kosovë, kjo përputhet me trendet e përgjithshme të pasivitetit, sipas të cilave më pak gra janë zyrtarisht aktive në tregun e punës ose që kërkojnë punë, sesa burrat.

Shkalla e ulët e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore (26.1%) krahasuar me burrat (73.9%), i është atribuar roleve gjinore shoqërore, ku gratë priren të qëndrojnë në shtëpi dhe të kujdesen për

fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të ndryshme, ndërsa burrat priren të punojnë jashtë shtëpisë. Mungesa e kujdesit për fëmijët në dispozicion, të përballueshëm, do të thotë që gratë nuk mund të punojnë sepse ato duhet të qëndrojnë në shtëpi për t'u kujdesur për fëmijët, duke pasur parasysh rolin e tyre tradicional të socializuar për tu kujdesur. Pronësia minimale e pronave të grave minon qasjen e tyre në kapital për hapjen ose zgjerimin e bizneseve. Për shkak të stereotipeve gjinore në punë, punëdhënësit mund të mos punësojnë gra për pozita që ata besojnë se janë “për burrat”. Projektimi i masave ekonomike do të duhet të marrë në konsideratë dhe të adresojë këto pabarazi themelore gjinore në mënyrë që të shmangët përforcimi i tyre.

Grafiku 17. Numri i punëkërkuessve sipas gjinisë, janar - tetor 2020



Globalisht, gratë priren të mbipërfaqësohen në ekonominë informale. Kjo mund të kontribuojë në nën-përfaqësimin e personave të punësuar në statistikat zyrtare dhe kështu të ulë nivelet e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore. Të dhënat e ndara sipas gjinisë për ekonominë informale në Kosovë janë të një cilësie të dobët. Vlerësimet e vjetruara bazuar në të dhënat e fuqisë punëtore nga 2012 sugjerojnë që shkalla e informalitetit mund të jetë më e lartë tek burrat (47%) sesa gratë (36%). Sidoqoftë, informaliteti prek qartë gratë dhe burrat në Kosovë. Dëshmitë cilësore kanë sugjeruar që gratë e punësuar në sektorin privat shpesh punojnë në mënyrë joformale, pa kontrata ose mbrojtje sociale. Ekzistojnë prova të mëtjshme të shkëlqeve të të drejtave të punës së grave në Kosovë, në lidhje me praninë e tyre në ekonominë informale, përfshirë punën pa kontrata, orë të gjata, kushte jo të volitshme të punës dhe shkëlqje të tjera të të drejtave. Gratë shpesh punojnë orë shtesë pa pagesë dhe kanë më pak shanse për tu qasur në mundësitë e zhvillimit profesional sesa burrat.

Gratë gjithashtu mund të punojnë në punë më fleksibile dhe të pasigurta, për shkak të përgjegjësive të punës së kujdesit të papaguar, përveç faktorëve të tjerë. Sipas ASK-së, më shumë gra (6.9%) punojnë me kohë të pjesshme sesa burrat (6.0%) në 2019. Më shumë gra cekën kujdesin për fëmijët ose të rriturit me aftësi të

Ne kemi parë raste të familjeve që janë kthyer nga një familje me një gjendje ekonomike modeste të qëndrueshme në një familje që ka nevojë për ndihmë sociale, dhe kjo është e vështirë si për burrin ashtu edhe për gruan.

— Zyrtar



“Nënat e fëmijëve me aftësi të kufizuara gjithmonë kanë sakrifikuar veten e tyre, duke punuar çdo lloj pune. Ata thjesht kishin nevojë të ishin në gjendje të siguronin [financiarisht] ilaçet që u duheshin fëmijëve të tyre. Në këtë kohë krize, atyre iu desh të bënin një sakrificë tjetër duke hequr dorë nga puna e tyre, edhe kur masat ishin të relaksuara dhe ata mund të punonin. Ata kanë frikë të infektohen dhe të vënë në rrezik jetën e fëmijëve të tyre.

— Përfaqësuesi i OSHC-ve që punon me grupe me nevoja të veçanta

ndryshme (0.6%) sesa burrat (0.0%) si arsye për të pasur një punë me kohë të pjesshme. Për më tepër, 10.9% e grave cekën arsye të tjera personale ose familjare si arsye për një punë me kohë të pjesshme, krahasuar me vetëm 3.6% të burrave që raportonin këtë. Në anën tjetër, arsyeja pse shumica e burrave punojnë me kohë të pjesshme nuk kishte mundësi të punës me kohë të plotë për ta (79.7%) krahasuar me 56.7% të grave që raportonin këtë. Kjo ka implikime negative për gratë siç janë shanset më të larta për të qenë në punë të pasigurt, me stabilitet më të ulët, mbrojtje të kufizuar sociale dhe qasje në kredi për kredi dhe rrezik më të lartë të varfërisë. Kushtet jo të volitshme të punës mund t'i largojnë gratë nga dëshira për të punuar, nëse kanë zgjedhje të tillë.

Mes masave të izolimit, roli tradicional shoqëror i grave si kujdestare gjithashtu ka nënkuptuar që atyre u është dashur të qëndrojnë në shtëpi për t'u kujdesur për fëmijët. Në mes të kujdesit për fëmijët dhe mbylljes së shkollave, gjë që i ka vendosur gratë në rrezik më të madh të humbjes së punës, kështu edhe të varfërisë, veçanërisht nënat e vetme gjatë izolimit¹³⁴. Fillimisht, si rezultat i izolimit dhe ndalimit të transportit publik, gratë me aftësi të ndryshme nuk mund të shkonin në punë¹³⁵. Pas relaksimit të masave, gratë që kujdesen për fëmijë me aftësi të ndryshme thanë se nuk mund të rrezikonin infektionin, gjë që mund të përkeqësonte gjendjen e tyre.¹³⁶ Humbja e punës dhe vështirësitë ekonomike kanë përkeqësuar qasjen e tyre në ilaçe të kushtueshme, nga të cilat varen.

Niveli i lartë i pasivitetit dhe papunësisë së grave, për shkak të përgjegjësive të papaguara të kujdesit, do të thotë që ato kanë tendencë të kenë shuma më të ulëta pensioni më vonë gjatë jetës. Në Kosovë, meqë më pak gra kanë paguar në sistemin e pensioneve përmes punësimit zyrtar, më shumë gra priren të marrin pension bazë, ndërsa më shumë burra marrin pensione më të larta “kontribuese”¹³⁷. Duke marrë parasysh që gratë gjithashtu kanë tendencë të kenë më pak qasje në burime, të tilla si ato që rrjedhin nga prona dhe trashëgimia, pensionet e ulta gjithashtu mund të kontribuojnë në feminizimin e varfërisë tek gratë e moshuara më vonë gjatë jetës.

134 Intervistat e RrGK-së.

135 Intervistat e RrGK me OSHC-të, zyrtarët e financave të komunave dhe ministrive, dhe ZBGj-të.

136 Intervistat e RrGK me një organizatë që përfaqëson interesat e njerëzve me nevoja të veçanta.

137 Riinvest, Fuqizimi i Grave. Faktorët që ndikojnë në vendimet ekonomike të grave në Kosovë, f. 28, 2018; dhe RrGK, Buxhetimi për Mirëqenie Sociale: Një Analizë Gjinore + për të Informuar Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë për 2016-2018, 2015.

Masat ekonomike

Në mënyrë që të ndihmohen bizneset dhe qytetarët e prekur financiarisht nga pandemia COVID-19, më 30 mars 2020 Qeveria e Kosovës miratoi Pakon Fiskale Emergjente, e cila përfshinte 15 masa për të injektuar ekonominë me 179 milion euro¹³⁸. Pastaj, më 4 prill, Ministria e Financave dhe Transfereve miratoi Planin Operacional për Pakon Fiskale Emergjente, i cili përmbante procedurat dhe kriteret për këto masa.¹³⁹ Pakoja Fiskale Emergjente kishte disa qëllime: të sigurojë ndihmë financiare shtesë për anëtarët më të varfër të shoqërisë gjatë pandemisë; të ndihmojë bizneset në mbulimin e shpenzimeve operative në mënyrë që ato të mund të sigurojnë një pagë minimale për të gjithë punëtorët gjatë emergjencës; të sigurojë që bizneset të kenë mundësinë të vazhdojnë të veprojnë gjatë dhe pas COVID-19; të sigurojë likuiditet shtesë për bizneset për të stimuluar rritjen e aktiviteteve ekonomike; të mbrojë punonjësit në sektorë thelbësorë të cilët janë më të ekspozuar ndaj rrezikut të infektimit dhe të stimulojë punësimin dhe formalizimin e sektorit privat.¹⁴⁰

Në përgjithësi, vendimi për Pakon Fiskale Emergjente dhe Plani Operacional nuk përmbajnë perspektivë gjinore. As nuk përmendin gratë, burrat dhe as barazinë gjinore. Në përgjithësi, pra, këto dokumente janë gjinia nuk është marrë në konsideratë, megjithëse secila masë diskutohet më tej në këtë pjesë.

Masat emergjente fiskale të asistencës sociale

Tri masat lidhur me asistencën sociale në Pakon Fiskale Emergjente:

1. Masa 1 - Pagesa e dyfishtë e vlerës së skemës sociale për të gjithë përfituesit e skemave sociale për mars, prill dhe maj, masë me vlerë deri në 7,650,000 euro;
2. Masa 2 - Pagesa shtesë në vlerë prej 30 euro në muaj për të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që marrin pagesa mujore më të ulëta se 100 euro për prillin, majin dhe qershorin, me kusht që ata të jenë përfitues të vetëm një skeme; si dhe kthimi në listat e përfituesve për përfituesit të cilëve, për shkak të mos-raportimit ose mos-vlerësimit në periudhën janar - mars 2020, nuk iu rinovuan të drejtat e tyre. Kjo masë ishte me vlerë deri në 13,000,000 euro; dhe
3. Masa 15 - Pagesa e ndihmës mujore për prill, maj dhe qershor në vlerë prej 130 euro për qytetarët me kushte të rënda sociale, bazuar në Ligjin për Skemën e Ndhmës Sociale, për të mbrojtur dhe për t'u kujdesur për familjet,¹⁴¹ e regjistruara si të papunësuar, të cilat nuk janë përfituese të të ardhurave mujore nga buxheti i Kosovës. Kjo arriti shumën deri në 3,000,000 euro.

Në kohën kur u miratua Pakoja Emergjente Fiskale, nën qeverinë e udhëhequr nga Kurti, tre masat e para ishin përgjegjësi e Ministrisë së Financave dhe Transfereve, nën Divizionin e Asistencës Sociale. Sidoqoftë, me ndrrimin e qeverisë, me qeverinë e udhëhequr nga Hoti, Ministria paraprake e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) rifilloi përgjegjësitë e saj paraprake në lidhje me ndihmën so-

¹³⁸ Për një përmbledhje të masave dhe një vlerësim të vëmendjes së tyre ndaj barazisë gjinore, shih Shtojcën 7.

¹³⁹ Qeveria e Kosovës, [Plani Operacional për Pakon Fiskale Emergjente](#), 3 prill 2020.


¹⁴⁰ Po aty.

¹⁴¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, [Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë](#), neni 1.

cialë në qershor 2020. MPMS nuk kishte të dhëna të ndara sipas gjinisë në lidhje me grupet e synuara ose përfituesit e parashikuar të këtyre masave, megjithëse kjo mund të ishte vlerësuar bazuar në programet para-ekzistuese dhe sistemet e menaxhimit të të dhënave.¹⁴²

Një rishikim i trendeve para-ekzistuese të përfituesit e ndihmës sociale do të sugjeronte se burrat do të ishin më të prirur të përfitonin nga këto masa sesa gratë.¹⁴³ Në përgjithësi, ndihma sociale sigurohet përmes familjeve, në vend të individëve. Masa I 5 e Pakos Fiskale Emergjente thoshte se “Një përfaqësues i familjes deklarohet si përfitues i skemës”. Janë përdorur kriteret para-ekzistuese për t’u kualifikuar për këto përfitime, dhe përfituesit përfshinin persona që i përmbushin ato kriteret. Siç ka vërejtur RrGK më parë, në Kosovë burrat prirën të “përfaqësojnë” familjen në skemat e ndihmës sociale.¹⁴⁴ Megjithatë, edhe pse burrat kanë tendencë ta marrin këtë ndihmë sociale në emër të familjeve të tyre, më shumë gra varen nga këto fonde.¹⁴⁵ Ekzistojnë informacione të pamjaftueshme në lidhje me mënyrën e shpërndarjes së ndihmës sociale në familje dhe nëse të gjithë antarët e familjes përfitojnë në mënyrë të barabartë.¹⁴⁶ Qeverisë i mungon informacioni nëse gratë dhe vajzat kanë qasje të barabartë në këto fonde shtetërore. Duke pasur parasysh rolet ekzistuese gjinore dhe marrëdhëniet e pushtetit brenda familjeve të Kosovës, përfshirë tendencat që burrat të marrin vendime në lidhje me burimet familjare,¹⁴⁷ nuk mund të supozohet se gratë dhe burrat domosdoshmërisht përfitojnë në mënyrë të barabartë nga ndihma sociale shtetërore.

Grafiku 18. Përfituesit e Masave të MPMS-së



Për t’u kualifikuar për përfitime nga Masa I 5, qytetarët duhet të regjistroheshin si të papunë në Agjencinë e Punësimit dhe Qendrat e Punësimit në komunat e tyre. Megjithëse nuk ishte një synim i shprehur qartë i masës, kjo thuhet se nxiti më shumë gra të regjistrohen si të papuna në mënyrë që të mund të kenë këtë qasje në këtë përfitim.¹⁴⁸ Si gratë ashtu edhe burrat punëkërkues të regjistruar u

¹⁴² Për shembull, disa nga këto të dhëna janë përpiluar më parë në një bashkëpunim midis MPMS dhe RrGK, duke rezultuar në *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, 2015.

¹⁴³ Po, aty.

¹⁴⁴ RrGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, 2015, f. 27, 30.

¹⁴⁵ Po aty, f. 4, 30.

¹⁴⁶ Po aty.

¹⁴⁷ Shih RrGK, *Mjaft më me arsytimit*, f. 29-30.

¹⁴⁸ Intervistë me MPMS, 18 shtator 2020.

rritën ndjeshëm në prill dhe maj, megjithëse, siç u përmend, është e vështirë të vlerësohet nëse ishin të papunë më parë apo kishin humbur punën e tyre si rezultat i COVID-19.¹⁴⁹ Gratë nuk ishin të synuara në mënyrë të qartë nga kjo masë dhe asnjë veprim mbështetës nuk ekzistonte ndaj barazisë gjinore si pjesë e kësaj mase. Ekziston mundësia që gratë dhe burrat të jenë përballur me sfida të ndryshme gjatë regjistrimit si të papunë, ndërsa nevojitet analizë më e thellë në të ardhmen për t'iu qasur këtyre problemeve.

Kështu, në dizajnimin e masave e lartpërmendura aspekti gjinor nuk është marrë në konsideratë, pasi ato nuk i konsideruan ose nuk iu referuan në mënyrë të qartë nevojave të ndryshme të grave dhe burrave në qasjen e asistencës sociale.¹⁵⁰ Duke pasur parasysh trendet e mëparshme që tregojnë se burrat kanë më shumë të ngjarë të përfitojnë nga ndihma sociale sesa gratë, pa marrë parasysh këto pabarazi në mënyrë të qartë në këtë masë, kjo masë madje mund të forcojë pabarazitë gjinore para-ekzistuese të fshehura brenda familjeve, dhe kështu të jetë gjinore negative. Sidoqoftë, siç është vërejtur më parë nga RrGK,¹⁵¹ nevojiten hulumtime të mëtejshme në lidhje me mënyrën se si ndihma sociale është shpërndarë në familje në këtë fushë për të përcaktuar ndikimet aktuale.

Sa i përket përfituesve aktualë, siç u përmend, MPMS u përballë me disa çështje në procesin e verifikimit të kualifikimit të aplikantëve për të përfituar nga masat e saj, të cilat kontribuuan në disa vonesa në sigurimin e përfitimeve për përfituesit. Fillimisht, në tetor, MPMS-ja ofroi një raport që përmbledh përfituesit e përgjithshëm të tri masave, por ai nuk përmbante të dhëna të ndara sipas gjinisë.

Në dhjetor, sa i përket Masës 1, MPMS-ja ofroi informata të azhurnuara në lidhje me përfituesit e pagesave të dyfishta sipas Skemës së Ndihmës Sociale (Grafiku 18). Në mars, kjo përfshiu 8,153 gra (34%) dhe 16,045 burra (66%). Në prill, 8,324 gra (34%) dhe 16,373 burra (66%) morën këtë ndihmë, ndërsa në maj 8,386 gra (33%) dhe 17,194 burra (67%) përfituan nga kjo skemë. Në total, këto përfitime arritën në 15,610,978 €.

Në lidhje me Masën 15, 28,728 familje kishin përfituar deri nga fundi i nëntorit, nga të cilat 40,568 aplikues si përfaqësues të familjeve të tyre ishin gra (47%), dhe 44,883 ishin burra (53%). Asnjë e dhënë nuk ishte e qasshme për numrin e grave dhe burrave përfitues brenda këtyre familjeve. Sipas MPMS-së, megjithëse Pakoja Fiskale Emergjente fillestare planifikonte buxhet prej 3 milion €, afërsisht 10.6 milion € ishin shpërndarë deri nga fundi i nëntorit; 4,000 familje të tjera shtesë pritëshin të kualifikoheshin si pjesë e procesit zyrtar të ankesave dhe të përfitonin, duke arritur 11.5 milion € në shpenzimet totale në 2020.

Në lidhje me Masën 2, MPMS më vonë do të ketë të dhëna të ndara sipas gjinisë në lidhje me përfituesit e skemave pensionale, pasi Ministria të përpilojë raporte për zbatimin e secilës masë.

Masat fiskale emergjente të garantimit të kredisë

Ministria e Financave dhe MTI, që themeluan Fondin e Garancisë së Kredisë së Kosovës, ishin përgjegjëse për zbatimin e Masës 10 të Pakos Fiskale Emergjente. Kjo përfshinte mbështetjen për të siguruar likuiditetin financiar për ndërmarjet e vogla dhe sektorin e vetë-punësuar, pasi Qeveria e Kosovës (30%) dhe Fondi i Garancisë së Kredisë së Kosovës (50%) do të garantonin 80% të shumës së kredituar të kërkuar në bankat tregtare.

Në shprehjen e saj, masa nuk merr në konsideratë aspektin gjinor sepse nuk merr parasysh nev-

¹⁴⁹ ASK, Buletini Tremujor, Tetor 2020 (f. 31 dhe 32). Shikoni diskutimin e mëtejshëm në [kapitullin](#) e parë.

¹⁵⁰ Intervistat e RrGK-së e konfirmuan këtë.

¹⁵¹ RrGK, *Buxheti për mirëqenie sociale* f. 29, 2015.

ojat e ndryshme të grave dhe burrave ose pabarazitë ekzistuese gjinore në qasjen e kapitalit pabarazitë ekzistuese gjinore. Për shembull, gratë përpiqen të sigurojnë kredi bankare për zhvillimin e biznesit të tyre. Duke pasur parasysh mungesën e pronësisë së grave për kolateral dhe norma të tjera shoqërore që pengojnë angazhimin e grave në biznes, gratë mund të mos kenë fare qasje në këto kredi ose të përfitojnë nga këto fonde qeveritare. Gratë tradicionalisht përballen me sfida të shtuara në qasjen në kredi bankare sepse ato zotërojnë më pak kapital, dhe përballen me diskriminim të bazuar në gjini në qasjen në kapital. Kjo masë do të mund të ndihmonte gratë që zotërojnë biznese duke përfshirë qartë analizën gjinore dhe masat afirmative. Masa mund të kishte ndjekur më mirë avancimin e barazisë gjinore, nëse masat afirmative do të parashikonin garanci deri në 100% të shumës së kredituar për bizneset në pronësi të grave, veçanërisht duke marrë parasysh që gratë statistikisht kanë më shumë gjasa sesa burrat të paguajnë huat. Një masë e tillë afirmative mund të kompensojë diskriminimin e bazuar në gjini, me të cilin përballen gratë me qasjen në kredi.

Masat Fiskale Emergjente për mbështetjen e Sektorit Privat dhe Publik

MEA ishte ishte përgjegjëse për pesë masat e mëposhtme:

- Masa 3 - Mbështetja financiare për kompanitë që janë në vështirësi financiare si rezultat i aktiviteteve të zvogëluara për shkak të situatës emergjente të shëndetit publik, si më poshtë:
 - (a) Mbulimi i shpenzimeve të pagave mujore të të punësuarve në vlerë prej 170 euro për punonjësit për prill dhe maj, në shumën deri në 41,000,000 euro;
 - (b) Qira të subvencionuara deri në 50% të vlerës së qirasë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, për prillin dhe majin, në shumën deri në 12,000,000 euro;
- Masa 4 - Ndërmarrjet publike me vështirësi financiare për shkak të situatës emergjente të shëndetit publik mund të huazojnë fonde nga bankat e Kosovës, pa interes, për të siguruar likuiditetin e tyre të përkohshëm, me një kthim deri më 31 dhjetor 2020, në shumën deri në 20,000,000 euro.
- Masa 7 - Pagesa shtesë në vlerë prej 100 euro për punonjësit e dyqaneve ushqimore, furrave dhe farmacive në prill dhe maj, në shumën deri në 3,000,000 euro.
- Masa 8 - Pagesa e ndihmës mujore në vlerë prej 130 euro për qytetarët që kanë humbur vendet e tyre të punës për shkak të emergjencës së shëndetit publik për prillin, majin dhe qershorin, në shumën deri në 4,000,000 euro.
- Masa 14 - Mbështetje financiare për ndërmarrjet tregtare që regjistrojnë punonjës me kontratë pune prej të paktën një viti gjatë periudhës së emergjencës shëndetësore publike në vlerë prej 130 euro për dy muajt e ardhshëm pas regjistrimit, në shumën deri në 6,000,000 euro.

Gjatë hartimit të këtyre masave, Ministria nuk mori parasysh mënyrat në të cilat këto masa mund të ndikojnë ndryshe te gratë dhe burrat, ose sesi masat potencialisht mund të kontribuojnë në avancimin e barazisë gjinore. Për shembull, ata nuk përmendën përdorimin e masave afirmative për kompanitë në pronësi të grave ose përfitimet shtesë për kompanitë tregtare që regjistrojnë më shumë gra të punësuar. Masa nuk merr në konsideratë në mënyrë të qartë nevojat potencialisht të ndryshme në sektorë të ndryshëm. As se si, edhe nëse krijohen punë të qëndrueshme, në cilët sektorë do të krijoheshin punë të tilla, të cilat, nga një perspektivë gjinore, janë shumë të rëndësishme duke pasur

parasysh ndryshimet në punë midis grave dhe burrave.

Ministria nuk përfshinte gjininë e aplikantëve në formularët e aplikimit, dhe kështu nuk u mblodhën të dhënat e ndara sipas gjinisë për përfituesit. Ministria gjithashtu nuk i konsideroi nivelet e ndryshme të qasjes në informacion në lidhje me masa të tilla që gratë dhe burrat mund të kenë, duke penguar potencialisht qasjen e tyre në këto përfitime. Përkundrazi, zyrtarët e Ministrisë iu referuan Ligjit për Prokurimin Publik, duke deklaruar se ata duhet ta ndjekin me përpikëri atë dhe se nuk i lejon ata të zbatojnë kritere afirmative drejt barazisë gjinore. Për më tepër, zyrtarët thanë se misioni dhe objektivat e Ministrisë nuk kanë asnjë lidhje me perspektivën gjinore ose ekonominë shtëpiake. Siç është përmendur në kapitullin e mëparshëm, komentet e bëra nga Ministria sugjerojnë mungesë të njohurive për Ligjin për Barazi Gjinore dhe kërkesat e tij, si dhe faktin që Ligji mbi Prokurimin Publik lejon masa afirmative. Si rezultat, këto masa ishin aspekti gjinor nuk është marrë në konsideratë në dizajnimin e këtyre masave. Duke pasur parasysh që gratë janë të nënpërfaqësuara në mesin e pronarëve të bizneseve, pa e adresuar këtë në mënyrë të qartë, masa mund të përforcojë pabarazitë gjinore të mëparshme dhe madje të jetë negative gjinore.

Sa i përket Masës 7, është vështirë të vlerësohet ndikimi tek gratë dhe burrat sepse MEA kishte lista të gjata që përmbajnë emrat e të gjithë përfituesve, por këto nuk ishin të ndara sipas gjinisë; ata thanë që ta bësh këtë do të duhej shumë kohë dhe përpjekje. Kjo sugjeron mangësi në sistemin e tyre të menaxhimit të të dhënave, i cili duhet të ketë opsionin për të përfshirë gjininë e përfituesit. Ekzistojnë raporte cilësore se nën Masën 7 që punëdhënësit të paguajnë përfitime të shtuara për punëtorët, disa punëtorë si burra dhe gra nuk kanë marrë ndihmën e shtetit nga punëdhënësit e tyre. Sidoqoftë, ata nuk kanë dashur ta raportojnë këtë nga frika e humbjes së punës. Punëtorët e paregjistruar në ekonominë joformale nuk mundën të përfitojnë nga pakot fiskale emergjente të qeverisë për bizneset, pasi subvencionet zbatohen vetëm për personat juridikë, përkatësisht punëtorët e regjistruar ligjërisht. Kjo mund të përfshijë dimensione të ndryshme të lidhura me gjininë, të cilat mund të pengojnë qasjen në këtë përfitim.

Lidhur me përfituesit, sipas komunave, që nga qershori, në mesin e 14,934 punëtorëve që përfituan nga Masa 14, 4,340 nga aplikantët ishin gra (29%), dhe 10,594 ishin burra (71%).

Masat fiskale emergjente për bujqësi

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) ishte përgjegjëse për Masën 11 për subvencione dhe grante për bujqësinë. Kjo masë thotë se MBPZHR do të identifikojë për mbështetje “nën-sektorët më emergjentë të prodhimit bujqësor [të prekur nga] kriza e pandemisë”. Edhe pse nën-sektorët të ndryshëm mund të ndikojnë në mënyrë të ndryshme në gratë dhe burrat fermerë, as pasi prirën të jenë të shpërndarë nëpër nënsektorët të ndryshëm të prodhimit bujqësor, masa nuk e analizoi këtë. As informacioni nuk ishte i disponueshëm në faqen e internetit të MBPZHR-së në lidhje me atë se cilët nën-sektorë u zgjodhën. Kjo masë në mënyrë të ngjashme dështon të marrë në konsideratë pozicionin veçanërisht të prekshëm të grave në sektorin e bujqësisë, duke përbërë vetëm 5% të fermerëve të licencuar, si dhe të nën-përfaqësuar deri më tani midis përfituesve (2%) të subvencioneve bujqësore. Masa nuk parashikonte ndonjë masë afirmative drejt barazisë gjinore. Prandaj, aspekti gjinor nuk u mor parasysh, që mund madje të kontribuojë edhe me pasoja negative gjinore duke i përforcuar pabarazitë ekzistuese.

Masat fiskale emergjente për Kulturën dhe Sportin

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) ishte përgjegjëse për Masën 12, e cila thotë se buxheti do të rritet për grante dhe subvencione në këtë sektor për të ringjallur aktivitetet kulturore dhe sportive të prekura nga pandemia. MKRS duhet të identifikojë dhe mbështesë “aktivitetet më të rëndësishme sportive dhe kulturore të prekura nga kriza pandemike.” Kjo masë nuk mori në konsideratë nën përfaqësimin e grave në këta sektorë. Për shembull, gratë përbëjnë vetëm 25% të të gjithë anëtarëve të klubeve sportive, dhe kështu do të përfitojnë më pak nga kjo masë sesa burrat. Në përgjithësi, masa nuk mori parasysh aspektin gjinor dhe madje mund të jetë negative gjinore, duke thelluar kështu pabarazitë para-ekzistuese.

Një qasje ndër-sektoriale ndaj masave fiskale emergjente?

Të paktën në formulimin e tyre të shkruar, asnjë nga masat në Pakon e parë Fiskale Emergjente nuk përmbanin analizë ndër-sektoriale gjinore ose qasje ndër-sektoriale që konsideronte dobësitë e shumta me të cilat gratë dhe burrat mund të përballen bazuar në gjininë që shoqërohet me moshën, aftësinë, orientimin seksual dhe vendndodhjen gjeografike, në mesin e faktorëve të tjerë. Masa 9 përfshin mbështetjen për iniciativat e organizatave për përmirësimin e situatës së romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve. Megjithatë, ajo nuk specifikon se si do të mbështesë gra dhe burra të ndryshëm. As nuk flet për dobësitë e veçanta të ndërlidhura ose diskriminimin me të cilin, për shembull, gratë romë mund të përballen në krahasim me burrat romë. Asnjë nga masat nuk adreson në mënyrë të qartë nevojat e njerëzve me aftësi të ndryshme, përfshirë gratë me aftësi të ndryshme që mund të përballen me dobësi të shtuara. Personat me aftësi të kufizuara dhe familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara përfituan gjithsej 90 euro vetëm nga Masa 2 e Pakos Fiskale Emergjente pasi ata marrin një pagesë mujore prej më pak se 100 euro. Kjo masë siguroi një pagesë shtesë në vlerë prej tridhjetë (30 €) euro në muaj për të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që marrin pagesa mujore më të ulëta se njëqind (100 €) euro për prillin, majin dhe qershorin, me kusht që ata të jenë përfituesit e vetëm një skeme.

Masat e rimëkëmbjes ekonomike, përfshirë ato që lidhen me kredi

Më 13 gusht, Qeveria e re e Kosovës miratoi Planin e saj për Zbatimin e Rimëkëmbjes Ekonomike, në vlerë prej 365,000,000 euro. Fondet e planifikuara do të alokohen ekskluzivisht për zbatimin e masave të përcaktuara në Programin e planit të Rimëkëmbjes Ekonomike. Qeveria ka mundur të fillojë zbatimin e disa masave pas miratimit të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike. Sidoqoftë, masa të tjera nuk mund të zbatoheshin derisa Kuvendi të miratonte Ligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike - COVID-19 sepse zbatimi i disa prej këtyre masave i nënshtrohet ndryshimit të tetë ligjeve të Kosovës. Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID-19 u miratua më 7 dhjetor 2020. Analiza këtu përqendrohet në Planin për Zbatimin e Rimëkëmbjes Ekonomike dhe nuk e analizon Ligjin, përveç nëse është shënuar qartë; megjithëse Ligji përfshiu disa ndryshime, ai u miratua disa ditë para përfundimit të këtij raporti.

Përveç masave në nën-seksionet që pasojnë, Plani për Zbatimin e Rimëkëmbjes Ekonomike përfshin masat, nën-masat dhe shumatat e mëposhtme në lidhje me huatë:

- I. Masa I - Lehtësimi i qasjes në hua për ndërmarrjet private, për të financuar projekte investimi dhe vazhdimësi biznesi, në vlerë prej 100,000,000 euro, me aktivitetet e mëposhtme:
 - Masa IA - Rritja e mbulimit të kredive të reja përmes Fondit të Garantimit të Kredisë së Kosovës, në vlerë prej 60,000,000 euro;
 - Masa IB - Mbulimi i kostos së tarifës së Fondit të Garancisë së Kredisë së Kosovës, në vlerë prej 5,000,000 euro;
 - Masa IC - Ristrukturimi i huave bankare ekzistuese, ku kostoja e ri-planifikimit përballohet nga qeveria, në vlerë prej 30,000,000 euro; dhe
 - Masa ID - Subvencionimi i normave të interesit për sektorë të caktuar bazuar në një plan strategjik të përgatitur nga palët e interesuara përkatëse, në vlerë prej 5,000,000 euro.

Kjo masë synon të lehtësojë qasjen në financa për sektorin privat. Masa përfshin nën-masa të reja që nuk përfshihen në Pakon Fiskale Emergjente të mëparshme. Sidoqoftë, duke pasur parasysh mungesën e lartpërmendur të grave në qasje në kapital, kolateral dhe hua, gratë ka të ngjarë të mos kenë qasje të barabartë në këtë masë. Kjo masë nuk merr në konsideratë aspektin, dhe mund të jetë madje edhe negative gjinore duke pasur parasysh pabarazitë para-ekzistuese.

Masat e rimëkëmbjes ekonomike që lidhen me tatimet

Masa tjetër synon të zvogëlojë barrën tatimore të bizneseve gjatë pandemisë:

- I. Masa 2 - Lehtësimi i barrës tatimore për bizneset, për të përmirësuar likuiditetin e tyre afatshkurtër, në vlerë prej 15,000,000 euro, përfshirë nën-masat:
 - Masa 2A - Shtyrja e pagesës së tatimeve bazuar në nevojat e biznesit;
 - Masa 2B - Mbulimi i 5% të kontributit të pensionit që biznesi u paguan punonjësve, në vlerë prej 5,000,000 euro;
 - Masa 2C - Sigurimi i lehtësirave tatimore për firmat për sektorë të caktuar bazuar në një plan strategjik të përgatitur nga palët e interesuara përkatëse;
 - Masa 2D - Sigurimi i përjashtimeve për parapagimet e detyrimeve tatimore nga bizneset;
 - Masa 2E - Lirimi i bizneseve nga ndëshkimet tatimore për vonesat në pagimin e tatimeve për shkak të pandemisë, bazuar në kritere të qarta dhe transparente;
 - Masa 2F - Sigurimi i mundësisë për të planifikuar borxhet e mëparshme tatimore, përfshirë zbritjet për ripagimin e menjëhershëm të borxhit; dhe
 - Masa 2G - Subvencionimi i 50% të shpenzimeve të qirasë për bizneset, në vlerë prej 10,000,000 euro.

Disa nga këto nën-masa janë të ngjashme me ato në Pakon Fiskale Emergjente të mëparshme; pakoja paraprake parashikonte gjithashtu një subvencion të qirasë deri në 50% të vlerës së qirasë për NVM-të për prillin dhe majin, në vlerë prej 12,000,000 euro, sesa 10,000,000 euro në Masën 2G. Me sa duket, masa e re është për të gjitha bizneset, dhe jo vetëm për NVM-të, por nuk është specifikuar në masë. Kur është për të gjitha bizneset, kjo mund të dëmtojë gratë që priren të mbipërfaqësohen midis pronarëve të mikro dhe NVM-ve, të cilat priren të kenë më pak burime dhe në këtë mënyrë sfida më

të mëdha për të konkuruar kundër bizneseve më të mëdha për përfitime të tilla.

Ulja e tatimeve për bizneset gjithashtu përfshihet në të dy pakot. E ndryshme në Programin për Rimëkëmbjen Ekonomike, Masa 2B parashikon subvencione për kontributet pensionale të paguara nga bizneset, ndërsa pakoja e mëparshme parashihte pagesën e kontributeve pensionale si për punëdhënësin ashtu edhe për punonjësin. Padyshim, nga perspektiva gjinore, mbështetja e drejtpërdrejtë për punonjësit mund të ketë rezultate më të mira nga e cila përfitojnë individë. Duke transferuar subvencione direkt te punonjësit, ndarja themelore e pushtetit në vendin e punës adresohet më mirë. Mundësia e keqmenaxhimit të këtyre transferimeve shmanget nëse ato shkojnë drejtpërdrejt në emër të punonjësit për lehtësimin e vështirësive.

Ligji përfundimtar i miratuar për Rimëkëmbjen Ekonomike, ndryshe nga Projektligji, përfshinte klauzola shtesë të reja për të mbështetur sektorin privat. Ligji përjashton nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) të gjithë lëndën e parë të prodhuar nga bizneset e regjistruara dhe aktive në Kosovë, pavarësisht nga ajo nëse materialet eksportohen jashtë ose jo. Po ashtu, neni 9 i këtij ligji ka ndryshuar Ligjin e Administrimit të Taksave dhe Procedurave; tani ofron një klauzolë të re që thotë se taksapaguesit me obligime të taksave të papaguara që nga 1 janari janë të liruar nga interesi nëse paguajnë të gjitha obligimet bazë të taksave deri me 31 dhjetor 2020, bazuar në një marrëveshje me Administratën Tatimore të Kosovës për pagesën e obligimeve.

Asnjë nga këto masa nuk marrin në konsideratë aspektin gjinor në formulimin e tyre me shkrim. Analiza gjinore do të sugjeronte që burrat do të kishin më shumë gjasa të përfitonin nga këto masa sesa gratë, pasi burrat kanë më shumë biznese. Kështu, relativisht, më shumë shpenzime shtetërore ka të ngjarë të shkojnë për bizneset e drejtuara nga burrat, përveç nëse zbatimi i këtyre masave përfshin më vonë masa afirmative për të mbështetur bizneset e drejtuara nga gratë. Nëse masat nuk adresojnë qartë këto pabarazi, kjo mund të forcojë ndryshimet ekzistuese gjinore dhe pabarazitë midis grave dhe burrave në biznes, gjë që do t'i bënte masat negative gjinore.

Masa 2C, në veçanti, mund të ketë implikime gjinore, varësisht nga ajo se cilat kompani kishin ulje tatimore dhe nga sektorët e prekur, duke pasur parasysh ndryshimet gjinore në sektorët në të cilët gratë dhe burrat priren të punojnë. Duhet vërejtur se gjuha e përdorur në masë, duke iu referuar “barrës tatimore”, nuk është neutrale, por më tepër ideologjike; sugjeron që tatimet janë vetëm barrë. Kjo gjuhë heshtë dhe madje minon qëllimin e synuar të tatimeve si një burim i rëndësishëm i të ardhurave të shtetit. Tatimet i mundësojnë qeverisë të sigurojë shumë shërbime thelbësore për qytetarët. Fakti që shumica e nën-masave vonojnë pagesat e taksave, përveç 2C dhe nuk heqin taksat, është pozitiv në kontekstin më të gjerë të sigurimit të të ardhurave në të ardhmen për të mbështetur shërbimet shtetërore.

Në përgjithësi, siç u përmend, nga ulja e tatimeve për bizneset do të përfitojnë më shumë burrat sesa gratë, pasi burrat priren të jenë pronarë të bizneseve. Duke pasur parasysh aspektet gjinore të sistemeve të tatimeve, në mënyrë që të përfitojnë gratë përmes uljes së tatimeve, qeveria do të duhet të marrë në konsideratë zbritjet ose përjashtimet nga tatimet indirekte si TVSH. Rolet dhe marrëdhëniet e konstruktura gjinore, dinamika e fuqisë, si dhe fuqia e barrës brenda familjes, ndikojnë në llojin e shpenzimeve që bëjnë gratë në krahasim me burrat. Siç ka zbuluar, “gratë, krahasuar me burrat, priren të shpenzojnë një pjesë më të lartë të të ardhurave nën kontrollin e tyre për mallra të tilla si ushqimi, arsimit dhe kujdesi shëndetësor që rrisin mirëqenien dhe aftësitë e fëmijëve.”

Pra, uljet e tatimeve për qytetarët me të ardhura të ulta, siç janë ato që lidhen me TVSH-në, e jo të bizneseve (në veçanti bizneset e mëdha), do të ndihmonin më shumë njerëz drejtpërdrejt dhe do të kontribuonin në barazin, veçanërisht barazinë gjinore. Në planin afatgjatë, përjasht-

timet nga tatimet për bizneset e mëdha mund të kenë efekte negative gjinore, duke ulur kështu të ardhurat e shtetit për programe sociale; pra, nga perspektiva e barazisë dhe barazisë gjinore, përjashtimet afatgjata tatimore për bizneset, veçanërisht bizneset e mëdha, duhet të shmangen.

Masat e rimëkëmbjes ekonomike për të mbështetur punësimin përmes bizneseve

Masa tjetër kërkon të mbështesë punësimin, duke mbështetur bizneset për të rritur punësimin:

- I. Masa 3 - Rritja e punësimit, në veçanti punësimi i grupeve specifike të punëtorëve me probabilitet më të ulët të punësimit, në vlerë prej 67,300,000 euro; dhe nën-masat:
 - Masa 3A - Subvencionimi i pagës për punonjësit në bizneset e prekura nga pandemia për mars dhe prill (170 euro), në vlerë prej 47,300,000 euro;
 - Masa 3B - Subvencionimi i pagës për punonjësit e rinj të punësuar nga bizneset bazuar në një plan që identifikon sektorët dhe kategoritë e punonjësve më në nevojë, në vlerë prej 5,000,000 euro;
 - Masa 3C - Sigurimi i mbështetjes profesionale për bizneset për të vepruar në kohë pandemie, të tilla si puna nga shtëpia, puna në internet, transformimi digjital, etj., në shumën 3,000,000 euro;
 - Masa 3D - Përkrahja e bizneseve prodhuese dhe të shërbimeve me pajisje dhe makineri për automatizimin e procesit, në vlerë prej 10,000,000 euro; dhe
 - Masa 3E - Mbështetja e bizneseve për të rritur produktivitetin e tyre, në vlerë prej 2,000,000 euro.
 - Masat 3, 3B, 3C, 3D dhe 3E janë masa të reja. Ndërkohë, masa 3A është e ngjashme me masën 3a në pakon paraprake në vlerë prej 41,000,000 euro.

Përsëri, pasi burrat kanë në mënyrë të konsiderueshme më shumë biznese në pronësi dhe shkallën më të lartë të punësimit sesa gratë, burrat ka të ngjarë të përfitojnë më shumë nga këto masa. Në formulimin e tyre me shkrim, masat nuk adresojnë në mënyrë të qartë nën-përfaqësimin e dukshëm të grave në tregun e punës ose ndikimin e masave të izolimit në aftësinë e grave për të punuar, duke pasur parasysh rritjen e ngarkesës së tyre të punës së papaguar të kujdesit. Kjo mund të kontribuojë në një probabilitet më të ulët të grave që të kthehen në punë ose të kërkojnë punë, gjë që nuk do të adresohet përmes kësaj mase. Përzgjedhja e sektorëve, e përmendur në masën 3B, gjithashtu mund të ketë implikime të ndryshme për gratë dhe burrat, duke pasur parasysh ndarjen profesionale. Pra, masa nuk e merr në konsideratë aspektin gjinor, dhe madje mund të jetë edhe negative gjinore, duke forcuar kështu pabarazitë ekzistuese gjinore në punësim.

Pas aprovimit të Planit të Rimëkëmbjes Ekonomike, MEA ekzekutoi pagesën e saj të parë në tetor, në vlerë prej 37,710,730 euro për 15,745 biznese që plotësuan kriteret.

Që nga 7 dhjetori, kur hyri në fuqi Ligji i ri për Zhvillimin Ekonomik, masat e reja do të mbështesin bizneset e sektorit privat të regjistruar para 29 shkurt 2020 për të mbuluar veprimtaritë e tyre në vlerë prej 200 milion € dhe për të paguar 300 € paga mujore për periudhën tetor - dhjetor 2020 për punonjësit e shkarkuar ose pezulluar për të paktën tre muaj, midis 29 shkurtit dhe 30 dhjetorit 2020 si rezultat i pandemisë COVID-19.

Masat e rimëkëmbjes ekonomike që lidhen me bujqësinë

Masa tjetër parashikon mbështetjen për sektorin e bujqësisë:

- I. Masa 4 - Rritja e prodhimit të brendshëm bujqësor për të rritur punësimin në zonat rurale, për të zvogëluar importet e odukteve bujqësore, për të kapërcyer sfidat për shkak të mungesës së shitjeve të shkaktuara nga COVID-19 dhe për të rritur sigurinë ushqimore, në vlerë prej 26,000,000 euro; dhe nën-masat:
 - Masa 4A - Dyfishimi i buxhetit për Programin e Pagesave Direkte për vitin 2020, në vlerë prej 24,000,000 euro; dhe
 - Masa 4B - Subvencionimi i normave të interesit për kreditë bujqësore, në vlerë prej 2,000,000 euro.

Këto janë masa të reja, megjithëse pakoja paraprake përmbante ndihmë për prodhimin bujqësor përmes granteve dhe subvencioneve, në shumën 5,000,000 euro. Masa e re nuk merr parasysh gjininë sepse është krijuar për të gjithë përfituesit që plotësojnë kriteret e kërkuara. Kriteret në lidhje me Programin e Pagesave Direkte nuk përmendin qartë gratë ose nuk kanë të vendosur ndonjë masë afirmative drejt barazisë gjinore. Sektorët e zgjedhur për subvencione përmes Programit të Pagesave Direkte mund të kenë implikime gjinore pasi gratë dhe burrat nuk janë të përfaqësuar në mënyrë të barabartë në të gjithë sektorët e bujqësisë. Siç u përmend, shumë më shumë biznese bujqësore janë në pronësi të burrave sesa nga gratë, dhe burrat kanë më shumë pronë sesa gratë, që do të thotë se burrat kanë qasje më të mirë në hua bujqësore. Brenda kriterëve të kualifikueshmërisë për marrjen e subvencioneve të huasë se cilat biznese kualifikohen dhe nëse kreditë e vogla apo më të mëdha do të marrin subvencione gjithashtu mund të kenë pasoja implikime, duke pasur parasysh që më pak gra kanë biznese më të mëdha bujqësore me kredi të konsiderueshme. Nga perspektiva gjinore, analiza gjinore për të informuar këtë masë gjithashtu mund të ketë konsideruar pozitat e ndryshme të grave dhe burrave në lidhje me bujqësinë informale dhe të vogël, përfshirë prodhimin për tregjet lokale. Masa nuk merr parasysh gjininë, ose këto çështje kontekstuale, dhe për këtë arsye mund të forcojë madje edhe pabarazitë gjinore para-ekzistuese (negative gjinore).

Masat e Rimëkëmbjes Ekonomike për të Stimuluar Kërkesën

Siç ceket në Projektligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID-19, masa në vijim synon të stimulojë kërkesën:

- I. Masa 5 - Stimulimi i kërkesës totale, e cila stimulon prodhimin dhe punësimin me efekte shumëzuese në ekonomi, në vlerë prej 15,000,000 euro; dhe nën-masat:
 - Masa 5A - Lejimi i tërheqjes së shumës prej 10% të fondeve të kursyera në Trustin Pensional për kontribuuesit, bazuar në nevojat e tyre, një mundësi e cila mund të përdoret për një periudhë prej katër muajsh; dhe
 - Masa 5B - Mbështetja e zgjatjes së periudhës së mospagimit për blerjen e banesave dhe shtëpive bazuar në kriteret e të ardhurave, në vlerë prej 15,000,000 euro.

Këto janë masa të reja që nuk përfshihen në pakon paraprake fiskale emergjente. Masa 5B nuk

e konsideron gjininë, pasi nuk i kushton vëmendje qasjes së pabarabartë të grave në pronë ose kapital për blerjen e pronës. Në këtë kuptim, mund të jetë edhe negative gjinore duke forcuar kështu këto pabarazi ekzistuese gjinore, përveç nëse përmban dispozita të qarta për regjistrimin e përbashkët të pasurisë, në përputhje me udhëzimin aktual administrativ.

Në lidhje me Masën 5A, pak më ndryshe nga Projektligji për Rimëkëmbjen Ekonomike - COVID-19, Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike i miratuar së fundi, thotë se çdokush që ka kontribute të ruajtura, mund t'i tërheq kursimet deri në 9,999 euro do të kompensohen në rimbursim nga qeveria për tërheqjen e 10%-shit. Aplikacionet për të përdorur këto kursime duhet t'i takojnë periudhës të 6 prillit 2020. Rimbursimi do të nis nga fillimi i vitit 2023. Edhe pse Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike është valid deri më 31 dhjetor 2021, kjo klauzolë do të mbetet në fuqi deri më 31 dhjetor 2028.

Masa 5A do të vlente vetëm për personat që kanë punuar dhe kanë kontribuar në pensionet e tyre. Kështu, kjo masë nuk merr parasysh situatat e ndryshme të grave dhe burrave. Në vitin 2018, rreth 83% e përfituesve të pensionit kontribues ishin burra dhe burrat do të merrnin 72% të shumës totale të pensioneve kontribuese. Në vitin 2019, 34.5% e kontribuuesve aktivë në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës ishin gra dhe 65.6% ishin burra. Gratë kanë bërë një pagesë mesatare mujore prej 40.59 euro dhe burrat kanë paguar 46.47 euro në muaj, duke reflektuar ndryshimet e përgjithshme në pagë midis grave dhe burrave në Kosovë. Duke marrë parasysh normat tradicionale gjinore, historikisht më pak gra kanë punuar, dhe për këtë arsye më pak gra kanë paguar në programin e pensioneve. Në vitin 2020, që nga nëntori, 192,131 pensionistë morën pensione, përfshirë 142,587 përfitues të pensionit bazë (65% gra, 35% burra) dhe 49,544 përfitues pensionin kontribues (84% burra, 16% gra). Pra, gratë më pak sesa burrat do të përfitonin drejtpërdrejt nga kjo masë.

Çfarë është më shqetësuese, shpenzimi i kursimeve të pensionit mund t'i vërë njerëzit në rrezik të varfërisë më vonë gjatë jetës, pasi ata do të kenë më pak kursime pensioni për t'i mbështetur ata në pleqëri. Duke qenë se gratë zakonisht kanë më pak qasje në burime sesa burrat, kjo mund t'i vërë ato në rrezik edhe më të madh të varfërisë. Gratë mund të jenë në rrezik më të madh të varfërisë në pleqëri sesa burrat. Qeveria nuk i ka konsideruar këto ndryshime gjinore në planifikimin e kësaj mase, dhe kështu masa mund të përkeqësojë pabarazitë ekzistuese, duke e bërë këtë masë negative gjinore.

Masa e rimëkëmbjes ekonomike për të mbështetur ndërmarrjet publike

Masa tjetër synon të mbështesë ndërmarrjet publike, siç janë ato që merren me ujë dhe mbeturina:

- I. Masa 6 - Mbështetja e funksionimit dhe investimeve kapitale në ndërmarrjet në pronësi publike, veçanërisht investimet strategjike, për të përballuar të ardhurat e reduktuara dhe investimet e nevojshme kapitale, në vlerë prej 17,000,000 euro; dhe nën-masat:
 - Masa 6A - Mbulimi i kostove minimale të funksionimit të ndërmarrjeve në pronësi publike, në vlerë prej 14,000,000 euro;
 - Masa 6B - Rishikimi i planit dinamik të investimeve kapitale të ndërmarrjeve në pronësi publike dhe vlerësimi i investimeve të nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve në pronësi publike; dhe
 - Masa 6C - Mbështetja e investimeve të ndërmarrjeve në pronësi publike përmes subvencioneve nga buxheti, huadhënies nga buxheti dhe lëshimit të garancive sovrane për huat e dhëna ndërmarrjeve në pronësi publike nga institucionet financiare, në vlerë prej 3,000,000 euro.

Këto janë masa të reja. Ato nuk marrin parasysh aspektin gjinor.

Masa e Rimëkëmbjes Ekonomike për Gratë

Një masë në Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike përqipet të adresojë në mënyrë specifike nevojat e grave si masë afirmative:

1. Masa 10 – Sigurimi i mbështetjes financiare për projekte dhe iniciativa që synojnë përmirësimin e pozitës së grave në shoqëri dhe ekonomi, në vlerë prej 2,000,000 euro.

Që nga 25 nëntori, Agjencia për Barazi Gjinore, përgjegjëse për këtë masë të re, kishte alokuar 1,000,000 euro për kopshte private dhe ato të menaxhuara me partneritet publiko-privat. Fondet kërkuar të mbështesin 115 qendra ekzistuese të kujdesit ditor dhe kopshte të prekura nga pandemia, bazuar në nevojat e tyre të paraqitura në kohën e aplikimit. Aplikantët mund të aplikojnë për mbështetje në 16 fusha, përfshirë pagesën e faturave të energjisë elektrike dhe shërbimeve publike (ujë dhe mbe-turina); blerja e materialeve higjienike, ushqimore dhe didaktike; rinovimi i ndërtesave; ngrohje; libra, lo-dra, terrene lojërash dhe kënde lojërash; material sigurie; dhe për zhvillimin profesional të stafit të tyre. Kjo masë ishte pozitive gjinore. Në mënyrë që të adresohen më mirë çështjet me të cilat përballen gratë, fonde dhe masa shtesë gjithashtu mund të ishin konsideruar në lidhje me hapjen e qendrave shtesë të kujdesit për fëmijët, të cilat do të krijonin më shumë vende pune dhe do të rritnin punësimin. Mbështetje e ngjashme për gratë do të vazhdojë në vitin 2021 si pjesë e kësaj mase.

Duhet të theksohet se Komiteti i KB-së për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave ka lëshuar udhëzime për shtetet për të forcuar makineritë e grave, të tilla si Agjencia për Barazi Gjinore dhe zyrtarët për barazi gjinore, gjatë krizës dhe rimëkëmbjes. Asnjë masë nuk synonte në mënyrë të qartë forcimin e rolit të tyre në kryerjen e vlerësimeve të ndikimit gjinor në sektorë dhe komuna për të informuar përpjekjet e ardhshme të rimëkëmbjes, bazuar në nevojat e grave dhe burimeve të ndryshëm. Duke pasur parasysh mungesën e vlerësimeve adekuate të ndikimit gjinor për të informuar programet qeveritare dhe mungesës së burimeve të përgjithshme të këtyre mekanizmave të barazisë gjinore, ma-sat mund të kishin konsideruar investime të tilla në përmirësimin e kapaciteteve të tyre dhe forcimin e aftësisë së tyre për t'u përfshirë në planifikimin e buxhetit në lidhje me COVID-19.

Masa të tjera të rimëkëmbjes ekonomike

Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike përbante disa masa të tjera, përfshirë:

- Masa 7 - Sigurimi i mbështetjes financiare për punësimin e të rinjve, mbështetja e organizatave të shoqërisë civile, grupeve të tjera jo zyrtare, stimulimi i aktiviteteve kulturore, artistike dhe sportive dhe rivitalizimi i tyre, në vlerë prej 5,000,000 euro. [Pako paraprake gjithashtu parashikonte një rritje të granteve dhe subvencioneve të MKRS-së, në shumën deri në 5,000,000 euro].
- Masa 8 - Mbështetja e programeve ekzistuese dhe të reja në lidhje me zhvillimin rajonal përmes Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, në vlerë prej 2,000,000 euro. [Masa e re].

- Masa 9 - Mbështetja e projekteve dhe iniciativave të komuniteteve jo-shumicë që synojnë përmirësimin e jetës së tyre dhe ringjalljen e tyre ekonomike, në vlerë prej 2,000,000 euro.
- Masa 13 - Sigurimi i mbështetjes financiare për bashkatdhetarët [Diasporën] duke mbuluar koston e primeve të policës së sigurimit, në shumën 3,000,000 euro. [Masa e re].
- Masa 14 - Financimi (rimbursimi i linjave buxhetore) për zbatimin e masave sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 01/19, në vlerë prej 71,700,000 euro. [Do të mbulojë zbatimin e masave në Pakon Fiskale Emergjente, megjithëse nuk thuhet saktësisht se cila].
- Masa 15 - Sigurimi i rezervës për raste urgjente – Rezerva mbahet për raste emergjente për të përballuar më mirë pandeminë COVID-19, në vlerë prej 19,000,000 euro. [Masa e re].

Sa i përket masës 7, pakoja paraprake gjithashtu parashikonte rritje të granteve dhe subvencioneve të MKRS-së, në shumën deri në 5,000,000 euro. E rëndësishme është se masa synon të adresojë nevojat e të rinjve, OShC-ve, artistëve, sportistëve dhe të tjerëve potencialisht të prekur nga COVID-19. Megjithatë, në formulimin e saj me shkrim, Masa nuk i konsideron në mënyrë të qartë shumë nivelet e punësimit të ndryshme të grave të reja (46.2%) dhe burrave (13.9%). As nuk e konsideron faktin e lartpërmendur që gratë historikisht kanë qenë të nënpërfaqësuar në mesin e përfituesve të subvencioneve shtetërore që kanë të bëjnë me kulturën, artin dhe sportet. Masa nuk i konsideron ose adreson këto ndryshime gjinore, të cilat madje mund të kontribuojnë në forcimin e pabarazive, të cilat do të ishin negative gjinore.

Masa 8 është një masë e re që nuk ekzistonte në pakon paraprake. Kjo masë kërkon të financojë zhvillimin rajonal socio-ekonomik, mesa duket në mes të rajoneve brenda Kosovës përmes kategorisë ekonomike të subvencioneve dhe transferimeve. Në formulimin e saj, ajo nuk mori në konsideratë ndonjë analizë gjinore dhe ishte e vështirë të përcaktohej se kush mund të përfitonte nga këto fonde, bazuar në informacionin e disponueshëm publikisht.

Sa i përket masës 9, e cila është e njëjtë si në pakon paraprake, në të njëjtën shumë, gratë dhe burrat brenda grupeve etnike të pakicave në Kosovë mund të jenë në pozita shumë të ndryshme dhe të kenë qasje të ndryshme në proceset e vendimmarrjes dhe burimet brenda komuniteteve të tyre. Masa 9 nuk i konsideron këto ndryshime gjinore në formulimin e saj me shkrim.

Për më tepër, masat 7 dhe 9, në dukje për OShC-të, nuk marrin në konsideratë pozitat e ndryshme të grupeve të ndryshme të shoqërisë civile, dhe pabarazitë dhe sfidat e mundshme ndërsektoriale me të cilat përballen në varësi të sektorit në të cilin ata punojnë (p.sh., dhuna në familje, bujqësia), vendndodhja gjeografike (rurale/urbane), përkatësia etnike dhe/ose mosha, dhe se si këto mund të kryqëzohen me gjininë për të krijuar sfida të shtuara gjatë kësaj periudhe.

Organizatrat për të drejtat e grave, mes OShC-ve të tjera, kanë qenë në rradhët e para të përpjekjeve për të adresuar pandeminë COVID-19. Edhe para pandemisë OJQ-të e grave janë përballur me sfida të ndryshme. Nga 72 OJQ të grave të intervistuar në Kosovë më 2019, 50% nuk e plotësuan buxhetin e tyre më 2018 dhe 86% e tyre kishin mbetur pa burime në një pikë . 16% nuk kishte marrë kurrë më parë fonde dhe kishte punuar plotësisht mbi baza vullnetare . Pra, edhe pse OSHCG tashmë janë përballur me sfida të konsiderueshme financiare para fillimit të pandemisë, ato kanë marrë përgjegjësi shtesë dhe ngarkesë pune mes krizës. Vlerësimi i shpejtë i RrGK-së për 110 nevojat e OSHCG-ve në prill zbuloi se pandemia gjithashtu ka pasur disa pasoja tek ato . Ato u përballën me vështirësi financiare për të paguar qiranë, pagat dhe shpenzimet e zyrës, veçanërisht pasi ngjarjet publike u anuluan dhe kështu buxhetet e tyre u shkurtuan. Ato gjithashtu luftuan për të mbledhur fonde mes ngarkesës së shtuar të punës dhe vështirësive në planifikimin e vazhdimit të



Gratë nuk kishin asnjë avantazh kur u shpenzuan ato para [të qeverisë].

Asnjë pabarazi, përveç se burrat përfitojnë automatikisht sepse konsiderohen kryefamiljarë.

— Zyrtarët e financave

ndjeshëm të punës së tyre mes pandemisë dhe masave të izolimit të lidhur me to. Për shumë OSHCG që punojnë me grupe të marginalizuara, duke përfshirë njerëz me nevoja të veçanta, takimi personal është thelbësor. Vështirësitë në organizim kontribuuan në stresin emocional dhe shterrje profesionale. Për aktivistet e angazhuara gjatë viteve 1990, masat e izolimit mbanin me vete edhe kujtime të izolimit dhe traumave të lidhura nga konflikti, të cilat ndikuan në shëndetin e tyre mendor.

Strehimoret në veçanti u goditën rëndë nga pandemia. Tashmë të financuara pamjaftueshëm, strehimoret ishin dëshmitare të një fluksi në rastet e raportuara. Ndërkohë, punonjësit e moshuar të strehimore, që janë në mesin e grupeve më të rrezikuara, kishin frikë të vinin në punë duke pasur parasysh rrezikun e infektimit. Pasi strehimoret u gjendën në një situatë staf të zvogëluar, punonjësit më të rinj morën ndërrime shtesë, shpesh duke punuar me ndërrime të shumta me radhë për të adresuar nivelin e nevojës. Fillimisht, strehimoreve gjithashtu iu desh të blinin vetë produktet sanitare ato të mbrojtjes personale, pasi atyre u mungonin burimet e nevojshme.

Shumë organizata dhe institucione shpejt ndërhyjnë për t'i furnizuar ato me burime emergjente dhe ndihmë financiare. Më vonë, Agjencia për Barazi Gjinore, së bashku me akterë të tjerë, më 29 prill hapën një strehimore të përkohshme për gratë dhe fëmijët e tyre, gjatë pandemisë. Policia atëherë mund të testonte gratë dhe familjet e tyre para se të hynin në strehimore me qëllim të sigurisë së personelit të strehimore dhe të mbijetuarve të tjerë. Mes çështjeve emocionale dhe shëndetësore, OJQ-të kanë këmbëngulur, duke vazhduar të organizojnë aktivitete në internet. Ato kanë luajtur një rol jetik në adresimin e çështjeve të mbetura të pa adresuara nga shteti, të tilla si mbledhja e fondeve për dhe shpërndarjen e pajisjeve mbrojtëse dhe paketave të kujdesit për personat e varfëruar nga efektet e pandemisë. Kështu që masat që mbështesin shoqërinë civile, përfshirë grupet etnike të pakicave, nuk marrin parasysh qartë ndryshimet e mundshme gjinore në formulimin e tyre. Nëse nuk adresohen në zbatim, masat kanë potencialin për të mbështetur pabarazitë e mundshme në qasjen në burime, midis OJQ-ve të ndryshme.

Masat shtesë

Ekziston mundësia që ministritë dhe komunat të ndërmarrin masa shtesë për të mbështetur ekonominë përtej masave të deklaruara në mënyrë të qartë brenda masave të Emergjente Fiskale ose masave të Rimëkëmbjes Ekonomike. Ndërsa këto mund të mos kenë të bëjnë qartë me adresimin e pandemisë COVID-19, këto masa mund të kenë mbështetur përpjekjet e emergjencës dhe rimëkëmbjes. Ndërsa ky hulumtim u përqendrua në masat e sipërpërmendura të dizajnuara në mënyrë të qartë për të adresuar COVID-19, RrGGK nuk shqyrtoi përpjekjet e tjera të mundshme.

Megjithatë, MTI (që ktheu emrin dhe funksionin e mëparshëm nga qeveria e udhëhequr nga Hoti në qershor), përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve të Kosovës (KIE-SA), shpalli thirrje publike për subvencionimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) për të forcuar bizneset me të paktën 50% bashkëpronësi nga gratë sipërmarrëse. KIESA publikoi thirrjen më

12 shtator 2020, bazuar në Udhëzimin Administrativ të MTI-së nr. 01/2018 për alokimin e fondeve nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve. Tri kategori kishin të drejtë të aplikonin:

- Mikro ndërmarrjet (me 1 deri në 9 punonjës), të cilat mund të përfitojnë deri në 10,000 euro;
- Ndërmarrjet e vogla (me 10 deri në 59 punonjës), të cilat mund të përfitojnë deri në 20,000 euro; dhe
- Ndërmarrjet e mesme (me 50 deri në 249 punonjës), të cilat mund të përfitojnë deri në 30,000 euro.

Më 2 dhjetor 2020, MTI nënshkroi marrëveshje bashkëfinancimi me 32 ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme, të udhëhequra nga gratë sipërmarrëse. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë theksoi se gratë sipërmarrëse kanë dëshmuar vazhdimisht se dinë të menaxhojnë jo vetëm familjet e tyre, por edhe bizneset e tyre në bashkëpunim me institucionet publike. Si rezultat i kësaj mbështetjeje, 140 gra do të punësohen në këto 32 ndërmarrje në pronësi të grave. Buxheti i vitit 2021 parashikon një rritje të buxhetit për subvencione për gratë sipërmarrëse. Megjithatë kjo masë nuk ishte e qartë në përgjigje të pandemisë COVID-19, është një shembull i një mase afirmative, pozitive gjinore, drejt mbështetjes së bizneseve të drejtuara nga gratë që mund të ndihmojnë në adresimin e vështirësive të shkaktuara nga pandemia.

Përfundime: Masat emergjente dhe rimëkëmbja ekonomike nga perspektiva gjinore

Si përmbledhje, një rishikim i këtyre masave ekonomike nga këndvështrimi gjinor sugjeron që shumica e masave nuk morën parasysh nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, as veprimet për avancimin e barazisë gjinore. Intervistat me zyrtarët e financave dhe ZBGj-të në ministritë kryesore sugjerojnë se zyrtarët nuk kanë marrë parasysh perspektivën gjinore gjatë procesit të hartimit të ndonjë prej masave. Disa zyrtarë vunë re se ata nuk morën pjesë në planifikimin e masave, por vetëm në ekzekutimin e tyre, kështu që ata nuk mund të kishin ndikuar në hartimin e masave drejt integritit të një perspektive gjinore. Në nivelin komunal, zyrtarët e financave ishin të përfshirë vetëm në vlerësimin se cilat fonde duhet të rialokohen për të adresuar pandeminë, pas kërkesave të paraqitura nga Selia e Emergjencave drejtuar kryetarëve të komunave dhe kuvendeve komunale. ZBGj-të e intervistuar thanë se ata nuk ishin të përfshirë në ndonjë nga proceset e planifikimit ose vendimmarrjes në lidhje me buxhetet për adresimin e COVID-19, gjë që gjithashtu mund të kishte minuar shkallën në të cilën një perspektivë gjinore u reflektua në këto masa. Gjatë intervistave, të anketuarit tentuan të deklararin se masat nuk favorizonin asnjë gjini. Grupet e synuara, thanë ata, përfshinin njerëz që aplikuan për të përfituar nga masat ose që u identifikuan se ishin në nevojë. Programet, si të tilla, ishin të hapura për të gjithë përfituesit e kualifikuar. Zyrtarët theksuan se asnjëra gjini nuk ishte “e favorizuar” në planifikimin dhe zbatimin e këtyre masave dhe se të dy gjinitë u trajtuan njësoj. Ndërsa intervistat u përqendruan në Pakon Fiskale Emergjente, gjetjet me sa duket do të qëndronin të vërteta në lidhje me Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike, duke qenë se ai ishte duke u hartuar gjatë fazës së hulumtimit, në kohën e intervistave.

Deklaratat e tyre nënkuptojnë që zyrtarët i konsideruan këto masa “gjinore neutrale”, kur në fakt ata nuk e konsideruan aspak gjininë. Si rezultat, masat mund të jenë edhe negative gjinore duke

përforcuar pabarazitë gjinore para-ekzistuese. Si përfundim, masat ekonomike nuk përfshinë analizën e mjaftueshme të ndikimit gjinor të propozimeve të politikës së shpenzimeve, dokumentacionit të propozuar të buxhetit të përgjegjshëm gjinor, ose planeve të performancës të ndara sipas gjinisë për ofrimin e shërbimeve, sipas dimensioneve 1.1, 4.1 dhe 5.1 të SHPPF MPGJFP.

Masat arsimore

Ky seksion shqyrton shkallën në të cilën masat qeveritare në lidhje me arsimin konsideruan dallimet midis vajzave dhe djemve të ndryshëm. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) nuk ishte drejtpërdrejt përgjegjëse për ndonjë nga masat e qeverisë në Pakon Fiskale Emergjente. Sidoqoftë, ajo mori masa të tjera në lidhje me sistemin arsimor. Siç u përmend, nga 11 mars deri më 26 qershor 2020, shkollat u mbyllën si masë parandaluese. Ndërsa numri i rasteve u rrit, MASHT vendosi të përdorë mësimin në internet. Duke filluar nga 24 marsi, nxënësit e klasave 1-5 filluan të mësojnë përmes video mësimëve të transmetuara në dy kanale të Transmetuesve të Shërbimit Publik. Këto video-mësime janë përgatitur nga MASHT. Fillimisht ato përfshinin vetëm dy lëndë: matematikë dhe gjuhë. Një javë më vonë, video-mësimet u bënë të disponueshme edhe për klasat 6-9. Platforma të tjera u përdorën për nxënës të shkollës së mesme dhe të shkollës profesionale.

Mësimi në internet nuk filloi në të njëjtën kohë për nxënësit që flasin serbisht. Sipas Ministrisë të Arsimit, kjo ishte për shkak se komunat serbe nuk bashkëpunuan; MASHT kërkoi nga Drejtoritë Komunale të Arsimit në këto komuna të identifikojnë mësimdhënësit për të përgatitur videot-materiale, por ata nuk u përgjigjën. Përndryshe, zonat folëse boshnjake dhe turke identifikuan mësimdhënësit, dhe mësimi në distancë filloi më 30 mars në gjuhët turke dhe boshnjake. Sidoqoftë, komunat serbe nuk e përkrahën angazhimin e mësimdhënësve serbë që do të përgatisnin materialet mësimore sipas programeve mësimore të Kosovës. Më 1 shtator, komunat me shumicë serbe filluan mësimin në internet, pas rekomandimeve nga Ministria e Arsimit të Serbisë dhe duke përdorur programet mësimore të Serbisë. Kështu, për më shumë se pesë muaj, fëmijët folës serb nuk kishin arsim.

Më 2 prill, qeveria miratoi një pako mbështetëse për mësimin në internet, e cila përfshinte pagesa shtesë të pagave mujore të mësimdhënësve për mësimdhënësit e përfshirë drejtpërdrejt në përgatitjen e video materialit mësimor për klasat 1-9; staf i shkollës "Qamil Batalli" në Prishtinë dhe "Emin Duraku" në Prizren; personeli ndihmës i nëpunësve civilë në departamentet e arsimit në komunat e Prishtinës dhe Prizrenit; Pagesa varion midis 150 dhe 300 euro; paratë do të buronin nga buxheti i MASHT-it. Për maj dhe qershor, qeveria alokoi fonde nga linja e lartpërmendur e buxhetit të emergjencës të Ministrisë së Financave për të mbështetur MASHT-in në sigurimin e mësimin në internet.

Sipas përfaqësuesve të MASHT-it, ata nuk morën asnjë alokim shtesë buxheti për adresimin e COVID-19 kur buxheti i Kosovës u ndryshua në gusht. Përkundrazi, buxheti i tyre u zvogëluar. MASHT themeloi një grup punues për të përgatitur një Master Plan për të Mësuarit në Kushtet Pandemike për vitin akademik 2020/2021. Qeveria e Kosovës ndau një buxhet prej 9,926,959 euro për arsimin përgjatë COVID-19.

Në gusht, MASHT kërkoi një buxhet prej 9,926,959 € për vitin shkollor 2020/2021, në mes të kushteve pandemike. Menjëherë pas kësaj, qeveria e Kosovës ndau buxhetin e kërkesës prej 9,926,959 € për arsimin në mes të COVID-19. Fondet u transferuan në kategorinë ekonomike për mallra dhe shërbime nga buxheti i qeverisë për Rimëkëmbjen Ekonomike, sipas Planit për Rimëkëmbje Ekonomike. Veçanërisht, sipas decentralizimit, MASHT-i financon vetëm arsimin në nivelin universitar dhe zhvillimin

e kurrikulës, ndërsa komunat financojnë arsimin parauniversitar. Prandaj, nga ky buxhet i përgjithshëm, për vitin shkollor në vitin 2020, MASHT-i mori 1,864,647 €, dhe komunat morën 2,960,000 €. Për të mundësuar të mësuarit në kushte pandemike në vitin 2021, MASHT-i mori 1,401,512 € dhe komunat 3,700,800 €. Shuma e fondeve të shpërndara në secilën komunë është llogaritur bazuar në numrin e nxënësve të shkollave për komuna. Në të vërtetë kjo përkon me Masën II të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike, “Mbështetja e sektorit të arsimit për të mundësuar fillimin dhe mbarëvajtjen e proceseve të mësimdhënies dhe të të nxënësve gjatë viti shkollor 2020/2021”, i buxhetuar në vlerë prej 10,000,000 €”. Në formulimin e saj, kjo masë nuk ka marrë në konsideratë aspektin gjinor.

Gjatë intervistave, përfaqësues të MASHT-it, konfirmuan se masat arsimore nuk morën parasysh perspektivën gjinore. Ata planifikuan përgjigjen “për të përmbushur nevojat e njerëzve në përgjithësi”. Ata nuk morën parasysh nevojat potencialisht të ndryshme të vajzave dhe djemve, grave dhe burrave. Masat arsimore ishin “neutrale në bazë gjinore” pasi MASHT i konsideroi ato “të drejta” duke i trajtuar të gjithë njësoj. Si rezultat, MASHT-i ndoshta në mënyrë të pavetëdijshme shpërfilli pabarazitë strukturore gjinore. Së pari, vendimi për t’i mbajtur fëmijët në shkollë si një masë parandaluese para se virusi të fillojë të përhapet nuk mori në konsideratë ndikimin e kundërt që kjo mund të kishte mbi gratë, aftësinë e tyre për të punuar dhe të ardhurat e tyre, duke pasur parasysh normat tradicionale gjinore. Ky vendim rriti shumë kërkesën për punë të papaguar brenda familjeve, të kryera kryesisht nga gratë. Gratë duhet të kalonin kohë duke u kujdesur dhe mbështetur fëmijët, veçanërisht fëmijët më të vegjël, se si të përdorin teknologjinë në mënyrë që fëmijët të mësojnë. Kjo kërkonte kohë shtesë për gratë, gjë që dëshmitë cilësore sugjerojnë se kanë ndikuar në aftësinë e tyre për të punuar dhe, në disa raste, kanë kontribuar në humbjen e punës të shumë grave. Padyshim që këto masa ishin negative gjinore.

Së dyti, ndërsa programet e të mësuarit në internet transmetoheshin radhazi për secilën klasë (klasa e parë deri në të nëntën), kjo nuk merrte parasysh kushtet shtëpiake të vajzave dhe djemve të ndryshëm dhe qasjen e tyre në këtë arsim televiziv. As programimi i ri në internet nuk mori parasysh se si një përmbajtje e tillë mund të përdoret për të transformuar pabarazitë gjinore. Thuhet se, disa mësimdhënës përdorën Viber dhe më vonë Zoom për të komunikuar me fëmijët. Në disa familje, shumë fëmijë kishin orë mësimi në Zoom në të njëjtën kohë, por familja kishte vetëm një telefon të mençur ose pajisje të disponueshëm. Para se mësimdhënësit të fillonin këtë punë arsimore, MASHT nuk kishte analizuar kushtet familjare të familjeve për të siguruar që teknologjia do të ishte në dispozicion. Familjet potencialisht të varfra nuk kishin ndonjë pajisje në dispozicion. Për më tepër, kjo qasje supozon qasje në internet; jo të gjitha familjet kanë internet të qëndrueshëm dhe Kosova është përballur me disa ndërprerje të internetit gjatë kësaj periudhe, duke penguar qasjen e fëmijëve në mësimin në internet.

Në qershor 2020, Ministri i Arsimit raportoi në Komisionin e Kuvendit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë dhe Sport se të mësuarit në internet arriti 89.4% të fëmijëve, ndërsa rreth 32,000 nxënës nuk morën pjesë në mësimin në internet sepse nuk kishin teknologji dhe nuk kishte sinjal televiziv për transmetimin e mësimin në distancë. Zyrtarët e MASHT-it thanë se mungesa e pajisjeve dhe qasja në internet është një sfidë; ata kanë kërkuar dhe inkurajuar donacione nga individë, donatorë dhe komuna.

MASHT më vonë sqaroi se në mars të vitit 2020, kishte 312,497 fëmijë të regjistruar në klasat I-12 (48.6% vajza, 51.4% djem). Gjatë pandemisë, 304,023 fëmijë morën pjesë në sistemin e të mësuarit në internet (97.2%), që do të thotë se vetëm 8,474 fëmijë nuk morën pjesë. MASHT nuk ka të dhëna të ndara gjinore për fëmijët që nuk janë në gjendje të ndjekin mësimin në internet. Vetëm në Komunën e Prishtinës, nga 28,785 nxënës të shkollës, 1,073 nuk kanë pasur qasje në arsim. Komuna e Prishtinës ka kërkuar ndihmë

për të ndihmuar fëmijët në 500 familje që ata kanë identifikuar se nuk kanë qasje në pajisjet teknologjike. Shifrat e sakta në lidhje me atë se sa fëmijë vazhdojnë të kenë mungesë të qasjes në mësimin në internet, përfshirë gjininë, vendndodhjet, moshën, etninë dhe aftësinë, nuk janë të disponueshme.

Ndikimet afatgjata të mos ndjekjes së arsimit mund të jenë të dëmshme për arritjen arsimore të fëmijëve dhe mirëqenien e tyre më vonë gjatë jetës. Vajzat mund të jenë në rrezik të veçantë duke pasur parasysh normat e mëparshme shoqërore, sipas të cilave historikisht familjet kanë tentuar të favorizojnë qasjen e djemve në arsim në situata kur familja nuk ka mundësi të arsimojë të gjithë fëmijët. Prandaj, në përgjithësi, masat arsimore për sigurimin e shkollimit në internet nuk kishin marrë parasysh aspektin gjinor dhe potencialisht mund të jenë edhe negative gjinore, megjithëse mungojnë të dhënat përkatëse.

Për vitin 2021, për zbatimin e Master-palnit për mësim në kushte pandemie, MASHT ka buxhetuar 500,000 euro të shpenzimeve për Mësimin në Internet në Pandemi për të blerë teknologji. Kjo bie nën nën-programin e investimeve kapitale për arsimin parauniversitar.

Lidhur me përfituesit, MASHT nuk kishte të dhëna të ndara sipas gjinisë në lidhje me pjesëmarrjen e të mësuarit në internet nga vajza dhe djem, të tilla si nga përkatësia etnike, mosha, aftësia ose zona gjeografike. MASHT deklaroi se edhe pse nuk është ndërmarrë asnjë veprim për të vlerësuar ndikimin e masave të tyre, ata besojnë se nuk janë identifikuar probleme. Kështu, ata nuk parashikuan se do të integronin një perspektivë të përgjithshme gjinore në masat ose politikat e ardhshme për arsimin në mes të krizës COVID-19. Kjo është shqetësuese, duke marrë parasysh sfidat e lartpërmendura të mundshme me të cilat vajzat dhe djemtë mund të përballen gjatë arsimimit. Vetëm duke vlerësuar ndikimin mund të dihet nëse vajza dhe djem kanë pasur qasje të barabartë. Për më tepër, përgjegjësitë shtesë për gratë lidhur me arsimin në shtëpi duhet të merren parasysh; për sa kohë që fëmijët janë në shtëpi, gratë do të luftojnë për të punuar. Si përfundim, masat arsimore nuk përfshijnë analizë të mjaftueshme të ndikimit gjinor të propozimeve të politikës së shpenzimeve, dokumentacionit të propozuar të buxhetit të përgjegjshëm gjinor, planeve të performancës të ndara sipas gjinisë për ofrimin e shërbimeve, ose të dhëna të ndara sipas gjinisë për shërbimet e ofruara, sipas SHPPF MPGJFP dimensionet 1.1, 4.1, 5.1, ose 5.2.

Masat shëndetësore

Ky seksion shqyrton shkallën në të cilën masat shëndetësore plotësuan nevojat potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave. Së pari, diskutohen sfidat për qasjen në kujdesin shëndetësor që ekzistonin para pandemisë COVID-19. Pastaj, masat qeveritare të marra në lidhje me shëndetin nga një perspektivë gjinore, e ndjekur nga çdo ndikim i njohur i këtyre masave.

Një analizë e shpejtë gjinore e qasjes në kujdesin shëndetësor

Në përgjithësi, gratë kanë mungesë të qasjes në kujdesin shëndetësor krahasuar me burrat, veçanërisht gratë në zonat rurale dhe nga grupe të caktuara të minoriteteve si romët, ashkalitë dhe egjiptianët. Kjo mungesë e qasjes në kujdesin shëndetësor mund të jetë shtuar gjatë pandemisë, veçanërisht duke pasur parasysh kufizimet mbi lëvizjen dhe mungesën e transportit publik të disponueshëm, në të cilin gratë priren të mbështeten më shumë se burrat. Gratë raportuan se kishin vështirësi në arritjen e shër-

bimeve jashtë rajoneve të tyre, përfshirë kujdesin shëndetësor. Thuhet se disa gra dhe vajza nuk kanë pasur qasje në kujdesin që u nevojitet. Sipas Qendrës së Studimeve Gjinore të Kosovës, gjatë pandemisë, “mungesa e perspektivës gjinore”, mungesa e “masave të veçanta për të siguruar funksionimin e reparteve gjinekologjike, mungesa e informacionit dhe punës me staf të reduktuar, rezultoi në uljen e numrit të vajzave dhe grave që kërkojnë shërbime gjinekologjike”.

Frika nga prekja me COVID-19 gjithashtu mund të ketë parandaluar njerëzit që të kërkojnë kujdes mjekësor për sëmundje të tjera, të cilat, nëse nuk trajtohen, mund të kontribuojnë në sëmundje të mëtejshme dhe madje edhe vdekje. Për shembull, njerëzit me aftësi të ndryshme varen nga dikush tjetër për t’i ndihmuar ata edhe në funksionet e tyre themelore, të përditshme, gjë që nuk ishte gjithmonë e mundur mes masave të izolimit. Për më tepër, duke marrë parasysh se shumë prej tyre kishin kushte themelore dhe autoimune, pak gra me aftësi të ndryshme ose nëna me fëmijë me aftësi të kufizuara u larguan nga shtëpitë e tyre nga frika e virusit.

Për më tepër, tendosjet e burimeve njerëzore në sektorin shëndetësor mund t’i kenë tërhequr punëtorët nga ofrimi i kujdesit shëndetësor të përgjithshëm. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, pandemia ka çuar në një rritje të nevojës për shërbime të shëndetit mendor, si izolimi, frika dhe humbja e të ardhurave janë duke shkaktuar apo përkeqësuar gjendjen mendore të burrat dhe gratë. Si një vend pas konfliktit, trauma themelore është rishfaqur mes masave të izolimit dhe frikës. Duke pasur parasysh ngurrimin e përgjithshëm të njerëzve për të kërkuar kujdesin e shëndetit mendor dhe disponueshmërinë e tij të kufizuar, veçanërisht mes masave të izolimit, shkalla e sfidave të shëndetit mendor ka të ngjarë të mbetet e panjohur.

Masat shëndetësore nga një perspektivë gjinore

Kjo pjesë analizon masat e qeverisë lidhur me masat shëndetësore nga një perspektivë gjinore. Ministria e Shëndetësisë ka qenë në ballë në adresimin e pandemisë. Qeveria i bazoi vendimet e saj në masat parandaluese në rekomandimet dhe udhëzimet nga kjo Ministri, ndër të tjera. Edhe para se rastet të konfirmoheshin në Kosovë, Ministria e Shëndetësisë filloi të siguronte informacione mbi situatën dhe udhëzime për masat parandaluese dhe mbrojtëse. Më 27 shkurt 2020, Ministri i Shëndetësisë themeloi Komitetin për Vlerësimin dhe Koordinimin e Situatës Emergjente me COVID-19. Komiteti kishte rolin për të vlerësuar, koordinuar dhe mbajtur komunikim të vazhdueshëm me institucionet përgjegjëse qeveritare për të vlerësuar situatën pandemike me COVID-19 dhe nevojat mjekësore të popullatës për këtë situatë.

Duke marrë parasysh ekspozimin e drejtpërdrejtë të punonjësve të kujdesit shëndetësor ndaj rreziqeve më të mëdha të infeksionit, Masa 6 në Pakon Fiskale Emergjente parashikonte pagesa shtesë prej 300 euro në muaj për pagat e mjekëve dhe infermierëve në prill dhe maj. Këto pagesa vazhduan të ekzekutohen në korrik dhe gusht. Bazuar në një vendim të qeverisë në tetor, ato do të zbatohen deri në fund të vitit 2020. Kjo masë, në formulimin e shkruar, nuk konsideronte në mënyrë të qartë një perspektivë gjinore ose nuk konsideronte nevojat potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave. Duhet theksuar, sidoqoftë, se duke pasur parasysh mbi-përfaqësimin e sipërpërmendur të grave në sektorin shëndetësor, që përfshin 61% të punonjësve, kjo masë do të ishte më shumë përfituese për gra sesa për burra. Sidoqoftë, kjo masë nuk adresoi domosdoshmërisht çështje të tjera si ngarkesat e shtuara fizike dhe psikologjike për punonjësit e kujdesit shëndetësor që ofrojnë shërbime gjatë pandemisë, duke çuar potencialisht në nevoja shtesë të kujdesit shëndetësor fizik dhe psikologjik dhe kostot

e lidhura me to; ose nevojat e institucioneve të kujdesit shëndetësor për fonde shtesë për të punësuar më shumë personel për të zvogëluar ngarkesën e punës.

Gjatë karantinës, duke marrë parasysh çështjet e shëndetit mendor dhe nevojën për t'u ofruar njerëzve shërbime këshilluese falas, Agjencia për Barazi Gjinore bashkëpunoi ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë për të ofruar shërbime të tilla. Ministria e Shëndetësisë bashkëpunoi me Universitetin e Prishtinës, Departamentin e Psikologjisë për të krijuar shërbime përmes linjave telefonike për shërbime këshilluese falas, si në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe, për njerëzit që kishin shqetësime dhe ankth si efekt i izolimit në karantinë. Ndërsa kjo masë nuk i referohej në mënyrë të qartë gjinisë, ajo mund të konsiderohej pozitive gjinore duke siguruar qasje në shërbimet e këshillimit që kanë potencialin për të kontribuar në parandalimin e dhunës me bazë gjinore që mund të lindë pjesërisht nga çështjet e shëndetit mendor.

Ministria e Shëndetësisë caktoi 55% të buxhetit të sektorit shëndetësor, afërsisht 40 milion euro, për t'iu përgjigjur pandemisë. Kjo ka përfshirë financimin për: sigurimin e testeve, pajisjet mbrojtëse për stafin, dezinfektimin dhe pagimin shtesë të pagave sipas Masës 6 në Pakon Fiskale Emergjente. Këto para u disbursuan përmes dy programeve: farmaceutikës dhe administratës. Sipas zyrtarëve, Ministria nuk ka marrë parasysh buxhetimin e përgjegjshëm gjinor gjatë planifikimit ose ekzekutimit të këtij buxheti. Të anketuarit nga Ministria thanë: “në shëndetësi, nuk mund ta bëni këtë dallim; ju ofroni shërbimin, kujdesin shëndetësor, atyre që e kërkojnë atë, atyre që kanë nevojë për të”; “Ministria është vetëm për pacientët”; dhe “nuk ka çështje me pabarazi në sektor”. Këto deklaratat janë dëshmi se Ministria ka pasur qasjen nuk e kanë marrë në konsideratë aspektin gjinor, pasi ata nuk kanë marrë parasysh nevojat potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave në lidhje me qasjen në kujdesin shëndetësor, ose mënyrat në të cilat gratë dhe burrat punonjës të kujdesit shëndetësor mund të jenë ndikuar negativisht nga pandemia dhe ngarkesa shtesë e punës e lidhur me të.

Lidhur me përfutuesit e masave të lidhura me shëndetësinë, siç u përmend, vetëm për periudhën midis 13 dhe 24 mars 2020 IKSHP bëri publike të dhëna të ndara sipas gjinisë në lidhje me testet e kryera, rastet pozitive të konfirmuara dhe vdekjet. Ndërsa të dhëna të tilla ekzistojnë edhe për periudhat e mëvonshme, ato nuk janë publikuar. Kjo sugjeron që sistemet e tyre të menaxhimit të të dhënave IKSHP janë joadekuate, pasi ato duhet të mundësojnë gjenerimin e raporteve të tilla të thjeshta në mënyrë automate, duke kërkuar vetëm disa minuta kohë të burimeve njerëzore. Pa të dhëna të tilla, është e vështirë të përcaktohet nëse më shumë burra ose gra janë prekur nga virusi, qasja e tyre në kujdesin shëndetësor dhe testimin, dhe çështje të tjera. As informacioni mbi numrin e personave të trajtuar nuk ishte i disponueshëm publikisht, ose qasja potencialisht e ndryshme e grave dhe burrave në shërbime. Të dhënat mbi përdorimin e përgjithshëm të sistemit të kujdesit shëndetësor këtë vit, siç krahasohet me vitet e mëparshme, nuk janë ende në dispozicion. Prandaj, përdorimi nga gratë dhe burrat i shërbimeve të kujdesit shëndetësor jo të lidhura me COVID-19 dhe ndikimet potencialisht më të gjera në shëndetin e tyre nuk mund të vlerësohen ende. Kjo e bën të vështirë vlerësimin e ndikimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, dhe kështu të shpenzimeve, në përgjigje të COVID-19.

Si përfundim, masat shëndetësore nuk përfshijnë analizën e mjaftueshme të ndikimit gjinor të propozimeve të politikës së shpenzimeve, dokumentacionit të propozuar të buxhetit të përgjegjshëm gjinor, planeve të performancës të ndara sipas gjinisë për ofrimin e shërbimeve, ose të dhëna të ndara sipas gjinisë për shërbimet e ofruara, siç përcaktohet nga SHPPF MPGJFP dimensionet 1.1, 4.1, 5.1, ose 5.2.

Masat komunale

Kjo pjesë analizon se në çfarë niveli, dizajnimi i masave komunale ka marrë parasysh nevojat e ndryshme të grave dhe burrave. Sapo Kosova filloi të merret me pandeminë, komunat tentuan të ndërmarrin hapa edhe për ta adresuar atë. Megjithëse Pakoja Fiskale Emergjente parashikonte mbështetje financiare për komunat e prekura nga pandemia, në vlerë prej 10 milion euro, në kohën e intervistave, në gusht 2020, kjo mbështetje nuk ishte siguruar akoma. Zbatimi i kësaj mase filloi vetëm në tetor. Sidoqoftë, implementimi aktual i kësaj mbështetje për komunat nuk lidhet me Masën 5 të Pako Fiskale Emergjente fillestare të 30 Marsit. Përkundrazi, mbështetja lidhet me Masën 12 të Planit më të ri për Zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike, miratuar nga qeveria e re, më 13 gusht.

Më 14 shtator, qeveria vendosi të zbatojë Masën 12, duke siguruar komunat me mbështetje financiare në vlerë prej 10 milion euro për projekte të lidhura me COVID-19. Prandaj, Ministria e Qeverisjes Lokale dhe Ministria e Financave ishin të detyruara ta zbatojnë këtë masë duke krijuar një komision vlerësues që do të vlerësonte të drejtën e komunave për të marrë këto fonde, bazuar në kriteret e miratuara. Ky komitet shpërndau fonde në 38 komuna, bazuar në kriteret e mëposhtme:

- I. Komunat e vogla me më pak se 50,000 banorë kishin të drejtë për një fond maksimal prej 300,000 euro. Në total u shpërndanë 3 milion euro.
- II. Komunat që ishin në karantinë ose kishin kufizime pasi ishin burime të infeksionit kishin të drejtë në maksimum prej 200,000 euro. Bazuar në vendimet e qeverisë për karantinat dhe kufizimet, Komisioni i Vlerësimit vendosi të mbështesë komunat që ishin në karantinë me 64,080 euro dhe komunat me kufizime në lëvizje me 55,000 euro.
- III. Bazuar në madhësinë e popullsisë, komunat supozohej të mbështeteshin me një shumë maksimale individuale prej 200,000 euro. Në total, 38 komuna morën 3,996,435 euro. Shuma e mbetur, 1,003,565 euro, u shpërndanë në dy kategoritë e para.

Komunat i morën këto fonde vetëm nga 5 tetori. Duke pasur mungesën e kësaj mbështetjeje gjatë fazës fillestare të emergjencës, komunat duhet të vepronin vetë dhe të përdornin buxhetet e tyre tashmë të caktuara për t'iu përgjigjur nevojave, siç është përshkruar në kapitullin e parë.

Shumica e zyrtarëve komunalë të financave të intervistuar e dinin se buxhetimi i përgjegjshëm gjinor ishte detyrim ligjor, bazuar në Ligjin e Kosovës për Barazi Gjinore. Sidoqoftë, në praktikë, zyrtarët komunalë thanë se në situata emergjente, ata nuk mund të konsultoheshin me publikun dhe të merrnin parasysh nevojat e ndryshme të grave. Pavarësisht nëse kishin konsultime, ata theksuan se të gjithë, pa dallim, kanë të njëjtat nevoja. Përfituesit e synuar ishin njerëzit në nevojë, përkatësisht ata që jetonin në gjendje të keqe ose me ndihmë sociale dhe bizneset, thanë ata. Për më tepër, ligjet e zbatueshme për shpenzimet kanë kriteret specifike që duhet të zbatohen, dhe këto nuk janë të drejtuara në bazë gjinore, thanë ata. Kështu që, planifikimi dhe ekzekutimi i buxheteve komunale të komunave në përgjigje të COVID-19 tentonte të mos e merrte parasysh aspektin gjinor. Në përgjithësi, deklaratat e tyre të lartpërmendura tregojnë për faktin se zyrtarët nuk kanë një kuptim të duhur të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor ose mënyrën e zbatimit të tij. Ndryshe, dy nga komunat e intervistuar mbështesin nënat vetushqyese në mënyrë të qartë, si një ndërhyrje e ndjeshme gjinore.

Një i anketuar tha që masat afirmative mund të përdoren vetëm për kategorinë ekonomike të buxhetit të subvencioneve. Sidoqoftë, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore, masa të veçanta siç

janë kuotat dhe programet mbështetëse për të siguruar pjesëmarrje të barabartë të të dy gjinive, duhet të përdoren në të gjitha fushat ku ekzistojnë pabarazitë gjinore. Këto përfshijnë gjithashtu “hapa për të përmirësuar pozicionin e grave dhe burrave në [të gjitha] fushat [...] dhe alokimin dhe/ose rialokimin e burimeve”. Në këtë kuptim, kategoria ekonomike e përdorur është e parëndësishme. Për më tepër, për të pasur qasje në subvencione, gratë duhet të informohen në lidhje me mundësitë në dispozicion në mënyrë që të mund të kërkojnë mbështetje komunale, vërejtje nga zyrtarë tjetër. Mungesa e qasjes në informacion ose paaftësia për të arritur fizikisht zyrën përkatëse me një kërkesë mund të nënkuptojnë që gratë mund të mos i përdorin këto mundësi.

Në kohën e intervistave në gusht, vetëm njëra nga komunat me intervistë posedonte të dhëna të ndara sipas gjinisë për një nga masat e saj komunale: për të mbështetur familjet me ushqime dhe paketa higjienike; nga 2,600 përfitues që morën 50 € secila, 66 ishin gra (2.5%) dhe 2,534 ishin burra (97.5%). Kjo ilustron një ndryshim të qartë në qasjen e grave dhe burrave në këtë përfitim. Kjo mund të jetë pjesërisht për faktin se ndihma ishte shpërndarë përmes kryefamiljarëve, të cilët, siç u përmend, në Kosovë priren të jenë burra. Në të vërtetë, zyrtari shpjegoi se numri i grave që përfitojnë mund të jetë më i lartë, pasi ndonjëherë ata mbledhin ndihmë nën regjistrimin e anëtarëve meshkuj të familjes, edhe kur, në disa raste, këta anëtarë të familjes kanë ndërruar jetë. Siç u diskutua, mënyra se si ndahen fondet të tilla brenda familjes mbetet e panjohur dhe nuk mund të supozohet se gratë dhe burrat anëtarë të familjes përfitojnë në mënyrë të barabartë.

Në përgjithësi, komunat patën tendencë të mos mbanin të dhëna për gratë dhe burrat përfitues të masave komunale për të adresuar pandeminë COVID-19. Të dhënat e disponueshme nuk janë të ndara sipas gjinisë. Kur u pyetën për mungesën e të dhënave të ndara sipas gjinisë, përgjigjet e zyrtarëve ndryshuan. Disa u habitën me idenë që informacioni duhet të ndahet, sepse sipas mendimit të tyre, “në një situatë pandemike, nuk mund të bësh dallime gjinore”, dhe “të gjithë njerëzit kishin nevojë të mbroheshin, pa dallim”. Përtej mungesës së njohurive në lidhje me detyrimin e Ligjit për Barazi Gjinore për të mbajtur të dhëna të ndara sipas gjinisë, kjo sugjeron një mungesë të përgjithshme të kuptimit të domethënies, përdorimeve dhe qëllimit të mbledhjes së të dhënave të ndara sipas gjinisë në mënyrë që të informohen politikave dhe programet. Për më tepër, kjo sugjeron njohuri të pamjaftueshme në lidhje me integrimin gjinor dhe si ta zbatojmë atë në praktikë në lidhje me planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, shërbimeve dhe buxheteve.

Si përfundim, masat komunale nuk përfshijnë analizën e mjaftueshme të ndikimit gjinor të propozimeve të politikës së shpenzimeve, dokumentacionit të propozuar të buxhetit të përgjegjshëm gjinor, planeve të performancës të ndara sipas gjinisë për ofrimin e shërbimeve, ose të dhëna të ndara sipas gjinisë për shërbimet e ofruara (me një përjashtim), sipas SHPPF MPGJFP, përkatësisht dimensionet 1.1, 4.1, 5.1 ose 5.2.

Përgjegjshmëria e Përgjithshme Gjinore e Masave

Ky seksion përmbledh, në përgjithësi, shkallën në të cilën zyrtarët qeveritarë konsideruan nevojat e ndryshme të grave dhe burrave në masat qeveritare për të adresuar COVID-19. Kur zyrtarët qeveritarë u pyetën se nëse institucioni i tyre kishte kryer një vlerësim të Ndikimit Gjinor për të informuar masat, sipas SHPPF MPGJFP 1.1 mbi analizën e ndikimit gjinor të propozimeve të politikave të shpenzimeve, 28 nga 34 të anketuarit thanë që nuk ishte bërë një vlerësim i tillë. Vetëm një i anketuar tha që

institucioni i tyre kishte kryer një Vlerësim të Ndikimit Gjinor. Pesë të tjerët nuk dinin nëse ishte bërë ndonjë vlerësim i tillë, që do të thotë se ata nuk mund të ishin tërhequr prej tij për të informuar masat.

Se “COVID-19 preku të gjithë pa marrë parasysh gjininë” ishte një përgjigje e përsëritur midis të intervistuarve. Në institucionet përkatëse të intervistuar, zyrtarët tentuan të mos e konsiderojnë barazinë gjinore një përparësi ose të mendojnë se ndryshimet midis grave dhe burrave duhet të merren parasysh gjatë planifikimit të përgjigjes së qeverisë ndaj COVID-19. Në përgjithësi zyrtarët nuk e kuptuan kuptimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, si ta realizojnë atë, ose si të sigurojnë ofrimin e shërbimeve me përgjegjësi gjinore.

Mekanizmat e barazisë gjinore ekzistojnë në të gjitha institucionet dhe ato mund të kenë mbështetur integrimin e gjinisë në programet dhe politikat e emergjencave dhe shërimin. Sidoqoftë, zyrtarët në pozicionet e vendimmarrjes kanë tendencë të mos angazhojnë shumë ZBGj-të në planifikimin dhe ekzekutimin e përgjigjes së qeverisë COVID-19. Për më tepër, intervistat sugjeruan që ZBGj-të kishin mungesë njohurish dhe informacioni në lidhje me proceset buxhetore dhe për këtë arsye u përballën me vështirësi për të siguruar që këto procese të përfshinin një perspektivë gjinore.

Megjithëse ishte shumë herët për të vlerësuar ndikimin përmes këtij studimi, sipas dimensionit 8.1 të SHPPF MPGJFP, vlerësimi i ndikimeve gjinore të ofrimit të shërbimeve është i rëndësishëm. Sipas Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), një Vlerësim i Ndikimit Gjinor ex ante mund të mbështesë qeverinë dhe institucionet e saj për të kuptuar më mirë shkallën në të cilën buxheti ka arritur rezultatet e synuara, si përfshirja dhe barazia gjinore. Një informacion i tillë mund të mbështesë qeverinë në vlerësimin dhe planifikimin e masave të mëtejshme për përgjigjen e saj afatmesme dhe afatgjatë ndaj COVID-19. Vlerësimi i shpenzimeve është një hap vendimtar në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Prandaj, kryerja e vlerësimeve dhe vlerësimeve pas ndikimit gjinor që marrin parasysh se si këto masa mund të kenë ndikuar ndryshe tek gratë dhe burrat, do të jetë e rëndësishme në të ardhmen. ane officersNdërkohë, RrGK u kërkoi të anketuarve nga sondazhi online i OshC-ve perceptimet e tyre të përgjithshme nëse masat qeveritare për të adresuar COVID-19 kishin kontribuar në barazinë gjinore deri më tani. Megjithëse nuk janë statistikiisht përfaqësuese, përgjigjet e tyre janë cilësisht interesante në lidhje me përshtypjet e tyre fillestare. Shumica e të anketuarve të OSHC-ve menduan se përgjigjja e qeverisë ndaj COVID-19 nuk ka kontribuar në barazinë gjinore (55%) ose se kontribuoi disi (29%). Asnjë nga të anketuarit nuk tha se përgjigjja e qeverisë kishte kontribuar “shumë” në barazinë gjinore.

Sa i përket një vlerësimi të mëtejshëm cilësor të ndikimit, çështjet kryesore me të cilat gratë duket se janë përballur gjatë pandemisë kanë përfshirë qasjen e dobët në kujdesin shëndetësor, papunësinë, paqëndrueshmërinë financiare, shkeljet e të drejtave në ekonominë informale dhe përgjegjësitë e shtuara të kujdesit me humbjen e vendeve të punës të lidhura. Ndërsa masat e diskutuara më parë mund të kenë lehtësuar disa nga vështirësitë me të cilat përballen gratë, ato nuk kanë adresuar çështje që lidhen me qasjen në kujdesin shëndetësor, ekonominë informale, shkeljet e të drejtave të punës, përgjegjësitë e kujdesit ose ndikimet afatgjata të humbjes së punës dhe papunësisë. Duke pasur parasysh pabarazitë ekzistuese gjinore, subvencionet në bujqësi nuk kanë adresuar vështirësitë e shtuara me të cilat janë ballafaquar gratë fermere, siç janë shitja e produkteve të tyre. Përveç tri masave të vogla të udhëhequra nga Agjencia për Barazi Gjinore për mbështetjen e qendrave të kujdesit për fëmijët dhe strehimit të përkohshëm për personat që përjetojnë dhunë në Prishtinë, dhe këshillimit telefonik, asnjë masë tjetër qeveritare nuk ka adresuar qartë nevojat e grave ose OshC-ve në pararojë të përpjekjeve emergjente.

Çështjet kryesore me të cilat përballen burrat kanë përfshirë pushimet nga puna dhe papunësinë

që rezultoi në paqëndrueshmëri financiare, si dhe stresin. Duke pasur parasysh normat e lartpërmendura gjinore, fakti që burrat priren të jenë kryefamiljarë (duke marrë ndihmë sociale), të punësuar në nivele më të larta se gratë dhe duke pasur më shumë biznese sesa gratë, mund të përfundojmë se masat qeveritare kanë të ngjarë të adresojnë disa nga nevojat e burrave. Stresi dhe çështjet e shëndetit mendor janë adresuar disi nga linja e ndihmës e Ministrisë së Shëndetësisë që ofron këshillim. Nevojiten analiza të mëtejshme të ndikimit për të përcaktuar ndikimin e masave tek burrat.

Prej një perspektive të ndërthurjes, vështirësitë e shtuara me të cilat përballen njerëzit me nevoja të ndryshme aftësisht, veçanërisht gratë që përballen me sfida të shtuara për shkak të pabarazive gjinore, u adresuan në mënyrë të pamjaftueshme nga masat qeveritare. Personat me aftësi të ndryshme kishin nevojë për më shumë mbështetje sesa morën, duke përfshirë qasjen në kujdesin shëndetësor, mbështetjen financiare dhe ilaçet. Distancimi shoqëror pengonte lëvizjen e tyre, veçanërisht pasi shumë persona me aftësi të ndryshme kanë nevojë për dikë që t'i shoqërojë ata. Për shembull, personat e verbër raportuan se përballen me sfida të shtuara për të hyrë në ndihmë për shkak të ndërprerjes së transportit publik. Vendimi për të caktuar kohë të veçanta për lëvizje, bazuar në Kartat e Identifikimit, e bëri të vështirë lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara; vendimi nuk përmendi që ata do të mund të shoqëroheshin nga një shoqërues me një numër tjetër identifikimi. As qeveria për të informuar publikun në lidhje me masat nuk merrte parasysh nevojat e tyre unike. Për shembull, qeveria nuk siguroi broshura me informacion në lidhje me COVID-19 dhe masat për ta adresuar atë në alfabetin e Braille. Kur filloi mësimi në internet, asnjë program duket se nuk ka adresuar nevojat e fëmijëve me aftësi të ndryshme. Për më tepër, prindërit e tyre, veçanërisht nënat, u përballën me sfida të shtuara të kujdesit, të tilla si detyrimi për të mbështetur arsimimin e fëmijëve të tyre. Ndërsa janë të rëndësishme si për vajzat ashtu edhe për djemtë, duke pasur parasysh që vajzat me nevoja të veçanta historikisht janë përballur me sfida të shtuara në arsim, kjo mund të ketë nënkuptuar sfida shtesë për to. Duke pasur parasysh pozicionin e tyre përgjithësisht më të prekshëm në shoqëri, gratë rurale, gratë etnike të pakicave, nënat beqare dhe çiftet e gjinisë së njëjtë mund të përballen me diskriminim në marrjen e masave, megjithëse kishte informacion të pamjaftueshëm për ta vlerësuar këtë.

Përfundimi

Fakti që pak institucione mbledhin dhe mbajnë të dhëna të ndara sipas gjinisë e bëri të vështirë për të analizuar se si pandemia mund të ketë ndikuar ndryshe tek gratë dhe burrat. Të dhënat për gjininë dhe përkatësinë etnike, moshën, aftësinë dhe / ose vendndodhjen ishin edhe më të pakta. Qartasi, pandemia COVID-19 ka prekur si gratë ashtu edhe burrat. Megjithatë, gratë dhe burrat kanë përjetuar vështirësi ndryshe. Rreziku i kontraktimit të virusit duket të jetë më i lartë për gratë, duke qenë se ato janë të mbipërfaqësuar në profesionet me rrezikun më të lartë të kontraktimit COVID-19. Sidoqoftë, sipas të dhënave zyrtare, më shumë burra sesa gra kanë kontraktuar dhe / ose kanë vdekur nga COVID-19. Të dy gjinitë, burrat dhe gratë janë përballur me vështirësi ekonomike si rezultat i pushimeve nga puna dhe papunësisë. Sidoqoftë, normat ekzistuese shoqërore dhe marrëdhëniet e pushtetit pa dyshim i kanë vendosur gratë në një pozitë veçanërisht të pasigurt ekonomike mes COVID-19. Duke pasur parasysh rolet tradicionale gjinore, përgjegjësitë e kujdesit kanë bërë që gratë janë më të rrezikuara nga humbja e punës dhe varfërisë, veçanërisht nënat e vetme dhe gratë që kujdesen për persona me aftësi të ndryshme. Kufizimet në lëvizje gjithashtu kanë të ngjarë të kenë kontribuar në

qasjen më të dobët në kujdesin shëndetësor, veçanërisht për gratë që kanë pasur më pak qasje në transport dhe shërbime shëndetësore. Kufizimet në lëvizje gjithashtu kanë të ngjarë të kenë kontribuar në qasjen më të dobët në kujdesin shëndetësor, veçanërisht për gratë që kanë pasur më pak qasje në transport dhe shërbime shëndetësore. Gratë dhe fëmijët gjithashtu kanë qenë në rrezik më të madh të dhunës në familje gjatë pandemisë për shkak të një numri faktorësh të përzier që rrjedhin nga izolimi i imponuar dhe i nevojshëm për të parandaluar përhapjen e virusit. Organizatat e të drejtave të grave kanë qenë në ballë të adresimit të çështjeve thelbësore që dalin nga COVID-19 dhe në mbrojtjen e të drejtave të grave, por atyre u mungon burimi i mjaftueshëm dhe i qëndrueshëm.

Ligji për Barazi Gjinore detyron të gjitha institucionet të kryejnë analiza gjinore, të ndërmarrin buxhetim të përgjegjshëm gjinor, të mbajnë të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe të promovojnë barazinë gjinore, përfshirë përmes masave afirmative. Gjetjet sugjerojnë se kjo nuk është zbatuar në përgjigjen e qeverisë ndaj COVID-19. Zyrtarët kanë tendencë të mos kenë njohuri dhe të kuptojnë këto dispozita ligjore, me integrimin gjinor, ose rëndësinë e tij në adresimin e pandemisë COVID-19. Në përgjithësi, zyrtarët kishin tendencë të ndjenin se masat qeveritare kërkonin të ndihmonin të gjithë qytetarët dhe bizneset në mënyrë të barabartë. Prandaj, ata thanë se nuk shihnin ndonjë arsye për vlerësimin e ndikimit që masat do të kishin ose kishin për gratë dhe burrat. ZBGj-të ekzistojnë në të gjitha institucionet, por ato nuk janë përfshirë shumë në planifikimin dhe ekzekutimin e përgjigjes COVID-19. Ndërsa zyrtarëve të financave u mungonin kapacitetet për planifikim dhe buxhetim të përgjegjshëm ndaj gjinisë, ZBGj-të kishin tendencë të mos kishin njohuri për proceset buxhetore. Si rezultat, të dy përballen me vështirësi për të siguruar që masat të përmbajnë një perspektivë gjinore.

Meqenëse asnjë nga dokumentet e buxhetit ose masat qeveritare të rëndësishme për adresimin e pandemisë nuk u informuan nga analiza gjinore, përveç një, ato nuk përmbajnë një perspektivë gjinore. Ata nuk morën parasysh normat e ndryshme gjinore, rolet, marrëdhëniet, mundësitë, qasjen në burime dhe nevojat e grave dhe burrave të ndryshëm. As masat qeveritare nuk morën parasysh nevojat ndërsektoriale, të tilla si për gratë dhe burrat me etni të ndryshme, aftësia, moshën, vendndodhje gjeografike dhe / ose dobësi të tjera të mundshme të shtuara.

Kështu, dhe pjesërisht si rezultat i analizës së pamjaftueshme gjinore, përgjigjja e qeverisë ndaj COVID-19 ka të ngjarë të përforcojë pabarazitë gjinore para-ekzistuese në shoqëri sesa t'i transformojë ato. Fakti që planet e rimëkëmbjes shpërndajnë shumicën dërrmuese të burimeve për bizneset, pa financuar mjaftueshëm infrastrukturën sociale që do të përfitojë qytetarë të ndryshëm, do të thotë që masat do të vazhdojnë të mbështesin pabarazitë ekzistuese strukturore brenda shoqërisë. Megjithatë pandemia ka ilustruar qartë nevojën e funksionimit të arsimit, kujdesit dhe shërbimeve sociale, veçanërisht për të mbijetuarit e dhunës, planet e rimëkëmbjes nuk investojnë burime të mjaftueshme në forcimin e këtyre fondacioneve sociale, thelbësore për çdo rimëkëmbje ekonomike.

Në përgjithësi, ky studim u përpoq të vlerësonte nëse masat qeveritare kontribuan në barazinë gjinore. Institucionet nuk kanë zbatuar detyrimin e tyre ligjor për të mbledhur dhe raportuar të dhëna të ndara sipas gjinisë në lidhje me përfituesit. Si rezultat, ka shumë pak të dhëna të disponueshme në lidhje me gjininë, moshën, etninë, orientimin seksual, vendndodhjen gjeografike dhe aftësinë e personave të ndihmuar nga masat qeveritare. Mungesa e të dhënave, e shoqëruar me faktin se është akoma mjaft herët, e bën të vështirë vlerësimin e ndikimit të masave në gra, burra të ndryshëm dhe në barazinë gjinore.

Si përmbledhje, lidhur me dimensionet e SHPPF MPGJFP, Kosova kishte një qarkore buxhetore të përgjegjshme gjinore (3.1.), Por analiza e ndikimit gjinor e propozimeve të politikës së shpenzimeve (1.1.), Dokumentacioni i propozuar i buxhetit të përgjegjshëm gjinor (4.1.), Planet e performancës të

ndara sipas gjinisë (5.1.) Dhe arritjet (5.2.) Për ofrimin e shërbimeve dhe ndjekja e shpenzimeve të buxhetit për barazinë gjinore (6.1.) Mungonin. Ishte shumë herët për të vlerësuar ndikimet gjinore të ofrimit të shërbimeve (8.1.).



“Tregu i lirë nuk ekziston. Çdo treg ka disa rregulla dhe kufij që kufizojnë lirinë e zgjedhjes. Një treg duket i lirë vetëm sepse ne i pranojmë në mënyrë të pakushtëzuar kufizimet e tij themelore, saqë nuk arrijmë t'i shohim ato. Se sa i “lirë” është tregu, kjo mund të përkufizohet objektivisht. Është përkufizim politik. Pretendimi i zakonshëm nga ekonomistët e tregut të lirë se ata po përpiqen të mbrojnë tregun nga ndërhyrjet e motivuara politikisht nga qeveria, është i rremë. Qeveria është gjithnjë e përfshirë dhe ata që bëjnë tregtinë e lirë janë të motivuar politikisht si çdokush tjetër. Tejkalimi i mitit se ekziston një gjë e tillë si “tregu i lirë” i definuar objektivisht është hapi i parë drejt kuptimit të kapitalizmit.”

— Ha-Joon Chang “23 gjëra që nuk ju tregojnë për kapitalizmin”

PERSPEKTIVA EKONOMISTE FEMINISTE MBI MASAT PËR ADRESIMIN E COVID-19

Në këtë kapitull diskutohet modeli aktual ekonomik dhe modelet e tjera të mundshme ekonomike që mund të përdoren për të informuar zgjidhje të barabarta gjinore për t'u rikuperuar nga pandemia e COVID-19. Së pari, konceptet neoklasike të “tregut të lirë”, “dorës së padukshme” dhe *homo economicus* shqyrtohen dhe zërthehen nga perspektiva e ekonomisë feministe dhe heterodokse. Kjo pjesë diskuton mitet e qasjes *laissez faire* dhe ekonominë “trickle down”, dhe si këto qasje mbështesin paaftësinë e sistemit aktual ekonomik për të përballuar me krizat shëndetësore, ekonomike, sociale dhe mjedisore, përfshirë krizën aktuale që lidhet me COVID-19. Pastaj, seksioni tjetër përfshinë pjesë të nxjerra nga ekonomia dhe idetë feministe për të propozuar ide shtesë dhe alternative për rimëkëmbjen ekonomike të Kosovës.

Rishikim i teorisë ekonomike neoklasike dhe i alternativave të propozuara

Sipas teorisë ekonomike neoklasike, interesi i ndjekur individual çon dhe i shërben shpërndarjes optimale të burimeve përmes asaj që Adam Smith e përshkroi si “dorë e padukshme” në tregje. “Tregu i lirë” është vendi ku mallrat dhe shërbimet shkëmbehen mes konsumatorëve, të cilët ndjekin interesin e tyre personal, dhe kompanive konkurruese, të cilat përpiqen të maksimizojnë fitimet e tyre, pa ndërhyrjen e

rregullimit të qeverisë.¹⁵² Ekonomistet feministe dhe të tjerë heterodoksë kanë kritikuar supozimet dhe vlerat e teorisë neoklasike,¹⁵³ veçanërisht supozimin e njeriut ekonomik racional (*homo economicus*).¹⁵⁴ Ekonomistet feministe konsiderojnë se supozime të tilla nuk marrin parasysh njerëzit që varen nga të tjerët për të funksionuar në shoqëri.¹⁵⁵ Mundësia e një modeli të një njeriu ekonomik të vetëmjaftueshëm që merr vendime për të maksimizuar interesat e tij, duke iu përgjigjur vetëm çmimeve të tregut, mund të ekzistojë vetëm nëse dikush injoron punën e papaguar që mbështet riprodhimin e përditshëm. Duke pasur parasysh normat dhe marrëdhëniet gjinore të atribuara shoqërisht, tradicionalisht gratë kanë kryer këto role të papaguara të kujdesit riprodhues që kanë qenë të padukshme brenda sistemit ekonomik tradicional neoklasik, por jetik për vetë funksionimin e tij. Sipas OXFAM, vlera monetare e punës së papaguar të kujdesit të bërë nga gratë arrin në të paktën 13.8 trilionë dollarë çdo vit, globalisht.¹⁵⁶

Ndërkohë, qasja *laissez faire* (nga frëngjishtja, politika “le të jetë”), pjesë kryesore e ekonomisë së tregut të lirë, sugjeron që nga më pak rregullime qeveritare të bizneseve do të përfitojë shoqëria si tërësi. Megjithatë, dëshmitë kanë treguar që kompanitë dhe ndërmarrjet e mëdha ‘të mbetura për t’u kujdesur për veten e tyre’, pa rregullim qeveritar, nuk sigurojnë domosdoshmërisht mirëqenien e punëtorëve të tyre, shoqërisë dhe mjedisit; dëshmitë sugjerojnë se ata me më shumë fitime dhe kapital nuk e lënë atë domosdoshmërisht të “derdhet” për të përfituar të tjerët, sipas supozimit të ekonomisë neoklasike “*pikon poshtë [trickle down]*”.¹⁵⁷ Dëshmitë në rritje ilustrojnë që sistemi aktual ekonomik përqendrohet në aktivitetet e tregut “të lirë” dhe maksimizimi i fitimeve ka neglizhuar asimetritë e fuqisë dhe ka zgjeruar pabarazitë, në vend që t’i pakësojë ato.¹⁵⁸ Në të gjithë botën, pandemia ka bërë që sektori privat, duke përfshirë kompanitë që veprojnë në ekonominë informale, të zvogëlojë fuqinë e tij të punës dhe të mbyllë kompani, ndërsa disa korporata bëjnë fitime të mëdha dhe paguajnë pak tatime.¹⁵⁹ Si rezultat i kësaj, sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), vetëm muaji i parë i krizës ka kontribuar në një ulje të përafërt të të ardhurave mes punëtorëve informale deri në 60% në të gjithë botën.¹⁶⁰

Pandemia COVID-19 ekspozoi mangësitë e sistemit aktual ekonomik, i cili mbështeste supozimet teorike të lartpërmendura. Pandemia i ka bërë të dukshme të gjithë kujdesin dhe punën riprodhuese të papaguar dhe të paguar dobët e të fshehura më parë, të cilat janë thelbësore për funksionimin e jetës, shoqërisë dhe ekonomisë.¹⁶¹ Pandemia COVID-19 vuri në pah faktin se përfitimet ekonomike nuk “*pikojnë poshtë*” që të përfitojnë të gjithë. Ajo ka ekspozuar mitin e “dorës së padukshme” dhe ka treguar rezultatet afatgjata të doktrinës *laissez-faire*, nga e cila qartazi nuk përfitojnë interesat e shumicës dërmuese të njerëzve, por përkundrazi përmbush interesat korporatave të fuqishme dhe të pasurve. Në fakt, sistemi aktual ekonomik nuk funksionon në kohërat e zakonshme, sepse çon në përqendrimin e pushtetit, pasurisë dhe të ardhurave në duart e pakicës. Pra, nuk është për t’u habitur që ky sistem

¹⁵² Smith, A., 1723-1790. Pasuria e Kombeve / Adam Smith; Hyrje nga Robert Reich; Redaktuar, me Shënime, Përmbledhje Marxhinale dhe Indeks të Zgjeruar nga Edwin Cannan. New York: Biblioteka Moderne, 2000.

¹⁵³ Ekonomia heterodoks i referohet teorisë ekonomike që ndryshon nga mendimi ekonomik ortodoks ose ekonomia neoklasike.

¹⁵⁴ Barker, D., “Ekonomistët, reformatorët socialë dhe profetët: një kritikë feministe e efikasitetit ekonomik”, *Feminist Economics*, 1 (3): 26-39, 1995; Nelson, J., “Feminism and Economy”, *Gazeta e Perspektivave Ekonomike*, 9 (2): 131-148, 1995; Barker, D., “Ekonomi neoklasike”, në Peterson, J. and Lewis, M. (eds) *The Elgar Companion to Feminist Economics*, Cheltenham: Edward Elgar: 570-577, 1999.

¹⁵⁵ Po, aty.

¹⁵⁶ OXFAM, *Koha për t’u kujdesur: Puna e kujdesit të papaguar dhe të nënpaguar dhe kriza globale e pabarazisë*, 2020.

¹⁵⁷ AWID, nga një ndihmë feministe në një rimëkëmbje ekonomike feministe globale.

¹⁵⁸ Po aty; AFRIKAN FEMINIZMI, Deklarata e Rimëkëmbjes Ekonomike Feministe Afrikane Post-COVID-19, 2020; YWCA Kanada, “Një Plan Feminist i Rimëkëmbjes Ekonomike për Kanada: Bërja e Ekonomisë të funksionojë për të gjithë”, 2020; WBG, “Krijimi i një ekonomie të kujdesshme: Një thirrje për veprim”, 2020.

¹⁵⁹ ILO, *Kriza COVID-19 dhe ekonomia informale*, 2020.

¹⁶⁰ ILO: “Ndërsa shkallëzohen humbjet e vendeve të punës, gati gjysma e fuqisë punëtore globale rrezikon të humbasë mjetet e jetesës”.

¹⁶¹ AWID, nga një ndihmë feministe në një rimëkëmbje ekonomike feministe globale.

nuk funksionin as në krizë, siç u tregua nga fakti që qeverive iu është dashur të ndërhyjnë edhe një herë për të mbështetur rikuperimin ekonomik nga kriza. “Dora e padukshme” ishte e padobishme në “riparimin” e tregut dhe nxjerrjes së vendeve nga recesionet ekonomike.

Në fakt, krizat nuk ndodhin në vakum. Përkundrazi, siç kanë argumentuar ekonomistët feministë dhe heterodoksë, krizat janë të pashmangshme në sistemin aktual ekonomik.¹⁶² Teoritë konvencionale ekonomike sugjerojnë që ulja e taksave për të pasurit stimulon investimet dhe hapjen e vendeve të punës nga të cilat do të përfitojnë shoqëria dhe ekonomia në planin afatgjatë. Megjithatë, pak prova mbështesin pretendime të tilla. Përkundrazi, ulja e tatimeve çon në fitime më të larta për të pasurit dhe në përqendrim të shtuar të pasurisë dhe të ardhurave.¹⁶³ Dëshmitë kanë treguar se ulja e taksave për të pasurit nuk përkthehet domosdoshmërisht në më shumë punësim, rritje në shpenzimet e konsumatorit, ose në më shumë të ardhura të qeverisë.¹⁶⁴

Në përgjithësi, kriza COVID-19 ka ilustruar se dekada të investimeve të dobëta në infrastrukturën sociale do të thotë që qeveritë në sistemin aktual ekonomik nuk janë në gjendje të ofrojnë madje, as shërbimet më themelore. Kjo përkeqësoi efektet në ekonomi, mes mbylljeve të detyruara, duke treguar kështu që modeli aktual ekonomik dominues po dështon qartazi, sidomos në kohën e krizës. Kjo krizë shëndetësore dhe ekonomike ka ekspozuar asimetritë e fuqisë midis grupeve të ndryshme shoqërore që janë shtresuar me kalimin e kohës nga padrejtësia ekonomike dhe strukturat patriarkale dhe ka përkeqësuar më tej pozicionin e grupeve të cenueshme.¹⁶⁵

Ndërkohë, dëshmitë tregojnë se investimet në barazinë gjinore, dhe barazinë në përgjithësi, promovojnë zhvillimin e prosperuar ekonomik, duke përfshirë rritjen më të barabartë gjinore ekonomike, krijimin e vendeve të punës dhe mirëqenien.¹⁶⁶ Studimi empirik i shtatë vendeve të OBZHE që krahason investimin e 2% të Bruto Produktit Vendor (BPV) në ndërtimtari kundrejt kujdesit, tregon se më shumë vende pune do të krijoheshin nëse qeveritë investojnë në kujdes; rrjedhimisht, shkalla e punësimit të grave do të rritet “nga 3.3 në 8.2 pikë përqindje (dhe nga 1.4 në 4.0 pikë përqindje për burrat)”; për më tepër, hendeku gjinor në punësim do të bjerë l 67. Vetëm gjysma e kaq vendeve të punës do të krijoheshin me të njëjtin nivel investimi në ndërtim dhe kjo do ta rriste hendekun gjinor në punësim. l 68 Prandaj, financimi për infrastrukturën sociale dhe rifokusimi i politikës fiskale për të rritur investimet në këta sektorë do të ishte një mënyrë e vetë-qëndrueshme për rimëkëmbjen ekonomike, meqenëse do të krijoheshin asete të identifikueshme në të ardhmen që do të financonin veten dhe përmirësonin potencialin për rritje të barabartë gjinore ekonomike. l 69 Kjo rritje ekonomike e barabartë gjinore do të çonte në krijimin e hapësirës fiskale, rritjen e të ardhurave nga taksat, deficite më të ulëta dhe ulje të borxheve publike, pra një mënyrë solide për të kapërcyer recesionin. l 70 Për më tepër, investimi në kujdes është i qëndrueshëm pasi “industria e kujdesit është një industri relativisht e gjelbër”, pasi investimet në këtë sektor janë provuar më pak ndotëse për vendet e punës të krijuara nga

¹⁶² Grupi i Buxhetit të Grave, “Krijimi i një ekonomie të kujdesshme: Një thirrje për veprim”, 2020.

¹⁶³ Piketty, T. Kapitali në shekulli 21, Cambridge: Harvard University Press, 2014.

¹⁶⁴ Grown, C. “Taksimi dhe barazia gjinore: Një kornizë konceptuale”, 2010.

¹⁶⁵ AWID, nga një ndihmë feministe në një rimëkëmbje ekonomike feministe globale

¹⁶⁶ De Henau, J., Himmelweit, S., Stimulimi i ekonomive të OECD pas Covid duke investuar në kujdes, Dokumenti i Punës i Universitetit të Hapur IKD, 2020; EIGE, Përfitimet Ekonomike të Barazisë Gjinore në Bashkimin Evropian. Ndikimet e përgjithshme ekonomike të barazisë gjinore, 2017a; EIGE, Përfitimet Ekonomike të Barazisë Gjinore në Bashkimin Evropian. Raporti mbi zbatimin empirik të modelit, 2017b; Elson, D. Plani F: Plani feminist për një ekonomi të kujdesshme dhe të qëndrueshme, 2016; Bargawi, H., Cozzi, G., Krijimi i Rimëkëmbjes Ekonomike: Alternativat e Modelimit të Shtërngimit në Evropë, 2017

¹⁶⁷ De Henau J, Himmelweit S, Łapniewska Z, Perrons D. Investimi në ekonominë e kujdesit: një analizë gjinore e stimullit të punësimit në shtatë vende të OECD, Bruksel: Konfederata Ndërkombëtare e Sindikatave, f.6, 2016, f. 6.

¹⁶⁸ Po, aty.

¹⁶⁹ Seguino, S. “Mjetet e politikës makroekonomike për të financuar barazinë gjinore”, Rishikimi i Politikave të Zhvillimit, 37: 504–525, 2019, <https://doi.org/10.1111/dpr.12396>.

¹⁷⁰ WBG, Krijimi i një ekonomie të kujdesshme: Një thirrje për veprim, 2020.

tre herë në krahasim me vendet e krijuara nga investimet në sektorin e ndërtimit¹⁷¹. Në të kundërt, nëse qeveria fut ulje të tatimeve për të pasurit, kjo do të nënkuptojë ulje të të ardhurave të shtetit dhe kësaj më pak shpenzime publike për infrastrukturën thelbësore sociale që mundëson funksionimin e ekonomisë, siç janë sistemet shëndetësore publike dhe mbrojtja sociale¹⁷². Në këtë mënyrë, politikat e rishpërndarjes përmes sistemeve progresive të tatimeve mund të jenë formë alternative e të ardhurave të qeverisë për rimëkëmbje më të barabartë gjinore dhe të qëndrueshme ekonomike, duke marrë parasysh bizneset lokale dhe të vogla.

Si do të mund të dukej reagimi i ekonomisë feministe ndaj COVID-19 në Kosovë?

Kjo pjesë shqyrton se si mund të duket përgjigja ndaj COVID-19 në Kosovë, duke u bazuar në teorinë ekonomike feministe dhe heterodokse dhe diskutimin në seksionin paraprak. Së pari, një përgjigje e tillë mund të marrë parasysh diskriminimin aktual strukturor që dobëson si ekonominë ashtu edhe mirëqenien e qytetarëve, veçanërisht mirëqenien e grave. Disa çështje strukturore para-ekzistuese po i minojnë përpjekjet qeveritare për rimëkëmbje.

Për shembull, diskriminimi strukturor që rrjedh nga dispozitat e Ligjit të Punës të Kosovës për pushimet e lehonisë, i bën punëdhënësit të diskriminojnë gratë gjatë punësimit, sepse nuk dëshirojnë të paguajnë përfitimet e pushimit të lehonisë.¹⁷³ Miratimi i një ligji të ri të punës në përputhje me direktivën e BE-së për Ekuilibrin e Punës dhe Jetës Private mund të adresojë këtë diskriminim strukturor duke siguruar të drejta dhe mundësi të barabarta për nënat dhe baballarët për të marrë pushim me pagesë për t'u kujdesur për fëmijët e tyre. Jo vetëm që kjo do të jepte më shumë baballarëve të drejta të barabarta shoqërore brenda familjeve të tyre, siç përcaktohet në Ligjin për Barazinë Gjinore, por kjo do të parandalonte punëdhënësit nga diskriminimi ndaj grave gjatë punësimit, pasi burrat do të kishin të njëjtat të drejta të barabarta për pushim. Një ndryshim i tillë strukturor do të mundësonte pjesëmarrje më të ekuilibruar të grave dhe burrave në jetën shoqërore, publike dhe ekonomike.¹⁷⁴ Kjo është edhe më e rëndësishme mes pandemisë dhe rimëkëmbjes ekonomike, në mënyrë që pabarazi të tilla strukturore të mos të minojnë rezultatet e planifikuara të punësimit.

Një çështje tjetër strukturore që kërkon adresimin e qeverisë, drejt zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies është mungesa e qendrave publike të përballueshme dhe të qasshme të kujdesit. Siç u diskutua në kapitujt paraprak, kjo çështje strukturore është ndër çështjet kryesore që minojnë pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore në Kosovë. Investimet në qendrat e kujdesit të siguruar nga Agjencia për Barazi Gjinore janë shembull pozitiv. Nevojitet më shumë përpjekje qeveritare. Dëshmitë e lartpërmendura në mbarë botën e veçanërisht në Kosovë, ilustrojnë se investimi në kujdes mund të krijojë mijëra vende të reja të punës, teksa ka përfitime të shtuara, duke transformuar punën aktualisht të papaguar dhe të panjohur në atë të paguar; të sigurojë mbrojtje më të mirë për këtë punë (p.sh., të drejtat e punëtorëve dhe pensionet); të mundësojë që më shumë gra të punojnë, duke pasur parasysh rolin e tyre tradicional të kujdesit, si sfidë kryesore për gratë që përfshihen në fuqinë punëtore në Kosovë; në këtë mënyrë, të rrisë të ardhurat nga tatimet nga nivelet e rritura të punësimit të grave; të përmirësojë rezultatet arsimore të fëmijëve përmes arsimit të hershëm; dhe të përdorë arsimin

¹⁷¹ Po, aty.

¹⁷² OXFAM, Koha për t'u kujdesur: Puna e kujdesit të papaguar dhe të nënpaguar dhe kriza globale e pabarazisë, 2020.

¹⁷³ RrGK, Krijimi i një Politike të Bilancit: Opsionet për Ndryshimin e Ligjit të Punës të Kosovës, 2016. Krijimi i një Bilanc

¹⁷⁴ Po, aty.

e hershëm për të transformuar rolet tradicionale gjinore drejt një shoqërie më të barabartë.¹⁷⁵ Në Kosovë, vendosja e kujdesit ndaj fëmijëve në përputhje me Objektivat e BE-së është vlerësuar të kontribuojë në 9,989 vende të reja pune si mësimdhënëse, 50,6 milion euro në të ardhura të reja dhe 2 milion euro në tatime mbi të ardhurat e paguara në vit.¹⁷⁶ Ndikimet e përbëra pozitive mund të jenë edhe më të mëdha, duke marrë parasysh që gratë të cilat janë aktualisht në shtëpi dhe ofrojnë kujdes do të ishin në gjendje të përfshiheshin në fuqinë punëtore. Investimi në kujdesin ndaj fëmijëve me aftësi të ndryshme dhe të moshuarve mund të kontribuojë në vende të reja pune si shtesë. Siç u përmend në seksionin e fundit, hulumtimi ka treguar se investimi në kujdesin dhe infrastrukturën sociale mund të krijojë shumë vende të reja pune krahasuar me investimin në infrastrukturë fizike dhe ka efekte të forta të rritjes ekonomike; investime të tilla janë veçanërisht të rëndësishme në kohë krize, pasi ato mund të nxisin punësimin dhe rimëkëmbjen ekonomike.¹⁷⁷

Ndryshe nga korporatat më të mëdha që grumbullojnë pasuri brenda sistemit aktual ekonomik, bizneset lokale dhe të vogla përpiqen të mbijetojnë. Edhe pse, bizneset e vogla lokale mund të nënkuptojnë shpërndarje më të drejtë të pasurisë mes njerëzve, modeli aktual ekonomik i vë në rrezik këto zgjidhje ekonomike më të qëndrueshme dhe të lokalizuara.¹⁷⁸ Në Kosovë, qeveria ka ndërmarrë disa hapa për të mbështetur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Kjo mund të jetë e rëndësishme për mbështetjen e bizneseve të lokalizuara. Planet e rimëkëmbjes që njohin dhe investojnë në solidaritetet alternative, komuniteti ose ekonomitë aktuale informale mund të kontribuojnë në ekonomi të qëndrueshme, të lokalizuara me përfitime të qëndrueshme.¹⁷⁹ Duke pasur parasysh nën-përfaqësimin aktual të grave si pronare të bizneseve të vogla, nevojiten masa afirmative, në përputhje me Ligjin për Barazinë Gjinore, në kriteret dhe procedurat e prokurimit në mënyrë që të sigurohet që gratë të kenë qasje në këto përfitime. Grantet e fundit të MTI-së për bizneset në pronësi të grave janë një shembull i praktikës së mirë.

Një çështje tjetër strukturore është alokimi i pamjaftueshëm i buxhetit për punësimin e mjaft inspektorëve të punës dhe mungesa e trajnimit për inspektimet e punës sa i përket diskriminimit me bazë gjinore, gjë që krijon kushte të këqija të punës dhe mbrojtje të pamjaftueshme të të drejtave të punëtorëve.¹⁸⁰ Hulumtimi i RrGK-së ka treguar se “diskriminimi me bazë gjinore është i përhapur në rekrutimin, ngritjen në detyrë, pagën, kohëzgjatjen e kontratës, pushimin e lehonisë dhe ngacmimin seksual në punë”, dhe kjo mund të ndalonte gratë të përfshihen në fuqinë punëtore.¹⁸¹ Prandaj, diskriminimi me bazë gjinore, i shoqëruar me shkelle të të drejtave të punës mund të minojë përpjekjet për të rritur punësimin. Në ndërkohë, inspeksione të përmirësuara mund të sjellin të hyra shtesë përmes venies së gjobave bizneseve që dështojnë të përmbushin standardet e të drejtave të punëtorëve.

Rishikimi i sistemit tatimor të Kosovës nga perspektiva gjinore mund të prodhojë ide të mëtejshme për një rikuperim më të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm. Dëshmitë e lartpërmendura nga pjesë të tjera të botës sugjerojnë që duhet të shmangen lehtësimet tatimore për kompanitë e mëdha. Përkundrazi, bizneset e mëdha dhe të pasurit duhet të taten kah shpërndarja më e barabartë të burimeve, pasi këto të ardhura mund të mbështesin përmirësimin e shërbimeve sociale, të tilla si

¹⁷⁵ Për Kosovën, shih RrGK, *Kush kujdeset? Kërkesa, furnizimi dhe opsionet për zgjerimin e disponueshmërisë së kujdesit për fëmijë në Kosovë*, Prishtinë: RrGK, 2016.

¹⁷⁶ Po, aty.

¹⁷⁷ De Henau, J., Himmelweit, S., Stimulimi i ekonomive të OECD pas Covid duke investuar në kujdes, Dokumenti i Punës i Universitetit të Hapur IKD, 2020; EIGE, *Përfitimet Ekonomike të Barazisë Gjinore në Bashkimin Evropian*. Ndikimet e përgjithshme ekonomike të barazisë gjinore, 2017a; EIGE, *Përfitimet Ekonomike të Barazisë Gjinore në Bashkimin Evropian*. Raporti mbi zbatimin empirik të modelit, 2017b.

¹⁷⁸ Liodakis, G., *Ekonomia Politike, Kapitalizmi dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm*, 2010.

¹⁷⁹ Po aty; dhe AWID, nga një ndihmë feministe në një rimëkëmbje ekonomike feministe globale.

¹⁸⁰ RrGK, *Diskriminimi me bazë Gjinore në Punë në Kosovë*, 2019.

¹⁸¹ Po, aty.

kujdesi shëndetësor dhe arsimit. Ndërkohë, një sistem tatimor progresiv, në vend të tatimit aktual i të ardhurave të korporatave të Kosovës, do të mund të mbështeste shërbimet e përmirësuara sociale, duke tatuar korporatat më të pasura dhe të mëdha.¹⁸² Lirimi i punëtorëve, në veçanti të të varfërve, nga tatimi mbi të ardhurat mund të inkurajojë shpenzimet dhe të mundësojë qasje më të barabartë në mallrat themelore, veçanërisht për gratë që priren të blejnë mallra të tilla të nevojshme për familjet e tyre.

Gjithashtu ekzistojnë disa mundësi, në përputhje me parimin e “ndotësi paguan” mes reformave të mbrojtjes së mjedisit që lidhen me BE, ku qeveria mund të gjenerojë të ardhura të konsiderueshme nga ndotësit, duke mbrojtur njëkohësisht mjedisin në të cilin Kosova do të llogarisë në të ardhmen për mirëqenien e qytetarëve të saj. Deponimi i paligjshëm i mbeturinave, ndotja e ujit, ndotja e tokës dhe ndotja e ajrit mund të gjobiten rëndë, me qëllim të mbrojtjes së burimeve të kufizuara natyrore të Kosovës. Zbatimi i duhur i parimit të “ndotësi paguan” do të krijonte vende të reja pune për inspektorët shtesë të mjedisit. Shtimi i më shumë inspektorëve mund të gjenerojë të ardhura të konsiderueshme, që do të përdoren për programet shtetërore. Masat pohuese në punësimin e inspektorëve gjithashtu mund të kontribuojnë në avancimin e barazisë gjinore brenda këtij sektori.

Përfundimi

Dëshmitë sugjerojnë që sistemi aktual ekonomik nuk po sjell rezultate në mirëqenien e popullatës e përgjithshme. Modeli aktual, i vjetruar ekonomik nuk kap kompleksitetin e sjelljes njerëzore, nuk kujdeset për nevojat riprodhuese dhe ato të kujdesit, nuk mbron punëtorët ose siguron sistemet shëndetësore funksionale të nevojshme për të mbështetur një sistem ekonomik funksional. Dëshmitë sugjerojnë që investimi në rimëkëmbje ekonomike të qëndrueshme dhe të barabartë gjinore, përfshirë investimet në infrastrukturën dhe mbrojtjen sociale, mund të krijojë më shumë vende të reja pune dhe të përmirësojë mirëqenien për më shumë njerëz, përfshirë si për gratë ashtu dhe për burrat. Qeveria e Kosovës mund të mësojë nga ky hulumtim, duke ndërmarrë reforma strukturore në të drejtat e punës, inspektime, disponueshmërinë e kujdesit, mbrojtjen e mjedisit dhe duke mbështetur ekonomi të vogla, të lokalizuara. Dëshmitë në Kosovë dhe jashtë sugjerojnë që investime të tilla mund të kontribuojnë në vende të reja të punës, të ardhura, mirëqenie dhe barazi. Kapitulli tjetër përmban rekomandime specifike në këtë drejtim.

¹⁸² OXFAM, [Koha për t'u kujdesur: Puna e kujdesit të papaguar dhe të nënpaguar dhe kriza globale e pabarazisë](#), 2020.

REKOMANDIMET

Rekomandimet e mëposhtme janë nxjerrë nga gjetjet dhe analizat e hulumtimit të paraqitura në kapitujt e mëparshëm, praktikat më të mira të SHPPF, hulumtimi i gjerë dhe kërkime dhe prova në mbështetje të qasjes ekonomiste feministe në përpjekjet për t'u rikuperuar nga pandemia e COVID-19. Rekomandimet për qeverinë, Zyrën Kombëtare të Auditimit, komunat, Kuvendin e Kosovës, donatorët dhe shoqërinë civile përqipen të ofrojnë sugjerime konstruktive për një rimëkëmbje të qëndrueshme nga e cila do të përfitojnë gratë dhe burrat, si dhe do të avancohet barazia gjinore.

Për Qeverinë

- Të sigurohet që të dhënat e ndara sipas gjinisë për të gjithë përfituesit të mirëmbahen në lidhje me të gjitha programet në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore,¹⁸³ dhe që të dhëna të tilla të përdoren për të informuar planifikimin në lidhje me përfituesit e parashikuar të programeve të reja. Të përditësohen sistemet e menaxhimit të të dhënave për të përfshirë një tregues për gjininë, duke lehtësuar menaxhimin e të dhënave.
 - Veçanërisht për Agjencinë për Barazi Gjinore dhe Ministrinë e Financave, të finalizohet koncepti për institucionalizimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe të sigurohet që buxheti i përgjegjshëm gjinor të zbatohet nga të gjitha institucionet qeveritare në të gjitha fazat e planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit të buxhetit.
 - Të sigurohet *ex ante* që Vlerësimet e Ndikimit Gjinor të përdoren për të informuar planifikimin e të gjitha programeve dhe shpenzimeve, sipas praktikave më të mira në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe në përputhje me kërkesat e Vlerësimit të Ndikimit Rregullativ. Këto analiza duhet të informojnë objektiva, tregues dhe synime të qarta drejt barazisë gjinore, përfshirë mbështetjen e identifikimit të grupeve dhe përfituesve të synuar.
 - Të sigurohet që masat të adresojnë pabarazitë e ndërthurura, siç janë nevojat e grave me aftësi të ndryshme, etnicitet, dhe ato në vende rurale.
 - Të organizohen diskutime publike të reklamuar mirë, duke siguruar që gratë dhe burrat të marrin pjesë, në mënyrë që të diskutojnë masat e propozuara, të mbledhin kontributin e qytetarëve dhe të përfshijnë propozimet e tyre brenda masave, sipas rëndësisë. Të merret parasysh ndërveprimi në të gjitha nivelet e konsultimeve dhe vendimmarrjes.
 - Të angazhohet më shumë shoqëria civile, përfshirë OSHCG-të, në procesin e hartimit të masave për adresimin e COVID-19 në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.
 - Të rishikohet plani i rimëkëmbjes në mënyrë që të prioritetizohen investimet në infrastrukturën shoqërore, duke përfshirë kujdesin shëndetësor, edukimin, shërbimet e kujdesit, shërbimet sociale, në veçanti për personat që përjetojnë dhunë, si dhe ambient i sigurt. Investimi në këto fusha është thelbësor për themelimin e një baze të fortë për një ekonomi të barabartë dhe të qëndrueshme.¹⁸⁴ Këto rekomandime do të kontribuojnë në krijimin e mijëra vendeve të punës, kështu duke kontribuar në mirëqenien sociale afatgjatë dhe eventualisht të ndikojnë në krijimin e të ardhurave të reja shtetërore për shërbimet sociale në të ardhmen nga rritja e punësimit, rritja e të ardhurave nga rritja e taksës në të hyra për biznese të mëdha, dhe ulja e evazionit fiskal.

¹⁸³ Neni 5, paragrafi I.8.

¹⁸⁴ AWID, Nga një ndihmë feministe në një rimëkëmbje ekonomike feministe globale.

- Në veçanti, të investohet në ekonominë e kujdesit, e cila mund të krijojë mijëra vende të reja pune në Kosovë, të lejojë më shumë gra të punojnë për shkak të rritjes së disponueshmërisë së kujdesit, të përmirësojnë rezultatet arsimore të fëmijëve dhe të kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe rritjen e të ardhurave të shtetit.
- Të investohet në barazinë gjinore si pjesë e masave të rimëkëmbjes ekonomike, pasi hulumtimet ndërkombëtare kanë treguar se barazia gjinore e avancuar ka përfitime të konsiderueshme ekonomike.
- Të njihet dhe të kërkohet mbështetja e duhur për modele të ndryshme të ekonomisë, përveç ekonomisë së komunitetit, ekonomisë së solidaritetit dhe ekonomisë aktuale të informacionit, të panjohurës¹⁸⁵.
- Të alokohen burime për të adresuar diskriminim ekzistues struktural që shkelë të drejtat, minon krijimin e ekonomive të qëndrueshme dhe kontribuon në padrejtësi, duke përfshirë, të paktën:
 - Të ndryshohen rregullat e asistencës sociale për të siguruar përfitime për individët, e jo familjeve, duke siguruar kështu që të gjithë qytetarët të kenë qasje në përfitime pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike, aftësia, vendndodhja, orientimi seksual ose ndonjë karakteristikë tjetër që mund të pengojë qasjen e tyre të barabartë në përfitimet në kuadër të modelit aktual të kryefamiljarit burrë;
 - Të ndryshohet urgjentisht ligji i punës që të sigurojë mbështetjen e duhur shtetërore dhe të financojë një shpërndarje më të përshtatshme të pagesës për kujdes ndaj fëmijëve mes prindërve;
 - Të alokohen burime për rekrutim të më shumë inspektorëve dhe institucionalizim të trajnimeve mbi diskriminim në baza gjinore në vendin e punës për inspektorët e punës.
 - Të krijohen mekanizma mbrojtës ndaj korrupsionit brenda inspektorëve dhe të sigurohet aplikimi i ndëshkimeve me kohë ndaj bizneseve që shkelin të drejtat e punëtorëve, drejt rritjes së të ardhurave shtetërore që do të mund të financonin shërbime sociale.
 - Të kërkohet nga të gjitha vendet e punës të vendosin informacione mbi të drejtat e punëtorëve, duke përfshirë informacione mbi ngacmimin seksual në punë, të vendosin mekanizma të përmirësuara të ankimit dhe të sigurohen mekanizma mbrojtës ndaj viktimizimit të personave që raportojnë diskriminim dhe shkeljen e të drejtave; dhe
 - Të përshpejtohen përpjekjet për të fuqizuar të drejta të barabarta pronësore për gratë, drejt sigurimit të të drejtave themelore shtëpiake, duke i mbrojtur nga diskriminimi, dhuna dhe varfëria.
- Të alokohen burime për inspektime dhe vlerësime shpesh të rrezikut në proceset e prokurimit për të siguruar që çdo investim i shtetit në biznese të sigurojë që bizneset të sigurojnë kushte të mira pune. Kompanitë që përfitojnë nga subvencionet shtetërore duhet të plotësojnë standardet më të larta në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, duke përfshirë sigurimin e kontratave, pensioneve, pagave të drejta, pagës së barabartë për punën e barabartë, një histori të pagesave në kohë të taksave, politikave gjithëpërfshirëse kundër diskriminimit dhe ngacmimeve seksuale, funksionimin mekanizmat e ankesave për shkeljet e të drejtave të

¹⁸⁵ Po, aty.

- punës dhe informacione të qarta të postuara mirë për punëtorët në lidhje me të drejtat e tyre. Këto duhet të përfshihen në kriteret për subvencione, të kontrollohen dhe monitorohen nga afër nga inspektimet, me gjobat për dështimet e zbuluara për të zbatuar ligjet ekzistuese.
- Të sigurohet dhënia transparente dhe e drejtë e fondeve. Të vendosen masa mbrojtëse për të zbutur rreziqet e keqpërdorimit, të tilla si përdorimi i thirrjeve të hapura me kriteret të qarta përzgjedhjeje, vlerësues të pavarur dhe mekanizma funksionues të ankesave. Transparenca është veçanërisht e rëndësishme mes situatave emergjente si kjo pandemi, pasi procedurat e shpejtuara mund të lënë hapësirë për keqpërdorim të fondeve.
 - Të konsiderohen heqja e zbritjes së taksave për bizneset e mëdha, në kontekstin më të gjerë të sigurimit të të ardhurave për të mbështetur programe të rëndësishme shoqërore të shtetit.
 - Të rishikohet sistemi i tatimeve nga perspektiva gjinore për të identifikuar, bazuar në prova se cilat rishikime në sistemin e tatimeve mund të kontribuojnë në përmirësimin e të ardhurave për shërbimet sociale dhe uljen e tatimeve për më të cenuarit. Të konsiderohet vendosja e një sistemi progresiv të tatimeve në të hyra për bizneset.
 - Për rimëkëmbje afatgjatë ekonomike dhe investime të qëndrueshme në infrastrukturën sociale dhe mirëqenien e qytetarëve, të rritet alokimi i buxhetit për rekrutimin dhe trajnimin e inspektorëve të taksave, si dhe të vendosen mekanizma të përmirësuar për të parandaluar korrupsionin brenda inspektorëve. Rritja e kapaciteteve të inspektorëve është thelbësore për reduktimin e evazionit fiskal, veçanërisht nga kompanitë e mëdha, drejt rritjes së të ardhurave.
 - Për rimëkëmbje ekonomike afatgjatë, nevojitet shikimi nga perspektiva gjinore e politikave makroekonomike dhe planeve zhvillimore të Kosovës, duke pasur parasysh rekomandimet e dhëna më lartë. Rishikimi i investimeve aktuale substanciale nga buxheti i Kosovës në infrastrukturë për projektet e mëdha dhe shpenzimet ushtarake, ri-balancimi i buxhetit për të përfshirë investime në strukturën sociale nga të cilat do të përfitonim mirëqenie njerëzore, rritje ekonomike dhe të shkallës së punësimit dhe çështjet shqetësuese të ambientit të Kosovës.
 - Të gjitha shërbimet themelore shëndetësore duhet të jenë të qasshme dhe të përballueshme nga të gjithë, përfshirë shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues.
 - Përveç masës 6 mbi kujdesin shëndetësor për përfitime shtesë të pagës për dy muaj për punonjësit e kujdesit shëndetësor, të sigurohet mbështetje tjetër e nevojshme për sistemin e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë mbulimin e kostove shtesë që punonjësit e kujdesit shëndetësor kanë në lidhje me barrën e shtuar fizike dhe psikologjike; të caktohen më shumë fonde për të punësuar më shumë staf për të zvogëluar ngarkesën e punës, duke krijuar kësh-tu vende pune.
 - Të themelohet një linjë buxhetore e përhershme për financimin e shoqërisë civile, me mbështetje shumë-vjeçare, fleksibile, financime për organizatat për të drejtat e grave me gjurmë të bazuara mbi prova, ashtu që të vazhdojnë të shërbejnë në vijën e frontit, të mobilizohen shpejt në situata emergjente, të monitorohen shërbimet e dhura të përgjigjes dhe të mbrojnë të drejtat për të gjithë në nevojë
 - Në veçanti, të krijohet një linjë buxhetore e përhershme për të alokuar financim të përhershëm për strehimoret, duke u bazuar në kërkesat e Konventës së Stambollit, duke përfshirë shërbime rehabilituese dhe ri-integruese.
 - Të sigurohet alokimi i mjaftueshëm i kompensimit të shtetit ndaj shërbimeve të rikuperimit, përfshirë financimin për shërbimet shtëpiake, të kujdesit shëndetësor, trajnime avokuese,

mbështetje e vazhdueshme për edukim dhe punësim. Të mbështetet dhe fuqizohet mbështetja ndaj mekanizmave koordinues në nivel të komunave, drejt një përgjigjeje të përmirësuar kundrejt dhunës në familje dhe menaxhimit të këtyre rasteve. Urgjentisht të alokohen fonde për rekrutimin e më shumë punonjësve të shërbimeve sociale, të trajnohen në rast të menaxhimit të ndonjë situatë në ballafaqim me viktimën, si dhe të përgatiten plotësisht për të kryer detyrat e veta të rregulluara me ligj.

- Të investohet në parandalimin e dhunës me bazë gjinore, gjë që do t'i kursejë shtetit mijëra fonde të nevojshme për siguri, ndihmë sociale dhe programe të tjera për personat që vuajnë nga dhuna¹⁸⁶.
- Të alokohen burime për programe rehabilituese të bazuara në prova, për të parandaluar dhunën në të ardhmen.
- Të sigurohet ofrimi i informacionit për publikun e gjerë, veçanërisht për gratë, për mënyrën e qasjes në fonde, mbështetjen financiare dhe programet qeveritare.
- Të avancohet ndërgjegjësimi dhe kapacitetet e zyrtarëve të financave për të kuptuar se si Ligji për Barazi Gjinore mund të zbatohet në proceset e prokurimit, bazuar edhe në Ligjin për Prokurimin, veçanërisht përdorimi i masave afirmative drejt barazisë gjinore. Të merret parasysh përfshirja e kësaj në planet dhe programet e trajnimit të prokurimit të ofruara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike.
- Të avancohet ndërgjegjësimi dhe kapacitetet e zyrtarëve të financave për të kuptuar se si buxheti i përgjegjshëm gjinor. Të përfshihet kjo në programet e trajnimit të detyrueshëm për nënpunësit civilë, të siguruara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike duke përdorur programet ekzistuese dhe azhurnuar ato bazuar në çdo ndryshim në sistemin e menaxhimit të financave publike në lidhje me buxhetin e përgjegjshëm gjinor.
- Të përmirësohet bashkëpunimi midis zyrtarëve të financave dhe auditorëve në lidhje me mënyrën e pasqyrimit më të mirë të një perspektive gjinore në procesin e auditimit.
- Pas rekomandimeve të bëra nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut të Komisionerit të Lartë në "Udhëzuesin për CEDAW dhe COVID-19", të forcohet roli i "makinerisë së grave" gjatë krizës dhe rimëkëmbjes, përkatësisht Agjencia për Barazi Gjinore dhe ZBGj-ve në ministri dhe komuna. Në veçanti, të forcohet roli i tyre në kryerjen e vlerësimeve të ndikimit gjinor për të informuar masat qeveritare, burimet e tyre dhe kapacitetet për të përfshirë drejtpërdrejt planifikimin e buxhetit.
- Të kryhet vlerësimi ex-post i ndikimit gjinor të të gjitha masave të deritanishme që lidhen me COVID-19. Të vlerësohen ndikimet mbi përfituesit dhe barazinë gjinore, përfshirë perspektivën ndër-sektoriale, drejt informimit të masave të ardhshme. Të përfshihen ekspertë të pavarur gjinor dhe OSHCG, duke siguruar që rezultatet të diskutohen publikisht dhe kontribuojnë në ndryshimin e masave, aty ku identifikohet nevoja.

Për Zyrën Kombëtare të Auditimit

- Të sigurohet që auditimet në vitin 2020, përfshirë shpenzimet e COVID-19, të përfshijnë vëmendjen ndaj treguesve gjinorë në lidhje me vlerësimin e performancës, si dhe të përmbajnë një perspektivë gjinore.

¹⁸⁶ RrGK, Me çfarë kosto? Buxheti për Zbatimin e Kornizës Ligjore kundër Dhunës në Familje në Kosovë, 2012.

- Duke pasur parasysh fondet e konsiderueshme të alokuara për bizneset si pjesë e masave të rimëkëmbjes, të bëhet një hetim i veçantë mbi atë se si janë përdorur paratë dhe nëse ato me të vërtetë kanë kontribuar në rritjen ekonomike, vendet e reja të punës dhe mirëqenien njerëzore, përfshirë barazinë gjinore. Të sigurohet përfshirja e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe të dhënave të ndërthurura.

Për Komunitat

- Të sigurohet përfshirja e aneksit të kërkuar me të dhënat në lidhje me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor kur dorëzoni kërkesat vjetore të buxhetit, në përputhje me Ligjin për Barazinë Gjinore dhe qarkoret e buxhetit.
- Të sigurohet organizimi i dëgjimeve publike për buxhet, edhe në kohë krize. Të merret parasysh përdorimi i platformave në internet për këtë qëllim, përfshirë mediat sociale.
- Të konsultohen me ZBGj-të komunalë dhe OSHCG-të për të kuptuar se si t'i kontaktojmë më mirë gratë dhe t'i angazhojmë ato në këto procese; të angazhojmë ato në proceset buxhetore.
- Të sigurohet qasje në informacion për gratë dhe për burrat përkitazi me mundësitë në dispozicion, në mënyrë që të mund të aplikojnë për ndihmë.
- Të sigurohet trajnim i përmirësuar për të gjithë zyrtarët për të zgjeruar njohuritë dhe të kuptuarit e tyre të barazisë gjinore dhe posaçërisht se si të kryejnë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.
- Në nivelin komunal, të kryhet vlerësimi ex-post i ndikimit gjinor të masave për të kuptuar se si ato kanë arritur tek gratë dhe burrat e ndryshëm, si dhe kanë kontribuar në barazinë gjinore. Të diskutohen publikisht rezultatet dhe të përdoren ato për të identifikuar një qasje të përmirësuar.
- Të vazhdohet monitorimi i situatës nga perspektiva gjinore për të fituar njohuri në lidhje me nevojat e ndryshme të grave dhe burrave në mënyrë që ato të adresohen përmes mbështetjes së mëtejshme.

Për Kuvendin e Kosovës

- Të mbështetet dhe monitorohet zbatimi i rekomandimeve të lartpërmendura të bëra për qeverinë.
- Para miratimit të ligjeve të ardhshme lidhur me adresimin dhe rikuperimin nga COVID-19, të insistohet në një vlerësim më të plotë të Ndikimit Gjinor si pjesë e Vlerësimit të Ndikimit Rregullativ, duke marrë parasysh se si ligji i propozuar mund të ndikojë në mënyrë të ndryshme te gratë dhe burrat dhe duke përdorur këtë dhe ligje të tjera për të adresuar dhe jo për të përforcuar pabarazitë ekzistuese gjinore.
- Të sigurohet shqyrtimi legjislativ i përgjegjshëm gjinor i buxheteve dhe auditimeve. Të angazhohen ekspertë të pavarur dhe OSHCG me ekspertizë në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor për të mbështetur këtë punë.
- Të monitorohen shpenzimet në lidhje me COVID-19 nga një perspektivë gjinore dhe t'i kërkohet qeverisë llogaridhënie në zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore, duke përdorur buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e burimeve shtetërore.

Për BE-në dhe financuesit e tjerë

- Sipas PVGj II të BE-së, PVGj III të ri dhe politikave të Kosovës që rregullojnë Vlerësimet e Ndikimit Rregullativ që përfshijnë Vlerësimet e Ndikimit Gjinor, të sigurohet që të gjitha programet që adresojnë COVID-19 në periudha afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të janë të informuara përmes analizës gjinore, përfshirë edhe informatat e bazuar në konsultime me mekanizmat kombëtar të barazisë gjinore dhe OSHCG të ndryshme; të vazhdohet të sigurohet financimi i programeve të fokusuara në avancimin e barazisë gjinore.
- Në përputhje me ligjin e Kosovës dhe prioritetet e GAP III të BE-së, të kërkohet përdorimi i programit të përgjegjshëm gjinor në lidhje me të gjithë sektorët e mbështetur.
- Të sigurohet përfshirja e OSHCH të ndryshme në hartimin si dhe zbatimin e programeve, në bashkëpunim të ngushtë me përfituesit e qeverisë dhe kontraktorët që zbatojnë programe, sipas GAP II dhe GAP III.
- Të alokohen fonde shumëvjeçare dhe fleksibile për strukturën e shoqërisë civile për t'i mundësuar OSHC-ve monitorimin e shpenzimeve qeveritare për të adresuar COVID-19, avokimin për transparencën dhe llogaridhënien, dhe vlerësimet e ndikimit të këtyre fondeve të përfituesit e synuar, përfshirë perspektivën gjinore.

Për Organizatat e Shoqërisë Civile

- Të organizohen fushata sensibilizuese për të rritur njohuritë e grave dhe burrave mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në debate publike dhe dëgjime buxhetore; si dhe mbi mundësitë e ndihmës në dispozicion të tyre.
- Të monitorohet dhe vlerësohet reagimi i qeverisë për të informuar avokimin drejt përmirësimit të masave të Covid-19, përfshirë perspektivën gjinore.
- Veçanërisht për grupet e studimit dhe OSHC-të që nuk përqendrohen në çështjet e barazisë gjinore, të bashkëpunojnë më ngushtë me OSHCG për të përfshirë një perspektivë gjinore në monitorimin dhe raportet e tjera që lidhen me COVID-19.

PUNIMET E CITUARA

Agjencia për Barazi Gjinore, *Vlerësimi i Ndikimit të Barazisë Gjinore*, në:

<https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/Manuali%20p%C3%ABr%20Vler%C3%ABsimin%20e%20Ndikimit%20t%C3%AB%20Barazis%C3%AB%20Gjinore.pdf>.

_____, *Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024*, 2020, në:

<https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ABGJ%20Programi%20i%20Kosov%C3%ABs%20p%C3%ABr%20Barazi%20Gjinore%202020-2024.pdf>.

Aristei, D. and Gallo, M., "Does gender matter for firms' access to credit? Evidence from international

Data", *Finance Research Letters*, 18, pp. 67-75, 2016, at:

https://econpapers.repec.org/article/eeefinlet/v_3a18_3ay_3a2016_3ai_3ac_3ap_3a67-75.htm.

Atkinson Foundation. (2020). *Informimi i Vendimeve Publike - Armine Yalnizyan*, at:

<https://atkinsonfoundation.ca/atkinson-fellows/>.

ASK, *Anketa e Fuqisë Punëtore 2019*, në:

<https://ask.rks-gov.net/media/5369/anketa-e-fuqis%C3%AB-pun%C3%ABtore-afp-2019.pdf>

_____, *Statistikat e Punësimit*, në: https://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/askdata_Welfare%20and%20health_02%20Health_01%20T%C3%ab%20pun%C3%absuarit%20n%C3%ab%20sh%C3%abndet%C3%absin%20e%20Kosov%C3%abs/health01.px/?rxid=-7fa530c0-64a3-44c5-815b-e76a9e352eb7

_____, *Statistikat e Shëndetësisë 2018*, në:

<https://ask.rks-gov.net/media/5111/statistikat-e-shendetesise-2018.pdf>

_____, *Struktura gjinore e të punësuarve në institucionet shëndetësore publike në Kosovë, 2018-*

2019, Kosovë, në: https://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/en/askdata/askdata_Welfare%20and%20health_02%20Health_01%20T%C3%ab%20pun%C3%absuarit%20n%C3%ab%20sh%C3%abndet%C3%absin%20e%20Kosov%C3%abs/health01.px/table/tableViewLayout1/?rxid=-7fa530c0-64a3-44c5-815b-e76a9e352eb7.

_____, *Buletini Tremujor, tetor 2020*, në: <https://ask.rks-gov.net/media/5644/buletini-tremujor-tetor-2020.pdf>

_____, *Statistikat Sociale: Anketa e Fuqisë Punëtore TMI 2020*, 2020, në: <https://ask.rks-gov.net/media/5554/afp-tmi-2020-finale.pdf>.

AWID, *Nga një Shpëtim Feminist në një Rimëkëmbje Ekonomike Global Feministe*, 2020, në: <https://www.awid.org/sites/default/files/atoms/files/bailoutmanifesto-en-final.pdf>

Bankrate, "Burrat, gratë dhe borxhi: A ka rëndësi gjinia?", 2014, në:

<https://www.bankrate.com/finance/debt/men-women-and-debt-does-gender-matter.aspx>.

Bargawi, H., Cozzi, G., *Krijimi i Rimëkëmbjes Ekonomike: Modelimi i Alternativave të Shtrëngimit në Evropë*, 2017, në: <https://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/13545701.2017.1344775>.

Barker, D. Barker, D. *Ekonomistët, reformatoret sociale dhe profetët: një kritikë feministe e efikasitetit ekonomik*, *Ekonomi Feministe*, 1(3): 26-39, 1995.

Barker, D. *Ekonomia neoklasike*, në Peterson, J. dhe Lewis, M. (red.) *The Elgar Companion to Feminist Economics*, Cheltenham: Edward Elgar: 570-577, 1999.

Bashkimi Evropian, Plani i Veprimit Gjinor i BE-së II: Si Delegacionet e BE-së kontribuojnë në barazinë gjinore në të gjithë botën, 2019, në: <https://europa.eu/capacity4dev/articles/eu-gender-action-plan-ii-how-eu-delegations-contribute-gender-equality-worldwide>

Bota Sot, Një muaj nga rasti i parë me COVID-19 në Kosovë, si u rrit ditë pas dite numri i të infektuarve dhe masat që u ndërmorën muaj nga rasti i parë COVID-19 në Kosovë, në:

<https://www.botasot.info/aktuale-lajme/1272777/nje-muaj-nga-rasti-i-pare-me-COVID-19-ne-kosove-si-u-rrit-dite-pas-dite-numri-i-te-infektuarve-dhe-masat-qe-u-ndermoren/>.

Bwire, George M., "Coronavirus: Pse burrat janë më të prekshëm nga Covid-19 sesa gratë? ", Mjekësia gjithëpërfshirëse klinike, 2020 qershor 4: 1–3, në: <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC7271824/>.

Chang, H.-J. 23 gjërat që nuk ju tregojnë për kapitalizmin, 2011, në:

https://dimosioshoros.files.wordpress.com/2010/09/23_things.pdf.

Cojocar, Alexandru, Jobs Diagnostic Kosovo, Issue No. 5, World Bank, 2017,

<http://documents1.worldbank.org/curated/en/814361497466817941/pdf/Kosovo-Jobs-Diagnostic.pdf>.

D4D, Implikimet e mundshme gjinore të COVID-19 në Kosovë, 2020, në:

https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2020/03/D4D_Analize-e-politikave_8.pdf.

De Henau J, Himmelweit S, Łapniewska Z, Perrons D., Investimi në ekonominë e kujdesit: një analizë

gjinore e stimulit të punësimit në shtatë vende të OECD, Bruksel: Konfederata Ndërkombëtare e Sindikatave, 2016.

De Henau, J., Himmelweit, S., Stimulimi i ekonomive të OECD pas Covid duke investuar në kujdes,

Dokumenti i Punës i Universitetit të Hapur IKD, 2020, në: <http://www.open.ac.uk/ikd/publications/working-letrat>.

EIGE, Përfitimet Ekonomike të Barazisë Gjinore në Bashkimin Evropian. Ndikimet e përgjithshme ekonomike të barazisë gjinore, 2017a, në: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/policy-areas/economic-and-financial-affair/economic-benefits-gender-equality/economic-caseconomic>.

_____, Përfitimet ekonomike të barazisë gjinore në Bashkimin Evropian. Raporti mbi zbatimin empirik të modelit, 2017b, në: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/policy-areas/economic-and-financial-affair/economic-benefits-gender-equality/economic-case>.

Ekonomia Online, Hoti: Në shtator fillon plani afatgjatë i rimëkëmbjes ekonomike], 20 gusht, 2020, në: <https://ekonomiaonline.com/ekonomi/hoti-ne-shtator-fillon-plani-afatgjate-i-rimekembjes-ekonomike/>.

_____, "Kryeziu: Vendimi i Qeverisë nuk e pamundëson marrjen e mjeteve për rastet sociale", në: <https://ekonomiaonline.com/politike/kryeziu-vendimi-i-qeverise-nuk-e-pamundeson-marrjen-e-mjeteve-per-rastet-sociale/>.

_____, "Hoti: Në shtator fillon plani afatgjatë i rimëkëmbjes ekonomike", 20 August 2020, në: <https://ekonomiaonline.com/ekonomi/hoti-ne-shtator-fillon-plani-afatgjate-i-rimekembjes-ekonomike/>.

_____, Mësimi online në distancë, ministria me grup të ekspertëve për vlerësimin e nxënësve, Prill

2020, në: <https://ekonomiaonline.com/nacionale/arsim/mesimi-online-ne-distance-ministria-me-grup-te-eksperteve-per-vleresimin-e-nxeneseve/>.

Elson, D. Plan F: Plani Feminist për një Ekonomi të Kujdesit dhe të Qëndrueshme, 2016, në: <https://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/14747731.2016.1156320?journalCode=r-glo20>.

Evropa e Lire, Mësimi në distancë për shumë fëmijë mbetet i paarritshëm, në: <https://www.evropaelire.org/a/mesimi-distance-nxenesit-pajisje/30588537.html>

Feminizmi Afrikan [AFRICANFEMINISM], Deklarata e Rimëkëmbjes Ekonomike Feministe Afrikane Post-Covid-19, 2020, në: <https://africanfeminism.com/african-feminist-post-covid-19-economic-recovery-statement/>.

FMN, Raporti i Vendit të Republikës së Kosovës Nr. 20/112, Kërkesa për Blerje sipas Instrumentit të Financimit të Shpejtë - Kërkesa për Blerje nën Instrumentin e Financimit të Shpejtë, Prill 2020, në: <https://www.imf.org/en/News/Articles/2020/04/10/pr20149-kosovo-imf-executive-board-approves-us-million-emergency-support-address-covid-19-pandemic>.

Galli E., Rossi S.P.S., Aksesit i kredisë bankare dhe diskriminimi gjinor: Disa fakte të stilizuara, in: Rossi S., Malavasi R. (eds) Financial Crisis, Bank Behaviour and Credit Crunch - Contributions to Economics, Springer, Cham, 2016, në: https://doi.org/10.1007/978-3-319-17413-6_8.

Grown, C., "Tatimi dhe barazia gjinore: Një kornizë konceptuale", në C. Grown & I. Valodia (Eds), Tatimi dhe barazia gjinore: Një analizë krahasuese e taksave direkte dhe indirekte në vendet në zhvillim dhe të zhvilluara, Abingdon: Routledge, 2010, në: <https://idl-bnc-idrc.dspacedirect.org/bitstream/handle/10625/43684/IDL-43684.pdf?sequence=1&isAllowed=y>.

Grupi i Bankës Botërore, Treguesit Global të Qeverisjes Rregullatore: Praktikant në të gjithë botën të Vlerësimeve të Ndikimit Rregullator, në: <http://documents1.worldbank.org/curated/en/905611520284525814/Global-Indicators-of-Regulatory-Governance-Worldwide-Practices-of-Regulatory-Impact-Assessments.pdf>

Grupi i Buxhetit të Grave, Krijimi i një ekonomie të kujdeshme: një thirrje për veprim, shtator 2020, në: <https://wbg.org.uk/events/creating-a-caring-economy-a-call-to-action/>.

Himmelweit, S. Prospektet për Përkujdesjen: Teoria Ekonomike dhe Analiza e Politikave, Cambridge Journal of Economics 31 (4): 581-599, 2007.

Instituti Demokratik i Kosovës, Analizë e shkurtër e Paketës Fiskale të Urgjencës, 2020, në: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2020/08/50-Analiz%C3%AB-e-Shkurt%C3%ABr-e-Pakos-Fiskale-Emergjente-ALB-02.pdf>.

Instituti GAP, Ndikimi i COVID-19 në pushtetin lokal, maj 2020, në: [https://www.institutigap.org/documents/47798_covid_komuna\(F\).pdf](https://www.institutigap.org/documents/47798_covid_komuna(F).pdf).

_____, Ndikimi i Pandemisë COVID-19 në Tregun e Punës. Qershor, 2020, në: https://www.institutigap.org/documents/97205_covid_tregu_punes.pdf.

Insajderi, Rishikimi i buxhetit – ja çfarë përfitojnë qytetarët, në: <https://insajderi.org/rishikimi-i-buxhetit-ja-çfare-perfitojne-qytetaret/>.

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, Udhëzues i përkohshëm për aplikimin e masave për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 ne institucione publike dhe private, Ministria e Shëndetësisë, Republika e Kosovës, maj 2020, në: <https://niph-rks.org/wp-content/uploads/2020/05/UDHEZUES-I-PERKOHSEM-APLIKIMI-I-MASAVE-COVID-19-INSTITUCIONET-PUBLIKE-E-PRIVATE.pdf>

Instituti Riinvest, *Gratë në Tregun e Punës*, f. 38, 2017, në:

https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2017/November/10/Grate_ne_tregun_e_punes1510308263.pdf.

Kallxo, Rastet sociale përfituan nga dy pagesa por jo dhe pensionistët, në: <https://kallxo.com/lajm/rastet-sociale-perfituan-nga-dy-pagesa-por-jo-dhe-pensionistet/>.

Klan Kosova, Kurti: Koalicioni me LDK-në u prish para se të shkarkohej Agim Veliu, prill 2020, në: <https://klankosova.tv/kurti-koalicioni-me-ldk-ne-u-prish-para-se-te-shkarkohej-agim-veliu/>, 32 mijë nxënës nuk e kanë ndjekur fare mësimin online, në: <https://klankosova.tv/%E2%80%8B32-mije-nxenes-nuk-e-kane-ndjekur-fare-mesimin-online/>

Koha, Miratohet Ligji për Buxhetin 2020, 15 mars 2020, në:

<https://www.koha.net/arberi/213305/deputeteve-iu-behen-testet-per-koronavirus-para-se-te-hyjne-ne-sallen-e-seancave/>.

_____, Kosova qëndron keq me barazinë gjinore, kërkohet që gratë të jenë pjesë e vendim-marrjes,

maj 2019, në: <https://www.koha.net/arberi/164214/kosova-qendron-keq-me-barazine-gjinore-kerkohet-qe-grate-te-jene-pjese-e-vendimmarrjes/>.

Komisioni Evropian, Dokumenti i Përbashkët i Stafit të Përbashkët, Barazia Gjinore dhe Fuqizimi i Grave: Transformimi i Jetës së Vajzave dhe Grave përmes Marrëdhënieve të Jashtme të BE-së 2016-2020, SWD (2015) 182 finale, Bruksel, 2015, në: <https://ec.europa.eu/anti-trafficking/eu-policy/joint-staff-working-document-gender-equality-and-womens-empowerment-transforming-lives-en>.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, E-Prokurimi, Republika e Kosovës, në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/application/ipn/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1188423.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, në:

_____, Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, 2015, në:

<https://abgi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/LIGJI%20I%20RI%20P%C3%8BR%20BARAZI%20GJINORE%20shqip.pdf>.

_____, Ligji Nr. 05/L -068, Për Ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-042 Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, 2016: në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11332>.

_____, Ligji Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 07/L-001 për buxhetin

Ndarjet buxhetore të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2020 , Ligji, në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/C967DC09-044E-4CED-8391-4DB711241381.pdf>

_____, Ligji Nr. 07/L-001 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=30422>.

_____, Ligji Nr. 06/L-11 për Pagat në Sektorin Publik, mars 2019, në: https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18683&fbclid=IwARIVfACsTL4aSgc_aArBlk69qY_k-0NxRSIfgdj5Uc3wLIZ5vTeoOtuztU.

_____, Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, 2008, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>.

_____, Ligji Nr. 03/L –212 i Punës, 2020, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2735>.

_____, Ligji Nr. 05/L-057 Për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, 2016, në: https://bqk-kos.org/repository/docs/korniza_ligjore/shqip/Ligji%20mbi%20themelimin%20e%20Fondit%20Kosovar%20per%20Garanci%20Kreditore.pdf.

Kombet e Bashkuara, Ndikimi i COVID-19 te gratë, f. 2, prill 2020, në:

<https://www.un.org/sexualviolenceinconflict/wp-content/uploads/2020/06/report/policy-brief-the-impact-of-covid-19-on-women/policy-brief-the-impact-of-covid-19-on-women-en-1.pdf>

Lajmi, “MTI mbështet 32 biznese që drejtohen nga gratë”, Dhjetor 2020, në:

<https://lajmi.net/mti-ja-mbeshtet-32-biznese-qe-i-udheheqin-grate/>.

Liodakis, G., Ekonomia Politike, Kapitalizmi dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm, 2010, në:

<https://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:Dtn3Xb9tI58J:https://www.mdpi.com/2071-1050/2/8/2601/pdf+&cd=3&hl=en&ct=clnk&gl=de&client=safari>.

MBPZHR, Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2020 për Pagesën Direkte në Bujqësi për vitin 2020, në: https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Udhezimi_Administrativ_Pagesa_Direkte_Nr_03_2020_UA.pdf.

Mehmeti I., Dobranja D. Ndërmarrësia e Grave, Instituti Riinvest, Kosovë 2017, në:

https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2017/November/10/Ndermarresia_e_grave1510307787.pdf

Millennium Challenge Corporation, *Raporti i Studimit të Fuqisë Punëtore të Kosovës dhe Studimit të Përdorimit të Kohës*, f. 65,

2017, në: https://millenniumkosovo.org/mfk_documents/kosovo-labor-force-and-time-use-study-research-report/.

Ministria e Financave, Qarkorja e Buxhetit 2020/01, 2019, në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/9B16C33B-8181-4A1D-A4A9-6625E1C1E9DA.pdf>.

_____, Qarkorja e Buxhetit 2020/02 për nivelin qendror, 2019, në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/038124D6-17B8-4116-86A9-A6CFCB1631B7.pdf>

_____, Qarkorja e Buxhetit 2020/02 për komunat, 2019, në: <https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2019/10/Qarkorja-Buxhetore-2020-02.pdf>

_____, Qarkorja e Buxhetit 2021/02, 10.08.2020, në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/8FBFC1C3-5CFC-407F-98BD-338C694F2FCD.pdf>.

_____, Qarkorja e Buxhetit 2021/02, 16.09.2020, në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/71F986D0-852C-4D20-B267-096CFA8900B9.pdf>.

_____, Qarkorja e Buxhetit 2021/03, 14.09.2020, në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/CEB60D91-DF8E-4085-8FEB-D48D710E1113.pdf>.

_____, 15.05.2020, në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/0A4862AF-FF68-4C1E-BA9A-BCD1C97BB422.pdf>.

_____, Plani Operacional për Pakon Fiskale Emergjente, prill 2020, në:

<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/CF860B38-765C-41B3-87D0-6E38AD371584.pdf>

_____, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023 (KASH) 2021-2023, në:

<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/B8FC29D8-0C72-4F7A-80ED-FE35E30A89AB.pdf>

Ministria e Pushtetit Lokal, Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2020 për Transparencën e Komu-

nave, 2020, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=31852>

Muravyev, A., Talavera, O. dhe Schäfer, D., kufizimet gjinore dhe financiare të sipërmarrësve: Dëshmi

nga të dhënat ndërkombëtare, Revista e Ekonomisë Krahasuese, 37 (2), f. 270-286, 2009, në: <https://ideas.repec.org/a/eee/jecon/v37y2009i2p270-286.html>

Nelson, J. Feminizmi dhe Ekonomia, Revista e Perspektivave Ekonomike, 9(2): 131-148, 1995.

Organizata Botërore e Shëndetësisë, COVID-19 po i shkatërron shërbimet e shëndetit mendor në shumicën e vendeve, sondazh i OBSH-së, tetor 2020, në: <https://www.who.int/news/item/05-10-2020-covid-19-disrupting-mental-health-services-in-most-countries-who-survey>.

OXFAM, Koha për t'u kujdesur: Kujdesi i papaguar dhe i papaguar dhe Kriza Globale e Pabarazisë, 2020, në: <https://oxfamilibrary.openrepository.com/bitstream/handle/10546/620928/bp-time-to-care-inequality-200120-en.pdf>.

Perrons, D., "Gjinia e debatit të pabarazisë", Gjinia & Zhvillimi, 23: 2, 207-222, 2015, DOI: 10.1080 /

13552074.2015.1053217.

Piketty, T., Capital in the 21st Century, Cambridge: Harvard University Press, 2014.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore, OP-ED: Shëndeti riprodhues i vajzave dhe grave gjatë pandemisë COVID-19, 27 korrik 2020, në: <http://kgscenter.net/sq/lajme-dhe-ngjarje/shendeti-riprodhues-i-vajzave-dhe-grave-gjate-pandemise-covid-19/>

Qendra Ndërkombëtare e Rritjes, "COVID-19 dhe ndikimi në gratë", 28 Prill 2020, në:

<https://www.theigc.org/blog/COVID-19-and-the-impact-on-women/>.

Qeveria e Kosovës, Vendimi nr. 01/07. 11 mars 2020, në:

<https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-7-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2020.pdf>

_____, Vendimi nr. 01/09. 13 mars 2020, në:

<https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/05/Vendimet-e-mbledhjes-s%C3%AB-9-t%C3%AB-t%C3%AB.pdf>

_____, Vendimi nr. 01/11. 15 mars 2020, në:

<https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-nr.01-11.pdf>

_____, Vendimi nr. 01/13. 18 mars 2020, në:

<https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendim-i-Mbledhjes-s%C3%AB-13-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs.pdf>

_____, Vendimi nr. 01/15. 23 mars 2020, në:

<https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-15-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs.pdf>

_____, Vendimi Nr. 01/19, 30 mars 2020, në:

<https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-i-Qeveris%C3%AB-nga-Mbledhja-e-19.pdf>

_____, Vendimi Nr. 09/21, 2 prill 2020, në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/04/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-21-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs.pdf>

_____, Vendimi Nr. 01/27, 30 prill 2020, në:
<https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/04/Vendimet-nga-mbledhja-e-27-t%C3%AB-e-Qeveris%C3%AB.pdf>

_____, Vendimi Nr. 01/32. 25 shtator 2020, në:
<https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/09/Vendimet-e-mbledhjes-s%C3%AB-32-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB.pdf>

_____, Projektligji për Rimëkëmbjen Ekonomike - COVID-19, korrik 2020, në:
<https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/08/PROJEKT-LIGJ-P%C3%8BR-RIM%C3%8BK%C3%8BMBJEN-EKONOMIKE-COVID-19.pdf>

_____, Plani Operacional për Pakon Fiskale Emergjente. 3 prill 2020, në:
<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/CF860B38-765C-41B3-87D0-6E38AD371584.pdf>

_____, Rregullorja Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, 2016, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15036>

_____, Programi i Qeverisë 2020-2023, 2020, në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/06/Programi-Qeverises-2020-2023-final-05062020.pdf>

REL, Qeveria e Kosovës: Maskat obligative, teste negative për qytetarët e vendeve fqinje. 13 korrik 2020, në: <https://www.evropaelire.org/a/30723697.html>

Rrjeti i Grave të Kosovës, Masat për adresimin e COVID-19 nga perspektiva gjinore. Rekomandime për Qeverinë e Kosovës, prill 2020, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2020/04/Masat-p%C3%ABr-adresimin-e-COVID-19-nga-perspektiva-gjinore_Rekomandime-p%C3%ABr-Qeverin%C3%AB-e-Kosov%C3%ABs_04_04_2020.pdf

_____, Udhërrëfyes Praktik i Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor në Nivel Lokal, 2017, në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/11/20170428114117381.pdf>

_____, Qasja në Kujdesin Shëndetësor, 2016, në:
<https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/12/qasja.pdf>

_____, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale: Analizë e shpejtë gjinore për informimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë për 2016-2018*, 2015, në: <https://womensnetwork.org/sq/publications/buxhetimi-drejt-mireqenies-sociale-analize-e-shpejte-gjinore-per-informimin-e-buxhetimit-te-pergjegjshem-gjinor-ne-ministrine-e-punes-dhe-mireqenies-sociale-ne-kosove/>

_____, *Diskriminimi me Bazë Gjinore dhe Punësimi në Kosovë*, 2019, në:
https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2019/05/RrGK_Diskriminimi-me-baze-gjinore-dhe-punesimi-ne-Kosove_REV_FIN.pdf

_____, *Analiza Gjinore e Kosovës*, 2018, në:
<https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20181003170921410.pdf>

_____, *Kujt i intereson? Kërkesa, furnizimi dhe opsionet për zgjerimin e disponueshmërisë së Kujdesit për fëmijë në Kosovë*, Pristina: KWN, 2016, në:
<https://womensnetwork.org/wpcontent/uploads/2018/10/2016060715152892.pdf>

_____, *Mjaft më me arsyttime: Analizë e qëndrimeve, incidencës dhe reagimeve institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovën*, 2015, në: https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/RrGGK_Mjaft%20m%C3%AB%20me%20arsyttime_2015.pdf

_____, Buxheti drejt një arsimit më të mirë: Analizë gjinore e shpenzimeve dhe shërbimeve në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2016, në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20160607151528451.pdf>.

Shefkriu, Arbisa. Pezullohet Ligji i Pagave, nuk ka paga me rritje për tre muaj. KALLXO, 2019: <https://kallxo.com/lajm/pezullohet-ligji-i-pagave-nuk-ka-paga-me-rritje-per-tre-muaj/>

SHPPF 2016, Korniza për vlerësimin e menaxhimit të financave publike, në: <https://www.pefa.org/resources/pefa-2016-framework>

_____, Supplementary Framework for Assessing Gender Responsive Public Financial Management (Korniza Plotësuese për Vlerësimin e Menaxhimit të Përgjegjshëm Gjinor të Financave Publike, në: <https://www.pefa.org/gender>.

Smith, Adam, Pasuria e Kombeve, New York: Modern Library, 2000.

Shoqëria Fawcett, Ndikimi i masave shtrënguese tek gratë, Raporti i politikave të shoqërisë Fawcett, 2012.

Telegrafi, Deklarata për të cilën u shkarkua Agim Veliu, 18 mars 2020, në: <https://telegrafi.com/deklarata-per-te-cilen-u-shkarkua-agim-veliu/>

_____, 32 mijë nxënës nuk e kanë ndjekur fare mësimin online, gusht 2020, në: <https://telegrafi.com/32-mije-nxenes-nuk-kane-ndjekur-fare-mesimin-online/>

Televizioni 21, *Mësimi në distancë, sot nis edhe në gjuhën turke e boshnjake*, March 2020, në: <https://rtv21.tv/mesimi-ne-distance-sot-nis-edhe-ne-gjuhen-turke-e-boshnjake/>.

UNDESA, Varfëria e të Ardhurave në Moshën e Vjetër: Një Prioritet i Zhvillimit në Zhvillim, f. 1, në: <https://www.un.org/esa/socdev/ageing/documents/PovertyIssuePaperAgeing.pdf>.

UNFPA & UN Women, Shpërthimi i pandemisë COVID-19: Shfaqja e çështjeve për gratë dhe vajzat dhe Rekomandimet për përgjigje të ndjeshme gjinore, në: https://www.mit-ks.net/repository/docs/2020_04_06_200911_Ndikimi_i_situates_se_COVID_19_tek_grate_dhe_vajzat_rekomandimet_UN_Women_UNFPA_1.docx.

YWCA Kanada, “Një Plan Feminist i Rimëkëmbjes Ekonomike për Kanadanë: Vënia në punë e Ekonomisë për Të gjithë”, 2020, në: <https://static1.squarespace.com/static/5f0cd2090f50a31a91b37ff7/t/5f205a15b1b7191d12282bf5/1595955746613/Feminist+Economy+Recovery+Plan+++Canada.pdf>

Zeri, “Qeveria cakton dy milion euro për Agjencinë për Barazi Gjinore”, Nëntor 2020, në: <https://zeri.info/aktuale/379188/qeveria-ndan-dy-milione-euro-per-agjencine-per-barazi-gjinore/>.

Zyra e Kryeministrit të Kosovës, *Konfirmohen dy rastet e para të Corona Virusit Covid-19 në Kosovë*, Gazeta Zyrtare e Kosovës, 13 mars 2020, në: <https://kryeministri-ks.net/konfirmohen-dy-rastet-e-para-te-corona-virusit-covid-19-ne-kosove/>.

_____, Programi i Qeverisë 2020-2023, 2020, në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/06/Programi-Qeverises-2020-2023-final-05062020.pdf>.

SHTOJCAT

Shtojca 1. Treguesit dhe dimensionet e SHPPF MPGJFP

Treguesi	Dimensioni
1. Analiza e ndikimit gjinor e propozimeve të politikave buxhetore	1.1. Analiza e ndikimit gjinor e propozimeve të politikës së shpenzimeve
	1.2. Analiza e ndikimit gjinor e propozimeve të politikës së të ardhurave
2. Menaxhimi i investimeve publike të përgjegjshme gjinore	2.1. Menaxhimi i investimeve publike të përgjegjshme gjinore
3. Qarkore buxhetore e përgjegjshme gjinore	3.1. Qarkore buxhetore e përgjegjshme gjinore
4. Dokumentacioni i përgjegjshëm gjinor i propozimit të buxhetit	4.1. Dokumentacioni i përgjegjshëm gjinor i propozimit të buxhetit
5. Informacione të performancës të ndara sipas gjinisë për ofrimin e shërbimeve	5.1. Planet e performancës të ndara sipas gjinisë për ofrimin e shërbimeve
	5.2. Performanca e ndarë sipas gjinisë e arritur për ofrimin e shërbimeve
6. Gjurmimi/përcjellja e shpenzimeve të buxhetit për barazinë gjinore	6.1. Gjurmimi/përcjellja e shpenzimeve të buxhetit për barazinë gjinore
7. Raportimi i përgjegjshëm gjinor	7.1. Raportimi i përgjegjshëm gjinor
8. Vlerësimi i ndikimeve gjinore të ofrimit të shërbimeve	8.1. Vlerësimi i ndikimeve gjinore të ofrimit të shërbimeve
9. Shqyrtimi legjislativ i ndikimeve gjinore të buxhetit	9.1. Shqyrtimi legjislativ i përgjegjshëm gjinor i buxheteve
	9.2. Shqyrtimi legjislativ i përgjegjshëm gjinor i raporteve të auditimit

Shtojca 2. Model i manualit të intervistave

Buxheti dhe proceset e buxhetimit

1.1.1. A ka komuna juaj zakonisht një buxhet të rastit? [Për sqarim të mëtejshëm: Një buxhet i rastit është një buxhet që mund të jetë i lirë të përdoret për qëllime të ndryshme, bazuar në nevoja]

Po

Jo

Nuk e di

1.1.2. Nëse po, a është përdorur për të adresuar pandeminë COVID-19?

Po

Jo

Nuk e di

1.1.3. Nëse po, ju lutemi mund të përshkruani procesin se si u morën vendimet se si të përdoret buxheti i emergjencave? [Për sqarim të mëtejshëm: kush e propozoi? Kush e rishikoi? Kush e aprovoi?]

1.2.1. Për çfarë qëllimi keni planifikuar të përdorni buxhetin e kontigjencës / të emergjencave për të adresuar krizën COVID-19?

1.3.1. A mbështetet në mënyrë efektive buxheti i kontigjencës nga sistemi i thesarit (siguroni prova)?

Po

Jo

Nuk e di

1.4.1. Në përgjithësi, a ka Kosova një fond katastrofash apo fond për menaxhimin e krizave?

Po

Jo

1.5.1. A është përdorur për të adresuar COVID-19?

Po

Jo

1.6.1. Në ç'masë u ndryshua buxheti fillestar, i miratuar zyrtarisht për të adresuar COVID-19? [Nëse nuk ka pasur ndryshime buxhetore vazhdo në 3.4.1.]

1.7.1. Sa i rëndësishëm ishte rregullimi/ndryshimi i buxhetit për sa i përket përqindjes së vijës buxhetore të buxhetit fillestar? [Për sqarim të mëtejshëm: me çfarë përqindje ndryshoi buxheti nga buxheti paraprak?]

1.8.1. Cila procedurë është përdorur për të bërë këto ndryshime? [Për sqarim të mëtejshëm: A u dërgua në parlament për miratim?]

Nuk kishte nevojë për aprovim [shkruaj pse; p.sh., më pak se shuma e lejueshme me ligj]

Nuk u dërgua në parlament

U dërgua në parlament

[Përshkrimi i shpjegimit nga hulumtuesi:]

1.9.1 A përfshinin modifikimet e buxhetit një arsytim?

Po

Jo

1.9.2. A ishin bazuar ndryshimet e buxhetit në një vlerësim të ndikimit?

Po

Jo

1.9.3./4.1.1A është kryer një vlerësim i ndikimit gjinor në përputhje me Vlerësimin e Ndikimit Rregullator?

Po

Jo

1.9.4. Në ç'masë u reflektua gjinia në justifikim?

Aspak

Pak

Shumë

1.9.5. Ju lutemi a mund të ndani arsyetimin me shkrim me ne?

Po e ndarë

Po do të ndahet më vonë përmes postës elektronike

Jo

1.10.1. Kur u propozua për herë të parë buxheti i rishikuar për t'iu përgjigjur situatës COVID-19?

[Shënim: nëse ka më shumë se një document politikash, përfshini datat për secilën, të etiketuara qartë, për këtë dhe pyetjet vijuese]

